

Rinia dhe islami

Çfarë rinie po vjen?

Rinia de arsimi


Jetojmë rininë

Personaliteti shumbullor

Rinia dhe koha e agimit

Roli i rinisë në kohën e pejgamberit (s.a.v.)

**Rinia Përballë të Vërtetës së
Modernizmit**



Viti: II Numri: 7

Prill - Maj - Qershor 2007

Rebiul Evvel - Rebiul Ahar

Xhumadel Ula 1428

Boton

SH. E. A. VËSHTRIMI:

Sead MORINA

Përkthyes:

Ermal Nurja

Ali Bardhi

Artur Tagani

Alban Kali

Adem Pizga

Evans Drishti

Zymer Ramadani

Redaktorë gjuhësor-letrar:

Ermira Alija

Brikena Smajli

Gentijana Dizdari

Diana Bilali

Adresa:

Dardania Rr. banesore 4/7-d-6
kati përdhes banesa Nr. 1 Prishtinë

Tel: +381 385 423 85

Shtyp: Shtëpia Botuese ERKAM

Tel: +90 212 671 07 00

Dizenjo - Grafik:

Ali KAYA

Ngjyra: World Graphics

Tel: +90 216 326 22 14

Adresa e përfaqësisë në Shqipëri:

Shoqata Vëllazërore Humanitare

Kulturore Stamboll

Bulevardi Zogu I pall. 97

ap. 21 shk. 2 Tiranë / Albania

Tel: +355 424 81 12

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Për artikuj:

e-mail: etika@revistaetika.com

editor@revistaetika.com

reklam@revistaetika.com

Të dashur lexues...

Si temë kryesore në këtë numër të revistës Etika kemi përzgjedhur çështjen e rinisë sonë përballë zhvillimeve marramendëse në botën e re që është duke sjellë mileniumi i tretë.

Ditët kalojnë pa kuptuar dhe shumë kush heq një rënkim të thellë tek kujton vitet e rinisë. Një delir që i bën disa njerëz t'u mbetet qejfi kur ju pa dashje i vini në dukje vitet që tashmë janë reflektuar në fytyrën dhe ballin e tyre. Njerëz që dëshirojnë të mbeten përherë të rinj. Mbase sepse vitet që kalojnë u përkujtojnë fundin e çdo gjëje të gjallë, ndoshta sepse kanë ende ëndërra për të realizuar në këtë jetë.

Ndërsa të rinjtë janë të dhënë aq shumë pas të sotmes, sa që nuk e ndalin njëherë hapin dhe të mendojnë se ditët që u kalojnë nuk do të kthehen më pas. Ato ditë që u duken bosh dhe përpiqen ti mbushin më shumë se me studime me dëfrime dhe shfrenime të pakontrolluara.

Që relaksi i përmbushur në mënyrë të duhur është i këshillueshëm kjo nuk ka dyshim. Por tek shohim se për ku shpejton bota e sotme, kur ndalim të reflektojmë se tashmë duhet të heqim njëherë e mirë dorë nga rradha e shteteve të prapambetura dhe të zëmë vendin që na takon si komb i lashtë nuk mund të mos ndalim një hop dhe të mos vëmë në qendër të planeve dhe projekteve së së ardhmes sonë të rinjtë, zhvillimin e tyre, plotësimin e tyre me njohuri dhe përgatitjen e tyre për një botë që nuk të fal as lajthithen më të vogël.

Ka shumë organizata, OJF, madje dhe instanca shtetërore që propogandojnë me të madhe zhvillimin e rinisë. Përfundimet nuk shihen, rezultatet të ngjallin krupën.

Në të shumtën e rasteve harrohet që këta të rinj mes të tjerash të edukohen edhe me ndjenjat më të shëndosha, mikun e vërtetë të udhës së vështirë të jetës.

Nëse akoma nuk e ka vendosur sistemi arsimor se çfarë dhe përse po edukon do të thotë që po mbillet erë dhe gjëja e vetme që do korret është stuhia.

Nëse nuk dëshirojmë që të shndërrohen shkollat në burgje, edukatorët dhe mësime të rinisë në gardianë, nëse nuk duam që në çdo ditë të shohim në sytë e fëmijëve me drojtje dhe me tension, atëherë duhet të trokasim më fort në portat e zemrës së njeriut.

Tek një fëmijë është i fshehur si një shpëtimtar, ashtu edhe një kriminel..., derisa të gjejmë shpëtimtarin duhet t'i japim formë, që t'i shkruhet emri në histori.

Gjatë gjithë historisë së Islamit të rinjtë kanë luajtur një rol shumë të madh. Nëse studiojmë me kujdes kohën e Muhammedit (a.s.) vërejmë set ë rinjtë e kanë pranuar dhe më lehtë besimin e drejtë.

Këshilla jonë nuk mund të jetë tjetër përveçse asaj që na këshillonte i Dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s.):

- Shfrytëzoheni rininë përpara set ë vijë mosha e thyer!



Në këtë numër do të lexoni:

- 1 Editorial
- 3 Rinia dhe Islame
- 6 Çfarë Rinie Po Vjen?
- 8 Plaga E Rinisë Zbrazësia Shpirtërore
- 11 Intervistë me Hirësinë e Tij, Osman Nuri Topbash,
- 15 Roli I Rinisë Në Kohën E Pejgamberit (S.A.V)
- 20 Këshillat E Mia Për Të Rinjtë
- 21 Kulturë Gjuhë
- 22 Rinia Dhe Arsimi
- 27 Jetojmë Rininë
- 29 Intervistë Me Prof. Dr. Hajreddin Karamanin Mbi Modernitetin
- 31 Vetja, të tjerët dhe mjedisi
- 32 Lufta e Vlerave
- 34 Gratë e Sulltanit
- 35 Personaliteti Shembullor
- 42 Rinia Dhe Koha E Agimit
- 44 Drejt Teje
- 45 Rinia Përballë Të Vërtetës Së Humanizmit-modernizmit
- 47 Dashuria Si Thelbi I Çdo Gjëje
- 50 Rinia Përballë Librit
- 51 Të Rinjtë Dhe Organizata E Konferencës Islamike
- 53 Xhamia “Sulltan Mehmed- Fatih”
- 57 Shëndeti & Familja
- 59 Arti i Tez’hibit
- 61 Aktualitet i Menduar
- 63 Teknologji



8



11



15



32



47

Rinia dhe Islame

Ahmet TASHGETIREN

Prill
Maj
Qershor
2007|7

ETIKA



**Thelbi i slloganit
“mos lufto,
dashuro”
ndoshta nuk
ishte i
qëndrueshëm,
por në formën e
një antiteze ai
bënte thirrje për
një kryengritje
nga Perëndimi.**

Pozitivizmi, i cili vazhdoi që nga shek. XIX në Perëndim, pas gjithë copëtimeve të luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, përfundoi me shpërthimet e rinisë. Vitet 1960 do të njiheshin me kryengritjet e rinisë Perëndimore ndaj rregullit që tashmë po vihej në dukje. Kjo kryengritje solli në Europë demonstrues, të cilët në një vend ishin “Fëmijët e Luleve” që njiheshin si Beatlesët, ndërsa në një vend tjetër “Demostrimet e nxënësve” dhe më pas në demostrimet e 1968 që arrinin në territoret e rrugëve.

Në një kohë kur shikohej se në Europë kjo dhimbje mund të kapërcehej, rinia Amerikane doli në dukje me Rock dhe Rap, një lloj muzike që e shoqëronte edhe heroina e vringëllonte rininë Perëndimore brenda një anafore.

Cilat ishin ato influenca shoqërore që ushqenin rrymat e kësaj rinie që zhvillohej në Perëndim?

Si të tilla mund të radhiten:

- Rinia Perëndimore e njohur me politikën pushtuese të Krishtëritizmit që nga shek. XIX e deri tani dhe si rezultat i arismit pozitivist që u zbatua është rritur larg vlerave shpirtërore.

Struktura kapitaliste e zhvilluar në Perëndim ka krijuar gremina mes pjesëve të shoqërisë dhe si rezultat pushtuesi ka krijuar një rregull të qëndrueshëm.

Në një atmosferë të tillë rinia, nga njëra anë anonte nga socializmi që vinte me kritikën e kapitalizmit ndaj natyrës së njeriut,

ndërsa nga ana tjetër zhvillonte filozofinë “e lënies pas dore”, që parashikonte një kryengritje kundër të gjitha vlerave të shoqërisë. Nga e para lindi mllefi i rinisë socialiste, ndërsa nga e dyta kryengritja “Fëmijët e Luleve”, ku nga një pjesë e kësaj të fundit u formua një kryengritje pasive që u zhvillua në formën e sulmuesve të heroinës dhe të vetvrasjeve.

Mund të thuhet se në thelbin e të dy rasteve kishte një kryengritje njerëzore. Vija rinore, e cila nuk e shikonte botën në aspektin e politikave të shtetit apo të grupeve dhe që akoma s’e kishte humbur anën njerëzore, duke parë që nuk e kishte ndryshuar rregullin në të cilin jetonte, zgjodhi kryengritjet. Kur demostrimet e veçuan nga politikën Sovietike, rinia socialiste doli kundër pushtimit, ndërsa Beatlesët i dënonin makinat e luftës që çonin më tutje sistemin pushtues ndërkombëtar të perëndimit. Thelbi i slloganit “mos lufto, dashuro” ndoshta nuk ishte i qëndrueshëm, por në formën e një antiteze ai bënte thirrje për një kryengritje nga Perëndimi. Edhe sot, p.sh.: në muzikën Rock dhe Rap është e mundur të vihet re një lloj nënvlerësimi, kritika rrënjësore ndaj vlerave të kulturës Perëndimore. Lëvizjet brenda rrethit bënin thirrje për një proces të tillë.

Tani, rinia në botën Sovietike, e cila del në dukje si një kryengritje ndaj kapitalizmit, por që përfshihet brenda një prese, pas një arsimit intensiv ateist me

shpërbërjen e sistemit Sovietik, ra në një kaos të plotë mendimi. Në këtë botë në të cilën bien këmbanat e vdekjes edhe të ateizmit së bashku me Marksizmin, miliona njerëz bashkë me urinë ekonomike jetojnë edhe urinë e besimit.

PROBLEMET E TË RINJVE...?!

Çfarë problemesh kanë të rinjtë në të gjithë botën?

Sipas mendimit tonë ato janë tre:

Së pari, të rinjtë mbrojnë një vizion njerëzor;


Së dyti, ato janë të pafuqishëm për ta bërë këtë, pra nuk ndejnë forca të mjaftueshme për ta bërë;

Së treti, janë aq të papërvojë sa rrugës bëhen flijimet e sistemit në fuqi.

Ne mendojmë se të rinjtë mbrojnë një pozicion shumë njerëzor mbi botën, sepse janë në një moshë akoma afër një ndërgjegjeje të pastër. Sistemi akoma si ka futur nën influencën e tij materiale.

Të rinjtë para pubertetit ndihen shumë afër besimit në Zotin e Profetin. Themeli shpirtëror i kësaj periudhe gjithashtu është në aftësinë e të jetuarit si i tillë. Kështu që mund të thuhet se të rinjtë e kësaj moshe janë duke kërkuar karakterin e tyre të ardhshëm kudo në familje, shoqëri, në sistemin mbizotërues etj, një periudhë kur të rinjtë kërkojnë lider-shembujt, për të mpleksur të ardhmen me reflektimin e tyre në to. Zhvillimi i tyre fizik e shpirtëror i vendos ato në një Araf (purgator) psikologjik. Janë të ndjeshëm e altruist, të aftë për të pranuar e për t'ju përshtatur zhvillimeve të tyre fizike apo shfaqjeve të reja fizike, në kërkimin e një



 Të rinjtë e sotëm po jetojnë një konsistencë shpirtërore të atillë që është e nevojshme tërësisht për zërin e Islamit apo thirrjes së tij.

identiteti, duke jetuar periudhën e pjekurisë së karakterit. Në këtë periudhë me këto cilësi ai i drejtohet islamit ose të njerëzishmes.

Mirëpo i riu, jashtë, gjen një sistem rregullit të ndërtuar apo organizuar. Në qoftë se ky sistem rregullit është i përafërt me vlerat e thella shpirtërore të tij atëherë zhvillimi apo rritja do të jetë e shëndoshë, por ka shumë kohë që bota e ka grushtuar një sistem të tillë rregullit.

Sistemi i rregullit që rrethon

apo përfshin të riun e ka përjashtuar sistemin e rregullave që ka vendosur Zoti, sistem i cili idhujtarizon unin e njeriut apo shoqërisë dhe ku idhulli më i fuqishëm kërkon të zhdukë të tjerët. I riu nuk ka fuqi ta ndryshojë këtë sistem, sepse idhujt e lartpërmendur kanë mbi supet e veta përvojën e shumë viteve.

Siç duket të rinjve përveçse protestave të pashpresa, e mërzi-tjeve nuk i mbetet asgjë tjetër. Sistemi e merr të riun dhe e brumos në mënyrë graduale duke e bërë edhe atë pjesë të çnjerëzores ose shtyp atë pafundësisht duke e bërë atë shembull të keq për ato që duan të ndjekin rrugën e tij. Kurse një pjesë tjetër e të rinjve ndihen të fyer nga sistemi në fjalë prandaj edhe vendosin ti marrin jetën vetes me shiringat që ngulin në damarët e tyre.

Konsistenca shpirtërore

Të rinjtë e sotëm po jetojnë një konsistencë shpirtërore të atillë që është e nevojshme tërësisht për zërin e Islamit apo thirrjes së tij. Në të gjitha shfaqjet e tyre shihet nevoja për islamit si në kërkimin, zemërimin, rebelimin... e tyre. Kjo është një gjendje që do të gjente qetësi në Islam. O në islam ose në vetvrasje, sepse ajo që të rinjtë kërkojnë është njerëzorja, e cila ndodhet tërësisht në islam.

Edhe pse gjërat e cekura janë disa të vërteta të pamohueshme kjo s'do të thotë që të rinjtë në mënyrë automatike do të njihen me islamit e në mënyrë të vetvetishme do ta rrokin atë. Kjo është në kundërshtim edhe me rregullat e natyrës.

Allahu ka dëshiruar që ngjarjet apo proceset sociale të mos ndodhin vetvetiu në mënyrë të pavetëdijshme por njeriu me vullnetin e përkushtimit e tij të

bëhet shkak i tyre. Prandaj duhet një lëvizje e menduar e mo-derne për të ftuar të rinjtë në islam me gjuhën më të ëmbël e me mjetet më të përshtatshme sigurisht për kohën që jetojmë.

Popullsia e të rinjëve dhe Islami

Si ndikon Islami në këtë popullsi të re, në shkollat, familjet, xhamitë dhe organet e shtypit?

Sot mund të flasim për një edukim të kufizuar (frenuar) islam si pasojë e sistemit laik që përshton të gjitha këto organe. Edhe xhamitë që njihen si institucionet më të gjalla përsa i përket mësimi të fesë islame duken shumë larg këtij realiteti.

I riu, i pajisur me edukatën fetare nuk mund të vlerësojë as përbërjen e vet kulturore, as organin social në të cilin ndodhet, thjesht çështja e marrjes së islamit nga një i ri duket tepër e largët në shoqërinë e sotme. Ndoshta mund të

bëhen edhe përjashtime.

A ka ndonjë përpjekje brenda familjes për të pasuruar anën shpirtërore të një të riu?

Imami (folësi) a i sheh dallimet që ekzistojnë në mes një xhemati të mbushur me studentë dhe një xhemati të mbushur me fshatarë?

A e sheh të nevojshme një gjë të tillë?

Duke filluar që nga vendi ynë shihet e nevojshme një lëvizje e popullsisë. Thirrja në fenë islame ka qenë një art, të cilit në kohën e profetit (a.s) i është kushtuar shumë rëndësi.

Profeti i zgjidhte me shumë kujdes të rinjtë që do i flisnin të tjerëve. Secili prej tyre kishte një mënyrë të foluri elokuent. Sot nuk shihet i njëjti kujdes në të zgjedhurit e vaizëve (oratorëve fetarë). Ne duhet të shikojmë anët që ndikojnë në thirrjen islame, të zhvillojmë metoda ose

mënyra thirrjeje të përshtatshme për shoqëri dhe grupmosha të ndryshme dhe këto mënyra t'i shprehim me gjuhën më të kuptueshme. Në qoftë se rinia jonë ballafaqohet me metoda të tilla mund të themi se Islami do ishte për to si drita që i ndriçon shpirtërat, si kallinj të e pjekur që nxjerrin kokën pa frikë duke hequr mbulesën.

Hapi i dytë konstaton në kuptimin e botës rinore. Pas regjimit sovjetik, një i ri i cili e ka kaluar një pjesë të jetës me një mangësi përsa i përket formimit fetar gjen si rrugëzgjdhje ose qetësi në biskota dhe në përdorimin e lëndëve narkotike.

I riu përëndimor do i afrohet fesë islame me shpresën e shpëtimit.

Myslimanët sot mbajnë një përgjegjësi të madhe mbi supë. Takimi i të rinjve sot me islam do të thotë krijimi i botës islame nesër. Ne duhet t'i afrohem shoqërisë duke marrë mbi supë përgjegjësinë e çdo fjale që themi.

Pejgamberi(a.s) gjeti dhe krijoi një shoqëri të rinjsh. Këtë e kuptuan të gjithë ato që qëndruan afër tij. Sistemi që u vendos në Medinë përbëhej nga këta të rinj. Kur pejgamberi (a.s) kërkonte komandantë për luftë, mësues feje apo ekonomistë gjithnjë mbështetej në krahët e fortë të të rinjve. Mus'ab b. Umejr, Usame b.Zejd, Abdullah b.Abbas, Abdullah b. Umer, Hazreti Hasani dhe Hysejni ishin disa prej të rinjve, mbi supet e të cilëve u lartësua feja islame. Ndihet e nevojshme të analizohet sunneti i pejgamberit (a.s) për nga aspekti i takimit me të rinjtë.



Çfarë Rinie Po Vjen

Hatixhe YILDIZ

Si një individ që udhëtoj shpesh me mjete transporti e ndiej veten të humbur në vorbullën e shoqërisë. Vajtjet dhe ardhjet që zgjasin kur trafiku ngushtohet u hap gojën disa njerëzve, aq sa kur flasin të rinjtë i shpjegojnë ngjarjet e jetës së tyre të përditshme sikur përreth tyre s'është askush. Ata flasin përherë për të njëjtat tema. Djemtë flasin për vajza dhe vajzat për djemtë.

Ato pandehin se jeta e tyre është shoku, shoqja, gënjeshtria, thashethemi, ndonjë telefonatë dhe kompjuteri... Atyre nuk u intereson as nëna dhe babai, as vëllau as motra, as mësuesi as familja, as problemet e shkollës, as papunësia, as varfëria dhe as çështjet e shtetit. Thuajse ka ardhur një planet i përbërë vetëm nga vajzat dhe djemtë.



Çdo vajzë dhe djalë i pëlqyer në këtë planet duhet të merret menjëherë. Kur të mërzhitet duhet të drejtohet tek tjetri apo tjetra. Pabesia është aq normale saqë të dalësh me njëren, një ditë tjetër të dalësh me një tjetër, bile të dalësh edhe me shokun e shokut më të ngushtë tashmë është bërë diçka normale...

Kur mësova nga të rinjtë se ç'kuptim kanë fjalët 'Të dalësh, të sillësh' me të vërtetë hyra në panik. Kuptimi i dhënë këtyre fjalëve për brezin tonë është shumë i ri. Unë mendoj se njerëzit e pjekur: nëna, babai, mësuesi – duhet të mendojnë shumë seriozisht për këto dalje dhe sjellje mes të rinjve dhe ata duhet të marrin masa penguese dhe mbrojtëse nga rreziku i këtyre akteve. Mendoj se po kalon koha për të qenë i vetëdijshëm për të kuptuar se deri në ç'skallë rrezikshmërie po shkon jeta e lirë e të rinjve. Të presësh më tepër e bën të pakuptimtë këtë situatë. Pasi **'Ngushëllimi i ardhur me vonesë i ngjan faljes pas varjes'**.

Duke qenë e zhytur në këto mendime, për një moment sjellja e vajzave të reja që hipin në autobus sikur u bënë kripë dhe biber i mendimit tim.

Trafiku i ngushtuar në çdo orë të ditës për shkak të punimeve të ndryshme nëpër rrugë që tashmë janë kthyer si përralla e gjarprit, thuajse ishte ndalur për shkak të motit me shi, makinat sikur ndiqnin njëra - tjetrën hap pas hapi. Çdokush ishte mërzhitur kur për një moment njëra nga vajzat e ulura prapa

filloi të fliste me zë të lartë:

- Tashmë unë nuk e dua Barëshin!!!. Më pas tjetra, dhe tjetra dhe me radhë të dashuruara i radhitën emrat e djemve të lënë.

Ato ishin të ulura prapa meje dhe flisnin me një zë aq të lartë, saqë jam e sigurtë që edhe ata të radhës së parë i dëgjonin. Dukej sikur po dëgjonim prapaskenat, por ato as që donin t'ia dinin. Pasi vetëm ato ishin të rëndësishme. Flisnin e flisnin pa mbarim dhe ne i kishim mësuar që të gjitha, sa djem kishte në shkollë, me emra, me kë dalin etj.

Më pas folën pak të emocionuara edhe për një djalë të ri simpantik që e kishin parë në stacionin e autobusit. Po dëgjoja e habitur bisedat që po bëheshin prapa meje. U ktheva dhe dëgjova dikë duke thënë: Ç'janë këto vajza kështu?

Atë moment ndjeva tronditjen e vërtetë. Vajzat që unë i pandehja se ishin në moshë të pjekur ishin nxënëse gjimnazi të moshës 13-14 vjeçe. Të gjitha ishin me uniformë. Ishin trupshkurtra, të dobëta dhe të rregulluara.

Më bëhej të thoja me gjuhën e tyre Si kështu?!

Desha të flisja me to, por ishte e pamundur pasi aq shumë ishin futur në botën e tyre dhe aq shumë e kishin marrë veten, saqë një ndërhyrje e imja e vogël do të çonte që ata të ngrinin krye dhe ndoshta të largoheshin me vite të tëra nga njerëzit e rritur dhe të pjekur. E pashpresë ktheva kokën.

Për momentin fillova të men-



doj ngjarjet që i kanë sjellë në këtë gjendje këta fëmijë. Filloi të më dhimbte tmerrësisht koka. E urreja pesimizmin tim dhe aq shumë kisha humbur, sa që për pak do të kaloja edhe stacionin ku do të zbritja.

Po mendoja se çfarë dhe si t'ua shpjegoja atyre. Prej ku nevojitej të fillohej? Ka aq shumë humnerë në mes. Sikur t'ua flisja këtyre të rejave për nderin dhe etikën jam e sigurtë se do të më shihnin me habi, kjo pasi koncepti i nderit aq shumë kuptime kishte ndryshuar mes të rinjve sa që është e pamundur të mos habitesh.

Këta fëmijë që nuk kanë marrë arsimin e nevojshëm nga familjet dhe institucionet arsimore dhe të cilët kalojnë kohën e lirë para ekranit të televizionit, filluan të ndiqnin serialele televizive të huaj për të rinjtë dhe më pas versionet vendase të tyre. Versionet vendase u bënë shka-tërruese pasi në këto seriale ata panë emrat e tyre, vendet dhe strukturën familjare të tyre, por ata që jetonin nuk ishin besimet dhe traditat e tyre. Kjo nuk ishte shumë e rëndësishme pasi ata që jetonin heronjtë e serialeve ishin shumë të bukura. Filloi të dukej normale të jetohej çdo gjë që jetohej në këto seriale. Në këtë kohë kur edhe nënat dhe baballarët filluan të ndiqnin këto seriale nuk mbeti as traditë, as zakon, as etikë dhe haram dhe hallall. Vetëm hedonizëm. Tashmë filluan të dukeshin nëpër rrugë edhe imitimet e heronjve të këtyre serialeve duke thënë: Unë jam i rëndësishëm. Unë jam i lirë të bëj ç'të dua.


Megjithatë sikur të gjeja një kohë dhe vend të përshtatshëm do të kisha shumë gjëra t'ju thoja këtyre të rinjve, madje fillova të mendoja që dëshiroja t'ua thoja

edhe ato gjëra që më erdhën në mendje për momentin, megjithëse e dija se do t'u vinte shumë rëndë.

Sikur të flisja

Kisha dashur ta filloja bisedën time duke u kujtuar fjalën: *'Është e vështirë të kuptosh vlerën e dy gjërave para se të rrëshqasin nga dora. Njëra është shëndeti dhe tjetra rinia'*.

Do t'ua tregoja se ishin vajza të hijshme dhe sa gjë e bukur dhe e këndshme është të jesh vajzë e re e aq më tepër është shumë e rëndësishme të jesh një



vajzë e re që shkon në shkollë. Sa shumë do të doja t'ua shpjegoja se fusha ku ato interesoheshin ishte një fushë e gabuar dhe se atyre u duhej të interesoheshin për mësimet dhe provimet dhe *'Ai që s'duron vështirësitë e arsimit mbetet injorant për gjithë jetën'*

Më pas do të doja t'ua kujtoja se ishte e nevojshme të dinin se e kishin kuptuar se dëshironin të ishin të lira, por liria e tyre ishte një liri e kufizuar me lirinë e tjetrit.

Do të kisha dashur t'ua thoja se e folura me zë të lartë në një

rreth shoqëror, atyre si vajza nuk u shkonte dhe se nuk ishte diçka e këndshme, sa të shqetësojnë edhe njerëzit e tjerë aty pranë dhe gjithashtu nuk është e hijshme të lejojnë të dëgjoen nga të tjerët gjërat e fshehta.

Do të dëshiroja t'ua theksoja se janë të reja për t'ua interesuar në lidhje me marrëdhëniet djalë-vajzë dhe se kur të vijë koha shpresoj se do të sillen më logjikshëm dhe më të menduara.

T'ua tregoja që sjellja e tyre pas dëshirave seksuale në mënyrë të palëkundshme mund t'i dëmtonte jo vetëm ato por edhe familjet e tyre.

Sa do të kisha dashur t'ua thoja 'Ju jeni vajza shumë të mira. Besoj gjithashtu se i besoni edhe Allahut. Pra ju jeni vajza myslimane, apo jo? Atëherë

Çdo fe ka një etikë të saj, edhe etika e Islamit është turpi.

Sa shumë do të dëshiroja t'ua thoja që këto fjalë të mos kuptoheshin gabim. Të njëjtat fjalë si për vajzat do të doja t'ua thoja edhe djemve që ndajnë të njëjtën jetë me vajzat. Pasi kur djemtë e një shoqërie nuk janë të moralshëm as gratë e asaj shoqërie nuk mund të jenë të tilla. Vallë a më kishin dëgjuar?!

Nuk shpresoj, pasi nuk jam e sigurtë që ne do t'i dëgjonim ato.

Sa bukur është shprehur Meolana:


'Sado që të dish, fjalët që thua janë aq sa të kuptojë personi me të cilin flet.'

'Fruti i papjekur asnjëherë s'mund ta kuptojë të pjekurin. Atëherë është e nevojshme që edhe fjalën ta presim shkurt...'

Plaga E Rinisë

Zbrazësia Shpirtërore

Përktheu dhe përshtati: Artur TAGANI



Njeriu është thesari më i rëndësishëm i një shteti dhe thesari i njeriut matet me kontributin që ka bërë për njerëzinë.

“Le të shikojë njeriu se çfarë ka bërë për të nesërmen”. {Sureja Hashr, 18}

“Çdo njeri e di se çfarë ka punuar dhe çfarë ka lënë prapa në atë botë!” {Sureja Infitar, 5}

Me këto versete Allahu i Madhëruar ashtu siç i tërheq vërejtjen njeriut për jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër, i kujton edhe të bëjë kujdes për **“ndërtimin e së ardhmes”** për brezat e rinj.

Gurët e së ardhmes vendosen që sot. Populli i së ardhmes formohet që sot. E ardhmja është e fshehur në zemrën e rinisë së sotme. Ç’mbjellim do të korrим. Mund të ujitësh si një pemë Tuba, pema që do jetë si shpërblim në xhennet për ata që kanë bërë vepra të mira., ashtu edhe një zakum, pema që do u jepet të ushqehen banuesve të xhehennemit....

Ashtu siç mund të rritet një shpëtimtar në zemrat e fëmijëve, mund të rritet edhe një kriminel... Grupmoshat e reja, nëse nuk rriten të shëndosha përbëjnë një rrezik, i cili mund të përhapet menjëherë, e nëse rritet e shëndoshë është një mundësi e re, një shi mëshirues...

Njeriu është thesari më i rëndësishëm i një shteti dhe thesari i njeriut matet me kontributin që ka bërë për njerëzinë.

Ndoshta, e gjithë rinia e botës është me probleme, ashtu siç thotë psikologu i njohur Jungu **“Nevroza e kohës sonë është një humbje shpirtërore kolektive”**, ndërsa shkencëtari i nderuar, psikiatri Kemal Sajari shprehët: **“Nuk shëtisin engjëjt mbi qytetin modern”**.

Por ne, ndonëse jemi të pajisur

me dritë që mund t’ia veshim zemrës së rinisë, ngaqë përballemi me probleme, ky realitet na dhemb më shumë. Kur kemi energji për t’i servirur një zemër të shëndetshme të gjithë rinisë së botës, të merresh me probleme është një veprim i ulët.

Sistemi MOBESE (sistem monitorimi) i vendosur në rrugicat e qyteteve si New York, Londra dhe Stambolli, i kontrollon dhe i monitoron rrugicat. Një sy në rrugica, në metro, në autobuzë e kudo. Terrori, plaçkitja, vjedhja e çdo faj, rrugën e zgjidhjes e gjeti si të thuash duke vënë një polic në krye të çdo njeriu. Gjithnjë po shtohet nevoja për besim të njeriut për të tjerët.

Një pyetje e tillë:

-A thua vallë, sikur të vidhnin të gjithë njerëzit, sikur çdo njeri të ushtronte dhunë me aq fuqi sa ka, çdo njeri të gënjente... çdo njeri, sikur të ishte ashtu siç thotë Kur’ani me gojën e engjëjve të merakosur **“gjakderdhës dhe ngatërrestarë”**... a do ishin të mjaftueshëm këta monitorues të rrugëve?

Po sikur të ishin ngatërrestarë dhe gjakderdhës ata që komandojnë kamerat... A thua do i duhej një MOBESE edhe vetë MOBESE-ve?

Pikëpamjet që e neglizhojnë zemrën, zgjidhjet që bëjnë sikur nuk e shohin besimin, orientimet laike që e anashkalojnë lidhjen me Allahun, mentalitetet shekullariste që përpiqen të ofrojnë



“etikë pa Zot e pa botë tjetër.” dhe ja grada që arritëm: Një monitorues për çdo njeri...

Kjo është frika e njerëzve nga njëri-tjetri..., sepse *“Njeriu është ujk i tjetrit”*, kur shkëputet nga normat hyjnore...

Le të ndalemi pak në Shqipëri:

Përse shteti ynë ka filluar të prodhojë **“rini të inkriminuar”**?

Çfarë u ndodhi zemrave të tyre të pandotura?

Si u vodhën, si u plaçkitën?

Çfarë nuk u dhuruam atyre ne, prindërit, shkollat, rrugët, ekranet, gazetatat...?

Apo, çfarë u dhamë që po ecin kështu mbi copëzat e xhamit?

Ju ndotën duart e tyre, këmbët në baltë u ranë, zemrave ju vendosën njolla të zeza...

Doli në pah çështja e **“rinisë së humbur”**, përse?

Ndoshta e kemi të vështirë t’a emërtojmë këtë proces

famëkeq..., sepse si popull, na u ngarkua një mision që t’i shpallim luftë recetave tona...

Duhet t’ua shpëtojmë zemrat e fëmijëve tanë, të rinjve dhe të rejave...

Me se do ua shpëtojmë?

Shërimi i kësaj nuk mund të bëhet nga mjekët e përgjithshëm. Kardiologu nuk mund të shërojë një zemër që ka papastërti, apo një zemër që ka prishur normat e saj. Nuk funksionojnë mjetet e kirurgut e as të neorologut. Duhet një eliksir tjetër, një tjetër mjek zemre, një tjetër ndërtues i mendjes...

“Feja le të qëndrojë në qoshe, ne ia pajisim mendjen, zemrën fëmijës!” Nuk ka një gjë të tillë. Materialet që do përdoren për ndërtimin e zemrës dhe të mendjes së njeriut janë ose nga Rahmani ose nga Shejtani.

Burimi i të bukurës është Rahmani dhe udhëzuesi i të shëmtuarës është Shejtani...

A është e shëmtuar gënjeshtër?

A është i shëmtuar krimi?

A është e shëmtuar vjedhja?

A janë të shëmtuara lëndët narkotike?

Duhet një “prodhues i vlerave” që t’u përcaktojë vlerat dhe t’u ofrojë.

Kush është ai?

Unë, ti, ai nuk është. Sikur t’i ngelin njeriut, ai do të konsumonte plot fjali figurative që njëra-tjetrën e kundërshton, që të shkarravitën...

Pastaj, kundrejt kujt është përgjegjësia?

Kundër fuqisë që ka ndërtuar MOBESE-në...sikur mos ta shihte MOBESE-ja? Aty mund të bësh ç’gjynah që dëshiron..., por duhet mpleksur me zemrat, ndjenja **“Të veprosh sikur e shikon Allahun, sepse sado që ti nuk e vë re, Ai ty të shikon”**.

Pa MOBESE, por nën mbikqyr-



jen e Zotit... Një zemër, një shpirt, një personalitet i veshur me këtë ndërgjegje. Është absurde të presësh ndonjë virtyt nga një zemër që është e boshatisur nga aspekti kuptimor.

Është e kotë të pritët ndonjë rreze nga një zemër që nuk është

vendosur ndonjë nur.

Nëse akoma nuk e ka vendosur sistemi arsimor se çfarë dhe përse po edukon, ose me misionin e tij ideologjik kërkon të edukojë "njeriun profan laik – të cilit i kanë marrë nga duart shenjtërinë, njeriun që është i shkëputur nga shenjtëria, që e ka hequr nga referimi henjtërinë", do të thotë që po mbillet erë dhe gjëja e vetme që do korret është stuhia.

Ja, fëmijët i ka zënë një stuhi e tillë, që para syve tanë kanë rënë në një anaforë që titullohet: **Zbrazëtia shpirtërore.**

Ja, kjo është fatkeqësia që ka përfshirë Shqipërinë, botën e çdo njeri u zbras zemrat njerëzve.

Kur'ani thotë:

"Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. E ata (djajt) do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse (jobesimtarët) mendojnë se janë duke i udhëzuar. E kur të vijë ai (jobesimtari) para Nesh, do të thotë: Ah, të kishim qenë larg mes vete sa Lindja me Perëndimin; sa shok i keq je ti!" Dhe sot, për shkak se ishit zullumqarë, shoqërimi juaj nuk do t'ju bëjë dobi në vuajtjet tuaja". {Sureja Zuhruf, 36-39}

Këto versete mund të mendohen edhe nga prizmi i kësaj bote edhe nga prizmi i botës tjetër... Miku i atij që nuk kujton Allahun është Shejtani, të cilin Allahu e cilëson si armikun e njeriut. Kur fillon të frymëzojë një njeri, ia robëron mendjen dhe e hedh **"më poshtë se kafshët"** bën të pamundurën që të bëjë egërsi të tilla që s'mund t'i planifikojë një kafshë.

Karakteri i fëmijës formohet brenda katërkëndëshit: familje, shkollë, rrugë, media...

Familja duhet të tregojë kujdes dhe përgjegjësi për to. Nëse prindi bëhet një jelek shpëtimi në zemrat e fëmijëve, atëherë ai mund t'a transformojë në të mirë shkollën, rrugën dhe median. Sistemi arsimor do përmisojë shtetin, qeverinë dhe median dhe kujdesi i prindërve do të sjellë sinjale të dobishme nga mesazhet që mbart fëmija. Do bëjë të mundur ndërgjegjësimin e secilit për pastrimin e pjesës së përparme të pragut të shtëpisë si një gjë mëse normale. Pastrimi i ajrit të fëmijëve që thithin nga rruga, nga shkolla e nga valët mediatike është bërë një detyrë jetike.

Nëse nuk dëshirojmë që të shndërrohen shkollat në burgje, stafi pedagogjik në gardianë, fëmijët në të akuzuar dhe prindërit në vizitorë të burgjeve..., nëse nuk duam që çdo ditë të shohim në sytë e fëmijëve me drojtje e me tension, nëse nuk jemi gëzohemi që të bijë në ndonjë kurth narkotik...

Duhet të trokasim më fort në portat e zemrës së shtetit...

Tek një fëmijë është i fshehur si një shpëtimtar ashtu edhe një kriminel..., derisa të gjejmë shpëtimtarin duhet t'i japim formë, që t'i shkruhet emri në histori...

Një ditë njeriut do i thuhet **"Shiko ç'ke dërguar në këto ditë"**. Ato që sot shohim janë dërgimet e së djeshmes. Ata na thërrasin nga batakaku ku kanë rënë **"Shiko, ç'po i dërgon së nesërme!"**.

Intervistë me Hirësinë e Tij, Osman Nuri Topbash

Etika: *Hirësia Juaj, e dini se revista Etika i drejtohet botës muslimane-shqiptare në Ballkan. Prandaj, për këtë numër menduam një intervistë me ju duke u nisur nga njohuritë e gjera historike, vëzhgimet dhe mbresat tuaja në lidhje me vëllezërit muslimanë shqiptarë. Siç e dini, shqiptarët dhe boshnjakët janë dy popuj të Ballkanit që e kanë pranuar si komb Islamit. Ç'rëndësi ka formuar për botën islame në kushtet e asaj dite pranimit të Islamit nga shqiptarët?*

O.N.Topbash: Me pranimin e Islamit, në të njëjtën kohë, vëllezërit shqiptarë morën për-sipër nderin e përfaqësimit të

botës islame në Ballkan. Besimi i tyre i sinqertë formoi themelin më të fuqishëm të Islamit në Ballkan. Në këtë mënyrë, vëllezërit shqiptarë formuan një portë orientimi dhe një dritare besimi të Islamit për botën perëndimore. Ata u bënë vend ekspozimi i Islamit në Europë, me shprehjen e sotme, u bënë vitrinë e tij.

Pema e besimit që lëshoi filiza në Medinen e Ndrirshme, hodhi rrënjë në Stamboll në formën e një qytetërimi madhështor dhe, pastaj, frytet më të mira në Ballkan i dha në fillim në Shqipëri, pastaj në Bosnjë-Hercegovinë.

Me këtë aspekt, vëllezërit tanë shqiptarë u bënë edhe fytyrë ndriçimi model për Europën, edhe kala kufitare, edhe avant-post i qytetërimit islam.

Duke i vënë në jetë në mënyrën më të bukur këto përgjegjësi historike dhe dinjitoze, gjyshërit tuaj dhe tanët sendërtuan një unitet zemre të mrekullueshëm. Pas ngadhënjimit të Kosovës nga sulltan Murati I, gjatë gjashtë shekujve, muslimanët shqiptarë me muslimanët turq jetuan në një klimë vëllazërore krejt të veçantë. Popullsia e urtë e Anadollit e vendosur në ato anë, bashkë me vëllezërit





Edhe poeti turk i Himnit Kombëtar, Mehmet Akifi, është shqiptar. Ka edhe shumë vëllezër shqiptarë që i kanë shërbyer kulturës islame dhe kanë dhënë kontributin e tyre në shumë fusha të ndryshme.

shqiptarë, me anë të cilësive të delikatesës dhe hijeshisë islame si dhe të imtësive përkatëse afektive, u bënë pretekst për orientimin e një pjese të konsiderueshme të popullsisë krishtere të atjeshme. Kështu, ata, bashkë me osmanët që përbëjnë faqe dinjitoze besimi të historisë, e mbajtën gjallë për gjashtë shekuj dinjitetin dhe shpirtin e Islamit në Europë dhe vazhdojnë ta mbajnë ende!

Etika: *Hirësia Juaj, siç e prekët edhe ju vetë, pasi e pranuan Islamën, shqiptarët jetuan së bashku dhe si një i vetëm me osmanët edhe si gjeografi, edhe si botë ndjesore e shpirtërore. Edhe nëse sot hartat kanë ndryshuar, uniteti ndjesor e shpirtëror i tyre vazhdon. A mund të na e shpjegoni këtë lidhje dhe marrëdhënie të fuqishme mes këtyre dy kombeve?*

O.N.Topbash: Siç e dini, os-

manët ishin një shtet i madh botëror i formuar nga bashkimi ndjesor i shumë kombeve nën një çati. Ndërkaq, siç e shprehëm pak më sipër, shqiptarët zinin një vend krejt të veçantë brenda kësaj strukture.

Shqiptarët qenë gjithmonë aktivë në organizimin dhe përbërjen e qytetërimit islam. Ky vitalitet dhe këto lidhje afektive ishin aq të fuqishme, sa që nga mëse 80 kryeministra të Shtetit Osman, afro 40 qenë shqiptarë. Për shembull, Mehmet Pasha i mbiquajtur Köprülü, i lindur më 1578 në fshatin Rudnik të sanxhakut të Beratit, ka qenë vetë kryeministër si dhe, më pas, i biri dhe i nipi. Pra, qysh nga ajo ditë, këta dy kombe janë si një puls i vetëm! Një shpirt i vetëm, një zemër e vetme dhe një mendim i vetëm! Ata kanë përbërë nga çdo anë një të tërë unike!

Edhe poeti ynë i Himnit Kombëtar, Mehmet Akifi, është shqiptar. Ka edhe shumë vëllezër shqiptarë që i kanë shërbyer kulturës islame dhe kanë dhënë kontributin e tyre në shumë fusha të ndryshme. Aq qemë shkrimë me njëri-tjetrin turqit dhe shqiptarët, sa, për shembull, jemi bërë dëshmitarë se si vëllezërit tanë shqiptarë në Kosovë e bënin turqisht njetin e faljes së namazit të të vdekurit.

Gjithashtu, një shembull domethënës është rasti i dëgjuar i Ali Jakup Hoxhës me origjinë shqiptare të cilit, duke zbritur nga qyteti në fshat, në Kosovë, i paksa thënë i ati që kishte mësuar në Medresenë e Fatihut në Stamboll:

- O bir, pa m'i numëro kushtet e turkllëkut!

Dhe ai ia paksa përmendur si kushte të turkllëkut, kushtet e Islamit:

- Agjërimi, namazi, zeqati, haxhi, Fjala e Dëshmisë!

Kjo ngjarje është vepër e mendësisë, sipas së cilës, "turk është e barabartë me musliman" ose, e shprehur ndryshe, "turk do të thotë musliman dhe anasjelltas"! Po kështu, edhe shqiptarët, pasi u bënë muslimanë, e shkruanë kombësinë brenda besimit dhe fesë, si rrjedhojë, u krijua konsiderata sipas së cilës, "shqiptar do të thotë musliman". Nga ana tjetër, siç dihet nga studimet dhe konsideratat historike serioze, identiteti besimor-fetar musliman i shqiptarëve jo vetëm s'e zbehu vetëdijen kombëtare shqiptare dhe identitetin kombëtar të shqiptarëve, por, përkundrazi, e forcoi atë dhe u bë mbështetja më e fuqishme e shqiptarëve për ruajtjen e kombësisë gjatë shekujve, veçanërisht për t'u dalluar si një komb krejt i pavarur dhe i ndryshëm nga kombet dhe kombësitë e tjera të Ballkanit! Kjo situatë cilësore është një shembull i mrekullueshëm i përvetësimit të Islamit reflektuar në traditë!

Një shfaqje e këtij uniteti mendësie mes turqve dhe shqiptarëve është edhe fakti që edhe sot, gjuha shqipe përmban një numër shumë të madh hua-zimesh turke!

Ja, pra, këto situata janë treguesit më të bukur të faktit se si turqit me shqiptarët, duke u brumosur së bashku, me anë të lidhjeve dhe marrëdhënieve të fuqishme, i kanë shërbyer Islamit!

Etika: *Hirësia Juaj, thatë se muslimanët-shqiptarë janë kombi që e ka përfaqësuar Islamën si popull në Europë dhe dhatë shembuj të fuqishëm të kësaj nga historia. Po sikur të vinim në ditët e sotme,*



ç'mund të thuhej për këtë?

O.N.Topbash: Nuk ka aspak nevojë për të folur gjerë e gjatë! Përgjigjja e kësaj është e njohur. Ashtu siç e patën realizuar dje përfaqësimin dhe mbrojtjen e Islamit në Europë, vëllezërit tanë shqiptarë në të njëjtën mënyrë janë duke e kryer këtë detyrë në ditët tona kur Islami ka hyrë në një periudhë të re rimëkëmbjeje. Siç pati ndodhur dje, edhe sot, shqiptarët janë para Europës një urë orientimi e fuqishme dhe dinjitoze, avanpost i qytetërimit tonë dhe serioziteti i personalitetit islam.

Po kështu, e provuan përsëri personalitetin e tyre të lartë në vitet e kaluara. Ata nuk iu përgjynjën despotëve serbë! U vranë, u plagosën, iu nënshtruan padrejtësisë dhe dhunës, por besimin dhe personalitetin e ruajtën! Kështu, ia shpallën dhe evidentuan edhe një herë tjetër botës personalitetin islam që përfaqësojnë!

Etika: *Hirësia Juaj, mesa dimë, keni pasur rast shumë herë t'i vizitoni Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë si zona ku jetojnë shqiptarët. Ç'mbresa keni marrë gjatë këtyre vizitave?*

O.N.Topbash: Secila nga vizitat që kam bërë në ato zona bartin për mua vlera të veçanta. Sa herë kam shkuar, jam bërë dëshmitar i faktit që dijet tona historike mbi shqiptarët vazhdojnë ta ruajnë të njëjtën gjallëri edhe sot. Kjo na ka bërë tejet të lumtur!

Entuziazmi shpirtëror i atyre vendeve, emocioni i shërbimit dhe bota ndjesore e sinqertë e njerëzve na japin neve ndjesinë se jemi në atdheun tonë. Mbushemi me kënaqësi e prehje shpirtërore sikur të ishim duke shëtitur nëpër Anadoll. Kjo kënaqësi e prehje e përçarur në të gjithë elementët moralolo-

shpirtërore e materialë, nga sjelljet gjer te arkitektura, si dhe vepërimitaritet mësimore-edukative të kryera për ta mbajtur gjallë e vazhduar atë, janë të denja për t'u miratuar dhe shpresëdhënëse për ditët që do të vijjnë!..

Etika: *Ju jeni një autor, veprat e të cilit, si në shumë gjuhë të botës, janë përkthyer edhe në shqip, ku lexohen me pëlqim e kënaqësi. Ju u jepni një rëndësi të veçantë veprimtarive botuese-emetuese në kushtet e ditëve të sotme kur komunikimi dhe arsim-edukimi mund të realizohen edhe me metoda dhe rrugë shumë të ndryshme. Cili është shkaku i kësaj? Pse janë të rëndësishme veprimtaritë botuese-emetuese?*

O.N.Topbash: Para së gjithash duhet të pohojmë se njeriu që nuk lexon e humb entitetin njerëzor, sepse njerëzorja tek njeriu fillon me respektimin dhe zbatimin e urdhrit "lexo!" Ajeti i parë i zbritur i librit të lartë i cili është udhëzues i orientimit në rrugën e drejtë dhe i jetesës i Islamit, fillon me këtë urdhër, pra, me urdhrin "lexo!"

Kombi që lexon është kombi i cili, gjatë gjithë historisë, e realizon në mënyrën më të bukur e më të fuqishme të vërtetën e themelimit të qytetërimit dhe ekzistencës. Dhe, për ta realizuar këtë, natyrisht, duhet të krijojë vepra që të kenë vlerën për t'u lexuar. Pastaj, shkëputjet, deviacionet dhe boshllëqet në fushat e qytetërimit, kulturës dhe moralit, të përjetuara në shekujt e fundit, shkaktuan plagë serioze në jetën e muslimanëve. U përjetua një periudhë shkëputjeje në çështjen e leximit dhe mësim-it të të vërtetave, e cila, në terminologjinë përkatëse të historisë së feve, quhet "fetret", "periudhë pa profet ose pa veprimtari orientuese profetike". Për rrjedhojë, e kemi të domosdoshme t'u japim rëndësi së bashku veprimtarive botuese-emetuese edhe

për të përballuar nevojat e sotme, edhe për të mbushur boshllëqet që dalin sheshit. Sepse çdo fushë e lënë zbrazur pushtohet nga tjetërkushi dhe bëhen përpjekje për t'i intriguar brezat tanë.

Nuk duhet harruar se veprimtaritë botuese-emetuese cilësore e të qëlluara janë, në mund të shprehemi kështu, si fabrika që përgatishin ushqim përjetësie për zemrat dhe shpirtrat. Veçanërisht në këtë kohën e mbrame të quajtur "ahirzaman", kur shpirtrat lihen të uritur, prodhimi ditë e natë i atyre fabrikave është një nevojë jetësore!

Etika: *Në numrin e shtatë të Etikës, ne po trajtojmë edhe temën e modernizmit dhe rinisë. Sot, mundësitë teknike që kanë përparuar dhe janë zgjeruar tejet, krahas dobisë, bëhen edhe burimi i shumë rrëshqitjeve morale e shoqërore. Pra, modernizmi e kërcënon në masë serioze edhe moralin e fëmijëve tanë dhe përbën një rrezik me rëndësi për të ardhmen. Ç'masa duhet të marrin brezat tanë të rinj përballë këtyre kërcënimeve dhe rreziqeve, për t'u bërë më të qëndrueshëm? Ç'gjëra duhet të kemi kujdes në këtë drejtim?*

O.N.Topbash: Zgjidhja më rrënjësore e kësaj është ta strukturojmë veten në entitetin e floririt të kulluar, sepse floriri e ruan veçorinë dhe vlerën edhe mes baltës, pa iu nënshtruar asnjë lloj ndikimi. Dhe rruga e kësaj, e shprehur më shkurt, kalon nga mbajtja fort pas Kur'anit dhe sunnetit, traditës së Profetit. Ata janë rrënjët që na ushqejnë neve shpirtërisht. Për sa kohë të mbetemi lidhur pas atyre rrënjëve, jetojmë në skenën e botës si një rrap i pamposhtshëm!

Nuk ka zgjidhje tjetër për t'u ruajtur nga të këqijat subjektive dhe sensitive të botës që globalizohet!



Qëndrueshmëria më e fuqishme përballë invazioneve denigruese që e rrënojnë shpirtin, është mbajtja fort pas besimit dhe fesë brenda kriterëve të principialitetit, sinqeritetit dhe devocionit që, në terminologjinë përkatëse, emërtohen, përkatësisht, ihlas dhe takva.

Dhe për këtë, edukimi mistik është kusht. Në sajë të këtij edukimi duhet arritur në gjendjen e zemrës së paqëtuar të cilësuar "selim". Duhet të bëjë përpjekje për t'u bërë shembull në mënyrë dinjitoze të bukurive shpirtërore të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), të sahabeve bujarë, të personaliteteve të shquara në lartësimin shpirtëror si dhe të etërve tanë të bekuar. Duhet të dimë që dyert që dalin për në mëkate, t'i mbyllim së pari në veten tonë, në zemrat tona, në vullnetin tonë! Në zemrën tonë duhet të ngremë avanposte morale dhe edukate që nuk i japin kalim imoralitetit!..

Kur t'i kemi arritur me sukses këto, bëhet e mundur të çlirohemi e të mbetemi të lirë nga çdo lloj ndikimi negativ!

Etika: *Ndërkaq, në këtë pikë, mund të themi se në çështjen e personalitetit model kemi boshllëqe të mëdha. Si duhet t'i mbushin këto boshllëqe të rinjtë tanë?*

O.N.Topbash: Këto personalitete modelë dhe monumentale do të formohen gjithmonë vetvetiu në atë masë sa të kapemi e të mbahemi pas Kur'anit dhe Sunnetit. Siç ka ndodhur në të kaluarën tonë, po qe se zelli dhe përpjekjet bëhen të mëdha, nuk formohet boshllëk jo vetëm në këtë, por në asnjë specifikë!

Mbi të gjitha, jeta e Profetit (s.a.s.) është e njohur për ne në mënyrën më të hollësishme sikur të jetonim në ato ditë. Prandaj, në këtë pikë, biografia pro-



fetike është modeli më ideal për ne. Ajetet dhe hadithet, me përvojën e jetës së tij, janë pothuaj një shembull personaliteti konkret! Në të njëjtën kohë, janë miqtë e Zotit të cilët e bëjnë atë shembull personaliteti të shfaqet tek ta. Ata janë për ne pasqyrat më të mira që pasqyrojnë jetën, moralin, adhurimin dhe vetitë e larta të Profetit (s.a.s.). Po qe se e shohim të vërtetën për të cilën po flasim duke vështruar në këto pasqyra të pastra e të çmuara, nuk përjetojmë asnjë boshllëk modeli në strukturimin e personalitetit tonë.

Etika: *Hirësia juaj, a ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni si të fundit?*

O.N.Topbash: Si të fundit, dëshiroj të them këtë: Gjyshërit tanë dhe tuaj jetuan zemër për zemër gjatë gjithë historisë, duke u vënë sup më sup përballë armikut në çdo betejë, veçanërisht në Çanakala, u vunë gjoksin sulmeve të përgjakura. Dy kombet e dy popujt tanë u bënë një zemër e vetme. Lutjet dhe përpjekjet tona janë që kjo lidhje dhe ky unitet historik të vazh-



Po kështu, e provuan përsëri personalitetin e tyre të lartë në vitet e kaluara. Ata nuk iu përgjunjën despotëve serbë! U vranë, u plagosën, iu nënshtruan padrejtësisë dhe dhunës, por besimin dhe personalitetin e ruajtën!

dojnë gjer në kiamet! Sepse për këtë kemi nevojë gjithmonë...

Etika: *Hirësia Juaj, ju paraqesim falenderimet tona të sinqerta për këto shpjegime të bukura dhe për të vërtetat që parashtruat!*

O.N.Topbash: Edhe unë ju falenderoj dhe ju uroj suksese në rrugën e shërbimit ndaj qëllimeve dhe bukurive të larta!

Roli i Rinisë Në Kohën E Pejgamberit (S.A.V)

Asist. Doc. Sejfullah KARA

Koha e rinisë është koha më dinamike në të cilën njeriu është shumë i lëvizshëm dhe plot energji. I riu, për të harxhuar energjinë që zotëron e ka të nevojshme që të lëvizë shumë. Në kohën e rinisë, njeriu është i aftë të bëjë shumë gjëra. Po t'i jepet mundësia mund të arrijë suksese të mëdha në fusha të ndryshme. Tek i riu gjithmonë gjenden forca dhe aftësi për të kryer detyrat që i ngarkohen, por e rëndësishme është që të zbulohen këto aftësi tek ai, të zhvillohen dhe sipas këtyre aftësive t'i jepen detyra në mënyrë që të dalë në dukje talenti i tij.

Këtë gjë mund ta shohim më së miri në kohën e Pejgamberit (s.a.v). Ai (s.a.v) i ka marrë para-

sysh dhe i ka vlerësuar shumë aftësitë e të rinjve dhe sipas këtyre aftësive ju ka dhënë detyra të ndryshme në çdo fushë si nga thirrja në Islam deri në postet më të larta shtetërore dhe këta të rinj, të zgjedhur nga Pejgamberi (s.a.v) nuk e zhgënjyen asnjëherë Atë (s.a.v), por përkundrazi i kryen me përpikmëri të madhe detyrat që ju ishin ngarkuar. Detyrat që u jepeshin këtyre të rinjve ishin të ndryshme dhe të rëndësishme si p.sh: Prefekturë, sekretari, gjykatë, udhëheqje ushtarake, mbajtje flamuri, ruajtje e rendit, financë, mësuesi ... etj.

Pejgamberi (s.a.v) ka thënë: *"Koha më e mirë është koha në të cilën gjendem unë"*. (Buhari)

Ai (s.a.v) i ka lavdëruar sahabët (shokët e tij) një nga një, por nuk duhet harruar se të rinjve u ka dhënë një rëndësi të veçantë dhe këtë e gjejmë të pasqyruar në thënien e tij: *"Mua më është dhuruar ndihma e të rinjve"*.

Gjatë gjithë historisë së Islamit të rinjtë kanë luajtur një rol shumë të madh. Nëse studiojmë me kujdes kohën e Pejgamberit (s.a.v) vërejmë se të rinjtë e kanë pranuar më me lehtësi dhe më me dëshirë Islamin sesa të moshuarit, prandaj shumica e myslimanëve të parë përbëhet nga të rinjtë. Aq shumë ka patur prej të rinjve që e kanë përqaftuar Islamin, sa që grupi i myslimanëve të parë që emigruan nga Mekka në Medine përveç Ubejd





bin Haris, i cili ka qenë i moshuar dhe dy - tre të tjerë ishin të rinj nën moshën tridhjetë vjeç. Të rinjtë e familjeve të mëdha dhe të njohura nxituan në pranimin e Islamit dhe pikërisht këta të rinj kanë qenë ata që nuk e kanë lënë për asnjë moment vetëm Pejgamberin (s.a.v) edhe në momentet më të vështira të jetës së Tij i kanë qëndruar afër dhe e kanë mbështetur vazhdimisht.

Një ndër këta të rinj është edhe Ali bin Ebi Talib (r.a).

Aliu (r.a) para Islamit qëndronte në shtëpinë e Pejgamberit (s.a.v). I ati i tij Ebu Talib edhe pse e pat mbrojtur shumë Pejgamberin (s.a.v) nga mushrikët (idhujtarët), nuk arriti të bëhej mysliman, por Aliu (r.a) është ndër të parët që e ka pranuar Islamin në një moshë fare të re, në moshën dhjetë vjeç. Edhe vëllai i tij Xhafer bin Ebi Talib (r.a) ka qenë ndër myslimanët e parë, rreth moshës njëzet vjeç. Gjithashtu edhe gruaja e Xhaferit (r.a) ka qenë ndër të rejtat e para që ka pranuar Islamin.

Një ndër myslimanët e parë që e ka pranuar Islamin në moshë të re dhe që Pejgamberi (s.a.v) e ka quajtur "ndihmësi im" është edhe Zybejr b. Avvam (r.a). Kur u bë mysliman ai nuk ishte më tepër se 12 vjeç. Duhet të përmendim këtu edhe të riun Habbab b. el-Eretin (r.a), i cili ishte ndër myslimanët e parë që përjetuan vuajtjet e shumta në fillimin e përhapjes së Islamit në Mekke, ndërsa mosha e tij ishte vetëm 16 vjeç dhe ky pranohet si personi i gjashtë që ka pranuar Islamin. Gjithashtu ndër myslimanët e parë është edhe i riu Osman b. Maz'un (r.a), i cili numërohet si myslimani i

katërmbëdhjetë. Edhe vëllai i tij Kudame b. Maz'un (r.a) ishte ndër myslimanët e parë dhe mosha e tij ishte rreth njëzet vjeç. Po kush nuk mbeti pa u futur në karvanin e të rinjve të parë myslimanë!

Ata janë të shumtë, ndër ta mund të përmendim edhe:

- I riu **Sa'd b. Ebi Vekkas (r.a)**, i cili e hapi zemrën për të pranuar mesazhin e Pejgamberit (s.a.v) në moshën 19 vjeç;

- **Talha b. Ubejdullahun (r.a)**, i cili e bëri trupin e tij mburojë për Pejgamberin (s.a.v) në luftën e Uhudit. Kur e pranoi Islamin nuk ishte më tepër se 14 ose 18 vjeç;

- **Abdullah b. Mesudin (r.a)**,



i cili u bë mysliman rreth moshës 16 vjeç. Ky sahab i nderuar edhe pse në një moshë shumë të re dhe me një fizik të dobët, pasi u bë mysliman, me një guxim të paparë, mori Kur'anin dhe e lexoi në mes të idhujtarëve të Mekkes;

- **Erkam b. Ebil-Erkamin (r.a)**, i cili ishte rreth 17-18 vjeç kur e pranoi Islamin, shtëpia e të cilit u bë vend mësimi për myslimanët e atëhershëm;

- **Said b. Zejd (r.a)**, i cili në kohën e emigrimit ishte rreth 20 vjeç dhe gruaja e tij Fatimja, e bija e Hattabit që ishte përafërsisht në të njëjtën moshë;

- **Vajza e Ebu Bekrit Esmaja**

(r.a), e cila ishte 17 vjeçe kur u bë myslimane; **Mus'ab b. Umejr (r.a)**, i cili la në një anë pasurinë e nënës së tij dhe duke ju bërë ballë të gjitha vështirësive dhe vuajtjeve, ia dedikoi veten thirrjes që solli i Dërguari i Allahut (s.a.v) dhe në fund ra shehid (dëshmor) në luftën e Uhudit, gjë e cila e bëri të lotojë edhe Atë (s.a.v) dhe shumë të rinj të tjerë që nuk do të arrijmë t'i përmendim të gjithë këtu.

Këtu duhet të theksojmë se nuk ishin vetëm të rinjtë e Mekkes që e pranuan Islamin, por ishin edhe të rinjtë e Medines që e pranuan Atë para të moshuarve. Siç e dimë Medinasit ishin ata që i hapën dyert e tyre për Pejgamberin (s.a.v) në momentet më të vështira të jetës së tij, për të cilët Ai (s.a.v) ka thënë: "*... Kush i do ata (Ensarët) edhe Allahu do i dojë, dhe kush nuk i do edhe Allahu nuk do ti dojë*".

Gjithashtu Ai (s.a.v) thotë: "*Sikur Ensarët të merrnin një rrugë edhe unë do shkoja në atë rrugë. Sikur të mos ishte emigrimi (hixhreti), do dëshiroja të isha një nga Ensarët*".

Të parët e Medinasve që u nderuan me Islam, të këtyre njerëzve që i Dërguari i Allahut i ka vlerësuar aq shumë, ishin pikërisht të rinjtë. Njëlloj si në Mekke edhe në Medine kishte të rinj, të cilët e kishin përqaftuar dhe e mbrojnë Islamin, ndërkohë që ballarët e tyre e kundërshtonin atë. Ndër shembujt më tipik të këtij lloji mund të përmendim Handhalen (r.a), i cili ishte i biri i një prej të parëve dhe prej të respektuarve të Me-dinës që quhej Ebu Amir, i cili nga xhelozia dhe mendjemadhësia nuk e pranoi Pejgamberin (s.a.v) si i Dërguar i Allahut, por i biri i tij Handhale e pranoi Islamin dhe ishte shumë i afërt me Pejgamberin (s.a.v).

Handhale (r.a) mori pjesë në luftën e Uhudit ku luftoi trimërisht derisa ra shëhid (dëshmor), trupin e pajetë të të cilit e kanë larë engjëjt. Mund të përmendim këtu edhe Abdullahun, i cili ishte i biri i Abdullah b. Ubejj, ku ky i fundit njihej si i pari i munafikëve (dyftyrëshve), i cili shfrytëzonte çdo mundësi për tu tallur me Pejgamberin (s.a.v) dhe për të përçarë myslimanët, por i biri i tij Abdullahu (r.a) u bë mysliman i fortë.

Të rinjtë e Medines që kishin pranuar Islamit nuk ishin vetëm këto të dy. Mund të përmendim: Es'ad b. Zurare (r.a), i cili e pranoi Islamit tre vite para emigrimit në Mekke, ku ishte kryetari më i ri i grupit që gjendej në Akabe.

Gjithashtu në Akaben e dytë ndër ata që i dhanë besën Pejgamberit (s.a.v) ishin edhe:

- I riu 13-14 vjeçar Ukbe b. Amr (r.a);
- 15 vjeçari Xhabir b. Abdillahi (r.a);
- 24 vjeçari Mesleme b. Selame (r.a);
- Muadh b. Amr (r.a), i cili shumë kohë para babait të tij i dha fjalën Pejgamberit (s.a.v) se do ta mbronë Atë (s.a.v) ..., si dhe shumë të rinj të tjerë.

Siç e shohim në Medine shumë të vjetër duke qenë në shirk (mosbesim), shumë prej bijëve apo nipërve të tyre i dhanë fjalën të Dërguarit të Allahut (s.a.v) se do ta respektonin dhe do ta mbronin Atë (s.a.v).

Të gjitha këto gjëra na tregojnë se, të rinjtë kanë qenë ato, që e kanë ndihmuar dhe çuar përpara Islamit. Ose e thënë ndryshe, Islami është lartësuar nga të rinjtë dhe ka arritur sukses të shumta me to. Duhet të



Të gjitha këto gjëra na tregojnë se, të rinjtë kanë qenë ato, që e kanë ndihmuar dhe çuar përpara Islamit. Ose e thënë ndryshe, Islami është lartësuar nga të rinjtë dhe ka arritur sukses të shumta me to.

dihet, se edhe sot nëse Islami do t'ju shpjegohej njerëzve ashtu siç duhet, të parët që do ta përqafojnë atë do të ishin përsëri të rinjtë, sepse Islami me mesazhet e tij universal dhe njerëzor i mahnit njerëzit në përgjithësi dhe të rinjtë në veçanti.

Një ndër çështjet që duhet të dihet është, se këta të rinj nuk u bënë besimtarë vetëm me fjalë, por me vepra duke u lidhur me Pejgamberin (s.a.v) me një lidhje të fortë dhe duke u bërë shembuj

të paarritshëm, në aspektin e besës dhe besnikërisë. Me të vërtetë ka qenë rinia, e para që e ka pranuar Islamit dhe po këta të rinj ishin ata që u treguan të gatshëm për ta mbrojtur atë. Që nga koha e fillimit të thirrjes dhe të përplasjes së Pejgamberit (s.a.v) me mushrikët, Ai (s.a.v) është mbrojtur nga të rinjtë me një përkushtim dhe guxim të madh.

Transmetohet, se Pejgamberi (s.a.v) i thirri të afërmit e tij për t'u bërë atyre të ditur haptazi thirrjen në Islam. Në këtë rast Ai (s.a.v) u bëri thirrje për të pranuar Islamit, por të pranishmit jo vetëm që se pranuan, por e kërcënuan për këtë. Në momentin kur ata u bënë gati të shpërndaheshin u ngrit në këmbë Aliu (r.a) duke thënë: *"Mendimi im është i shkurtër, krahët e mi janë të dobët dhe mosha ime është më e vogël nga të gjithë ju këtu, por megjithatë unë do të jem me ty dhe do të të mbroj o i Dërguari i Allahut"*.

Të pranishmit qeshën kur e dëgjuan këtë. Në atë kohë Aliu (r.a) ishte vetëm 13 vjeç (r.a), pra në fillimin e rinisë së tij. I njëjti Ali (r.a) në moshën 20 vjeç duke ditur fort mirë se mund të vritej, fjeti në shtratin e Pejgamberit (s.a.v) në kohën kur mushrikët kishin bërë plan që ta vrisnin, kështu Ai (s.a.v) e shpëtoi nga vrasja e armiqve të tij dhe mundësoi emigrimin e Atij (s.a.v) pa probleme.

Nëse thuhet se, Ali (r.a) e ka shpëtuar Pejgamberin (s.a.v) ngaqë ka qenë i afërm i Tij (s.a.v), kjo nuk është e saktë, sepse edhe Ebu Lehebi ka qenë i afërm i Atij (s.a.v), por ju kujtojmë se ai ka qenë ndër ata që e kanë munduar më shumë Muhammedin (s.a.v), prandaj sakrifica që bëri Aliu (r.a) nuk ishte për shkak të afërsisë së gjakut, por sakrificës e forcës së imanit.

Gjithashtu përpjekjet që bëri

Talha b. Ubejdullah në luftën e Uhudit për të shpëtuar Pejgamberin (s.a.v) nuk mund të vlerësohet me fjalë. Ai duke zgjatur duart e tij për të penguar shpatat që të mos dëmtonin Pejgamberin (s.a.v), u bë mburojë për Të (s.a.v) derisa ia prenë dorën dhe mbeti sakat. Megjithë mbrojtjen që u mundua t'i bënte Talha (r.a), Pejgamberi (s.a.v) ishte në një gjendje të vështirë derisa edhe u plagos, atëherë Talha e kapi Atë (s.a.v), e vuri mbi shpinën e tij dhe e hypi mbi një shkëmb të madh duke ia shpëtuar jetën Atij (s.a.v), i cili për këtë rast i tha Ebu Bekrit (r.a):

“O Ebu Bekir! Sot xhenneti u bë vaxhib për Talhan”. (Buhari)

Abdullah b. Zejd (r.a), ka qenë njëri prej dy djemve të gruas sahabi, Ummu Umare (r.a). Ai me qëndrimin shumë afër Pejgamberit (s.a.v) në luftën e Uhudit duke e mbrojtur, pat fituar lëvdatat dhe vlerësimin e Atij Zotni (s.a.v). Nga besnikëria dhe trimëria që tregoi Abdullahu dhe familja e tij, Pejgamberi (s.a.v) u lut për ta që të ishin komshi në xhennet me Të.

Gjithashtu lidhja e djalit tjetër i Ummu Umares, Habib b. Zejdit (r.a) me Pejgamberin (s.a.v) ishte shumë e madhe. Kjo lidhje e fortë e ngriti atë në gradën e shehidit (dëshmorit). Pejgamberi (s.a.v) e dërgoi atë kundër Musejlemetul-Kedhdhab që e kishte shpallur veten si profet, por Musejleme arriti ta kapte Habibin dhe e pyeti nëse besonte apo jo në Muhammedin (s.a.v) si i Dërguari i Allahut. Habibi dëshmoi dhe deklaroi profetësinë e Muhammedit (s.a.v), pastaj Musejleme e pyeti për veten e tij nëse e besonte apo jo se ishte Profet. Habibi kësaj pyetjeje iu përgjigj: *“Unë jam i shurdhër, nuk të dëgjoj ty”*. Kjo pyetje dhe e njëjta përgjigje iu përsërit disa herë. Për çdo përgjigje Musejleme i priste Habib-

it nga një pjesë të trupit. Dhe në këtë mënyrë, duke iu prerë pjesët e trupit një nga një, Habibi u bë shehid. (Ibnu Abdilber)

Ai (r.a) nga imani, dashuria dhe lidhja e fortë që kishte me Pejgamberin (s.a.v), për të mos mohuar Profetësinë e të dashurit të tij dhe të mbarë myslimanëve, Muhammedit (s.a.v), pranoi që të jepte jetën e tij në një mënyrë të tmerrshme duke u coptuar pjesë - pjesë.

Mushrikët (idhujtarët) e Mekkes, në kohën kur nuk e lejonin Pejgamberin (s.a.v) të hynte në Mekke i çuan fjalë të parit të Mynafikëve Abdullah b. Ubejjes, se nëse dëshironte mund të shkonte në Mekke dhe të bënte tavaf Qaben. Kur e dëgjoi këtë i biri i tij, Ibn Abdullah iu drejtua të atit duke i thënë:


- Ti do të shkosh të bësh tavaf Qaben pa e bërë i Dërguari i Allahut (s.a.v)?! Nëse e bën një gjë të tillë Allahu do ta shfaqë dyfytërsinë tënde haptazi dhe do të turpërohesh.

Ibn Abdullah që ishte shumë i lidhur me Pejgamberin (s.a.v) i solli shpinën të atit e i tha:

- Unë nuk do ta bëj tavaf Qaben pa e bërë i Dërguari i Allahut.

Kjo sjellje e Ibn Abdullahut i pëlqeu shumë Pejgamberit (s.a.v). Kështu që ky i ri, nga dashuria e madhe që kishte për të Dërguarin e Allahut (s.a.v) i ktheu shpinën babait të tij dyfytëresh dhe e shfaqti haptazi dashurinë dhe respektin që kishin për Atë (s.a.v).

Në kohën e Pejgamberit (s.a.v) rinia myslimane ka qenë aq e lidhur me Të (s.a.v) sa që ishin të gatshëm të jepnin edhe jetën e tyre për të Dërguarin e Allahut (s.a.v). Këtë e shohim më së miri në marrëveshjen e Hudejbijes, ku myslimanët i dhanë besën Pejgamberit (s.a.v) dhe i pari që e dha besën ishte një 20 vjeçar që quhej Ebu Sinan el-Esed (r.a), por ky nuk ishte i vetmi prej të rinjve që ia dhanë besën Pejgamberit (s.a.v). Kishte edhe shumë të tjerë. Ndër to



mund të përmendim: 20-vjeçarin Abdullah b. Ebi Evfa (r.a); 17- vjeçarin Abdullah b. Jezid el-Hatmi (r.a); 16- vjeçarin Abdullah b. Umer b. Hattab (r.a) ... dhe shumë të tjerë që i dhanë besën të Dërguarit të Allahut, se nuk do ta kursenin jetën e tyre për Allahun (xh.xh) dhe të dërguarin e Tij (s.a.v).

Të gjithë këto na tregojnë se të rinjtë e asaj kohe jo vetëm kanë besuar, por kanë qenë të gatshëm të japin edhe jetën e tyre për këtë besim. Ndjenjat e pastërta të të rinjve, mospajtimi me padrejtësitë si dhe të qenurit të gatshëm dhe të përshtatshëm për të pranuar mendimet universale, kanë bërë që këta të rinj të pranojnë thirrjen e Pejgamberit (s.a.v) pa mëdyshje dhe ky është edhe shkaku që shumica e myslimanëve të parë kanë qenë të rinjtë.

Ndërsa shumica e të vjetërve, në të kundërtën e besimit dhe dorëzimit të këtyre të rinjve, nuk hoqën dorë nga besimet e tyre të vjetra. Ata nuk mbetën me kaq por u munduan me gjithë mundësitë që kishin, për t'i penguar këta të rinj nga rruga që kishin zgjedhur. Këta të moshuar i mbyllën veshët e tyre për të mos e dëgjuar këtë mesazh universal dhe nuk arritën të shpëtonin veten e tyre nga bestytnitë e vjetra duke mbetur të mbyllur në kallëpet e tyre të ngushtë dhe nuk arritën dhe nuk dëshiruan të dilnin prej aty, sepse ata në mjedisin ku jetonin kishin arritur në një farë makami (postë) dhe kishin frikë se mos i humbisnin ato poste, duke pranuar besimin e ri. Kishte prej të rinjve që e kishin pranuar Islamin ndërsa baballarët e tyre ishin në poste të larta, por këta të rinj edhe pse ishin të bijtë e njerëzve me pozitë, nuk vonuan në pranimin e mesazhit që solli Pejgamberi (s.a.v). Për këta të rinj nuk ishte i rëndësishëm postë apo fitimet e tjera, por i rëndësishëm ishte mesazhi universal, hyjnor. Mesazhet e njerëzishme, rregullat hyjnore dhe universale që solli Islami, kur u ndeshën me këta të rinj, bëri që këta të rinj të rrjedhin si lum për në Islam. Të rinjtë, besimet e gabuara dhe padrejtësitë e kohës së injorancës i hodhën pas shpine dhe mesazhin hyjnor e bënë si qëllimin e vetëm të tyre. Në këtë mënyrë Pejgamberi (s.a.v) me një sukses të madh arriti që këta të rinj t'i bëjë për vete. Pas gjithë këtyre mund të themi se Islami është përhapur duke pasur në themel të tij lëvizjen dhe vullnetin e të rinjve.

Në përhapjen e Islamit në të gjithë Arabinë dhe më gjerë, ka një rol të madh dinamizmi dhe besimi i fortë i të rinjve. Prandaj është shumë e rëndësishme që të përgatitim të rinj me besim dhe t'i mësojmë ata që të sakrifikojnë për këtë besim. Një rini e tillë nuk është e rëndësishme vetëm për ummetin Islam, por është e rëndësishme për mbarë njerëzinë, sepse me paraqitjen e mesazhit universal të Islamit, me anën e të rinjve me besim të fortë dhe të vetëdijshëm, do të shpëtonte faqja e dheut, e cila është e lagur nga lotët dhe gjaku, që e ka kapluar në çdo anë, në ditët e sotme. Nuk ka dyshim që qetësia, paqja dhe lumturia e kërkuar nga të gjithë njerëzit, arrihet nga të rinjtë e përgatitur mirë.



Ndjenjat e pastërta të të rinjve, mospajtimi me padrejtësitë si dhe të qenurit të gatshëm dhe të përshtatshëm për të pranuar mendimet universale, kanë bërë që këta të rinj të pranojnë thirrjen e Pejgamberit (s.a.v) pa mëdyshje dhe ky është edhe shkaku që shumica e myslimanëve të parë kanë qenë të rinjtë.

Këshillat E Mia Për Të Rinjtë

Prof. Dr. S. Mehmet SHEN

- Mësojeni vetë Islamin, duke lexuar disa herë bu-
rimet themelore që vite me
radhë nuk i vjetëruan dhe
jo nga njerëz që nuk u është
provuar dija, përvoja, gjyki-
mi, vullneti dhe horizonti.
Do të shihni që do mësoni
t'i shihni dhe gjykoni çësht-
jet në aspektin e Islamit dhe
që për çdo temë do të jeni
në gjendje të prodhoni
zgjidhje. Aq e lehtë është kjo
në ditët tona saqë... Aman
mos ia dorëzoni veten
njerëzve që s'kanë emocion
dhe ngatërresë, që s'kanë
vullnet dhe që kanë një
botëkuptim të cënuar.

- Qëndroni pas dijeve që
arrijnë kohën dhe që do t'ju
bëjnë të sundoni mbi sendet.
Bëhuni miq të ngushtë me
kompjuterin dhe rriteni këtë
miqësi dhe përpiquuni të më-
soni përherë gjëra të reja me
kusht që të jeni të dobishëm
duke shkuar në çdo vend ku
mund të shkoni me të. Kjo
do t'ju çojë në një shkallë të
caktuar edhe në fusha të tjera
të caktuara jashtë profesionit
tuaj dhe do të jeni një person
i kërkuar edhe në ato fusha
ku njerëzit kanë nevojë. Du-

het të dini që përderisa të
mos arrini ta plotësoni kom-
pjuterin do të jetë e pamun-
dur që të shpëtoni nga të
kapërdimurit e kripës dhe
nga mbledhja e patkuajve.

- Jeta juaj nuk është aq e
gjatë derisa të keni etje. Për
këtë arsye, duhet të dini që
nuk keni të drejtë t'u shman-
geni atyre që dini dhe sipas
kësaj edhe duhet të silleni.

- Mos u bëni si uji i vërshi-
meve që ka ujë të
bollshëm, që rrjedh me zhur-
më dhe që merr përpara çdo
gjë që i del përpara. Bëhuni
si përronjtë që rrjedhin pa
zhurmë, të qetë dhe ngadalë
-ngadalë, në mënyrë që
njerëzit, kafshët dhe bimët
ta shuajnë etjen pikërisht
nga ky përrua.

- Mos u bëni të lirë, pasi siç
i thotë një fjalë: nuk bëhet
jahni me mish të lirë. Mbani
lart ndihmën tuaj dhe mos
kërkoni suksese që arrihen
lehtë. Djeni që sukseset e leh-
ta shkojnë lehtë.

- Mos e ngrini grushtin me
të cilin s'mund të godisni;
mos e tregoni dhëmbin me

të cilin s'mund të kafshoni
dhe mos u ngrini nga vendi
, ku s'do të mund të uleni.
Mos harroni që myslimani
është njeriu i qetësisë dhe jo
i ngatërresës dhe përplasjeve.

- Rruga e të qenurit njeri i
kërkuar kalon nga të qenurit
njeri që kërkon. Këtë djeni
kështu dhe kurrë mos e ha-
rroni.

- Nëse jeni i gatshëm për
t'u mashtruar ju mashtron
kushdo qoftë, prandaj kontro-
lloni shpeshherë veten në
mënyrë që të shpëtoni nga
mesi i mashtruesve të përher-
shëm.

Dhe fjala e fundit:

Nëse s'mund të arrini gjërat
që njerëzit i vlerësojnë nuk
mund t'ju jepni atyre gjërat
që vlerësoni ju, pasi ata nuk
marrin asgjë nga ju, ashtu
sikurse sot që askush nuk
merr gjë nga ummeti Islam...

Kulturë Gjuhë

Ma. Irida HOTI

Prill
Maj
Qershor
2007 | 7



ETIKA

Kanë thënë për gjuhën:

Njësia e gjuhës është njësia e kombit.

Aleksandër Xhuvani

Gjuha është pasqyrë e mendjes.

Noam Chomsky

Më jepni një gjuhë të mirë t'ju jap një qytetërim fort të mirë.

Wilhem Gottfried Leibniz

Prano çdo gjë që një folës i një gjuhe thotë në gjuhën e vet, por asgjë nga ato që ai thotë për gjuhën e vet.

Bloomfield

Fakti që mund të mendojmë apo rezonojmë pa gjuhë është iluzion.

Edward Sapir

Rrjedha e vërtetë e gjuhës nuk është tregues i të menduarit.

Edward Sapir

Gjuha është burim i dijes.

Shtjefën Gjeçovi

Gjuha nuk e ka parë kurrë mendimin.

Paul Valeri

Gjuha lidhet me përparimin mendor të njeriut.

Sami Frashëri

Një shoqëri zbulohet përmes pamjes së gjuhës.

Arthur Rembo

Një popull nuk shkatërrohet deri sa flet, mendon dhe ndien gjuhën e vet amtare.

L. Vukçeviç

Puna e gjuhës është punë e shenjtëruar.

K. Kristoforidhi

Të begatojmë gjuhën dhe kombin tonë me kulturë dhe qytetërim.

Petro Nini Luarasi

Të dish shumë gjuhë do të thotë të kesh shumë çelësa për një dry.

Volter

Të falem ty o gjuhë e fisit tim!

Mitrush Kuteli

Rinia Dhe Arsimi

Përktheu dhe përshtati: Evans DRISHTI

Të vjetrit thonë “Shpjegimi është gjysma e shkencës”, kështu që edhe unë humbjen e qytetërimit shpeshherë e lidhi me humbjen dhe mungesën e shpjegimit prandaj dhe mërzitem. Unë mendoj se shpjegimi, është dera e hyrjes së shkencës. Urdhëri i përcaktuar në Kur’an “Në shtëpitë tuaja hyni nga dera” thujse na bën thirrje për shpjegim. Shpjegimi është sikurse përshëndetja në fillim të bisedës. Mua më duket sikur urdhëri peygamberor “Përhapni selamin” që na jepet me gjuhën peygamberore në të njëjtën kohë na bën thirrje që të përhapim edhe shpjegimin... Përveç kësaj Allahu i Lartë Ademit i mësoi të gjithë emrat e sendeve, pra ia mësoi një e nga një shpjegimet e emrave dhe më pas Atë me melekët e çoi në sheshin e provimit që do të bëhej. Me të vërtetë, peygamberi ynë, vazhdimisht u ka dhënë shpjegime të dhura njerëzve që dëshironin të mësonin se *ç’është besimi?, ç’është Islami?, kush është besimtari?, kush është myslimani?*

Sipas meje një nga shkaqet kryesore të kaosit që jetohet sot në vendin tonë është mungesa e shpjegimit. Sikurse thonë edhe të vjetërit “Qëllimi është një, transmetimet janë të ndryshme”. Njerëzit tanë që mendojnë të njëjtat gjëra në shumë çështje, për shkak të dallimeve në mënyrën e të shprehurit nuk arrijnë të kuptohen dhe kapen me njëri-tjetrin. Kjo është edhe arsyeja që e pëlqej shpjegimin dhe çdo gjëje mundohem t’i jap një shpjegim në mënyrë që mes nesh të mos ketë ndonjë mosmarrëveshje apo që të shmangim mosmarrëveshjet.

Ç’është “Rinia”, ose kur themi “rini” ç’kuptojmë?

A është “rinia” njerëz të një grupi të një moshe të caktuar?

Ose të pyesim kështu: ç’është ajo “e re” tek njeriu? Trupi, shpirti apo mendja?

Pra, ato gjëra që e bëjnë njeriun të ri a janë veçoritë fizike, shpirtërore apo mendore?

Pra, me çfarë është “i ri” njeriu, me mirësinë e tij, me dijen apo dëshirën për dije, me dashurinë e tij, me emocionin e tij, me bukurinë e tij, apo me pasurinë e tij?

A mund të më thoni? Pra, çfarë është “e re” te njeriu?

Përse dijetari i madh dhe i shquar Muhammed Ikbali bënte thirrje me zë të lartë në gjithësi duke thënë: “O Muhammed (a.s) që i sjell rininë njerëzimit”?

Vallë, çfarë ishte ajo “rini” që i sollti njerëzimit Ai njeri i dashur, Ai njeri që ishte përmbledhja e

gjithë njerëzimit, pra, Ai njeri që ishte “njeriu më i vlefshëm”?

A kemi menduar ndonjëherë dhe a e kemi lodhur veten tonë ndopak për ta gjetur këtë? Pra, çfarë “i riu” ishte ky dhe në cilën pjesë të njeriut ndodhej kjo “rini”?

A mund të themi se kjo rini ishte në anën fizike dhe se kjo rini ishte një rini fizike?

A nuk kishte para profetit ‘rini fizike’ pra, ‘njerëz me fizik të ri’? Kush i sollti në sipërfaqen e tokës njerëzit e një grupi të caktuar moshe, ai njeri i ndershëm? A nuk e dimë që kjo s’është kështu?

Gjithashtu a nuk e dimë që ai njeri i ndershëm, kur u ngarkua me detyrën për t’i sjellë njerëzimit iksirin e ‘rinisë’ nuk ishte as në moshë të re fizike, por ishte në moshë të mesme?

Kjo do të thotë që nuk mund të themi se rinia që i sollti njerëzimit ai njeri i ndershëm ishte rini fizike. Gjithashtu dimë që Ai (Peygamberi (a.s)), aq sa ishte i ri në ditën kur erdhi si njeri që i sollti njerëzimit iksirin e rinisë, pra në ditën kur u ngarkua me këtë detyrë, aq ka qenë i ri edhe ditën kur është ndarë nga kjo botë.

Pra Ai ishte i ri edhe:

- Në luftën e Bedrit kur triumfoi mbi ushtrinë armike,
- Në Uhud, kur u bashkua me të rinjtë myslimanë dhe që ju thyen dhëmbët,
- Kur hyri me fitore në Mekken e braktisur në mes të natës,
- Kur ishte duke shkuar i vetëm në Hunejn mbi ushtrinë

armike e cila numëronte me dhjetra mijëra,

- Kur u nis për në Tebuk në atë verë të nxehtë përvëluese të shkretëtirës së Arabisë ku çdokush kërkonte një hije, ai përherë ishte i ri.

Aq shumë vështirësi, aq shumë vuajtje kaloi dhe përsëri Ai, Muhammedi (a.s) nuk humbi asgjë nga rinia e Tij. Pasi Ai, që nga koka e deri në këmbë ishte 'një iksir rinie' dhe detyra e Tij ishte t'i përcillte njerëzisë këtë iksir rinie që ai mbarte. Prandaj, Muhammedi (a.s) nuk u plak asnjëherë dhe kurrë nuk e humbi rininë e Tij. Edhe shokët e Tij, edhe miqtë e Tij të ngushtë, edhe ata që ndoqën rrugën e Tij, edhe ata që shkelën në gjurmët e Tij ishin të tillë dhe të tillë janë.

Po kush janë ata që ndoqën hap pas hapi predikimet e Tij, që jetuan në rrethin e Tij dhe që nuk humbën asgjë nga rinia e tyre, çfarëdo moshe që kanë patur?

A dëshironi shembuj?

Shihni njëherë rrethin tuaj; ata miq të ngushtë të Allahut, ata njerëz shpirtëror, ata që shkëlin në gjurmët e të dërguarit të Allahut, ata që s'ndahen asnjëherë nga ajo gjurmë, ata që janë të shtrenguar fort në rrugën e Tij, si e ruajnë rininë e tyre, a nuk i shihni?

Nga ky aspekt, rinia s'ka lidhje me moshën. Prandaj edhe unë them që e rëndësishme është të jesh i ri me tipare shpirtërore dhe jo nga ana fizike. Në këtë drejtim, njeriu duhet të jetë i ri me dashuri, me emocion, me mirësi, me bukuri, me pasuri dhe me dëshirën për dije. Prandaj unë them që nëse njeriu është i ri vetëm 'me këto tipare' dhe 'në këto tipare' mund ta ruajë akiden e tevhidit dhe mund të arrijë emblemën e të qenurit rob i Allahut dhe vetëm njeriu që arrin në këtë pikë, mund të



arrijë në kënaqësinë e të qenurit i lirë dhe mund të dalë në shkallën e të qenurit i lirë. Unë, me të vërtetë e pëlqej dhe e dua jashtë mase 'lirinë' dhe 'të qenurit 'i lirë'. Unë i besoj gjithashtu edhe faktit që pjesa më e madhe e problemeve dhe vështirësive tona të ditëve të sotme burojnë nga ajo që nuk jemi 'të lirë'. Prandaj edhe unë e pëlqej shumë 'rininë', 'të qenurit i ri' dhe 'mbajtjes në formë të re'.

Dhe me të vërtetë, a nuk është rinia një simbol i të qenurit i lirë dhe një emër që nuk i jepet para botës?

Nëse njeriu do t'i japë para botës a e keni menduar se çfarë mund të jetë ajo gjë?

Një njeri aq sa i jep para botës a nuk lidhet me të dhe a nuk futet në autoritetin e saj?

E thënë ndryshe, aq sa lidhet me botën a nuk e humb lirinë e tij dhe a nuk bëhet rob i saj?

Si do ta mbronte dinamizmin

e tij një shpirt i robëruar dhe a nuk do të shkojë atje ku do të tërhiqet zvarrë?

Pasi a nuk është ai rob i botës, pra i nefsit të vet, pra i interesit të vet?

A është e mundur që një njeri i tillë të ketë të drejtat e veta, të mbrojë të drejtat e veta dhe të ruajë origjinalitetin e vet?

A mund t'i themi "i ri" një njeriu që nuk është origjinal, pra që nuk ka të drejtën e vet, pra që nuk është "vetvetja"?

Rinia është emri i moskonsumimit dhe mosvetërsimit të dashurisë. Pasi vetëm në këtë mënyrë njeriu mund të arrijë atë që quhet "hubbu lillah dhe bugzu fillah", pra të fshehtë që dashuria dhe urrejtja të jetë për Allahun, dhe vetëm kështu në botë mund të mbizotërojë vëllazëria dhe qetësia, pasi vetëm dashuria heq papastërtinë e shpirtit. Në këtë aspekt, ajo është sikurse një "prush zjarri" që pastron ndryshkun e



hekurit, është emri i dashurisë dhe i zhdukjes së njeriut në dashuri, sepse nuk ka një të dashuruar të vërtetë. Ai që është i dashuruar çdo gjë dhe çdo njeri e sheh me syrin e Tij. Kjo është edhe arsyeja e dashurisë dhe e urrejtjes së tij. Dashuria është emri i ruajtjes së freskisë. Prandaj dashuria nuk e ndan syrin dhe shpirtin nga dashuria. Kjo është edhe arsyeja që Allahu i Lartë e sheh robin e Tij në shpirt me herë të tëra. Pasi njeriu i dashuruar e mban vazhdimisht shpirtin në këndvështrimin e Tij. Atje nuk vendos asgjë tjetër përveç dashurisë së Tij. Nëse do të vendosë diçka tjetër e di që Ai nuk do të shohë.

Ai pyet:

- A mund të qëndrojnë në një shpirt dy dashuri?

Këtë e shpjegojnë edhe njerëzit tanë duke thënë: *“Ai që është larg syrit është edhe larg zemrës”*. Kjo është edhe arsyeja që njerëzit tanë kanë thënë: *“Ndarja është më e tmerrshme se vdekja”*.

A mund ta mendoni se ç'bëhet nëse njeriu vjetëron dashurinë, e prish atë apo më e keqja nëse e konsumon dashurinë?

Fillimisht njeriut i ik rinia dhe tashmë nuk shkon që t'i thuhet “i ri” njeriut që nuk ka dashuri. Njeriu që s'ka dashuri “s'mund ta dojë krijesën përtej Krijuesit”. Kur mungon dashuria nuk mbetet as dashuri dhe as qetësi. Zhduket mirëkuptimi dhe njerëzit, madje edhe për çështjet më të vogla zihen mes njëri-tjetrit. Këto duar që i zgjaten armikut s'janë gjë tjetër vetëm një zgjatje ndaj njëri-tjetrit. Kjo do të thotë humbja dhe rrënim i një populli, ndërsa dobësia e një populli e humbet dhe e çon atë në “poshtërsi” dhe e thërret “me qiri me dritë të kuqe”. Poshtërsia, kur bie mbi një popull si retë e zeza, është e pamundur

që ta nxjerrësh me top dhe tufek, pasi nxjerrja jashtë e poshtërsisë është e lidhur jo me top dhe tufek, por me goditjen e shpirtërave me top, kurse në fakt tashmë shpirtat nuk po godasin me top. Pasi dashuria është vjetruar dhe bashkë me të edhe shpirtat...

Rinia është emri i të qenurit në shkallën më të lartë të mirësisë. Pra, ihlas është emri i të bërit çdo gjë për Allahun. Në shpirtin e njeriut të mirësisë, pra në shpirtin e robit të vërtetë, pra në shpirtin e të riut Muhammedan, nuk ka vend për ata që thonë të shohin, të dëgjojnë, të thonë. I riu Muhammedan çdo gjë e bën për Allahun, pasi ai e di që Allahu e sheh atë. Nëse Allahu e sheh dhe e ndjek një të ri a ka



Dijetarët ishin njerëz që jetonin për të tjerët. Ja pra, për këtë arsye ata ishin trashëgimtarë të pejgamberit (a.s). Prandaj “vdekja e dijetarit ishte vdekja e botës”.

nevojë që atë të ri ta shohë dikush tjetër? Dhe njeriu i ri që çdo gjë e bën për Allahun tashmë përherë do të bëhet “dora që jep” dhe përherë do të bëhet “njeriu i dobishëm”. Në këtë mënyrë, ai do të arrijë të konceptojë lajmin e mirë që “dora që jep është më e dobishme se dora që merr” dhe duke u bazuar në hadithin profetik “*më i dobishmi i njerëzve është ai që është më me dobi për njerëzit*” do të arrijnë në gradën e “*të qënurit më i dobishmi i njerëzve*”. Njeriu Muhammedan

nuk pret diçka prej njerëzve dhe s'mund të ketë diçka. Ai e përgatit veten e tij për një ditë ku llogaria e tij do të shihet plotësisht. Në atë ditë, në atë ditë të fundit, në atë ditë fetare ku çdo gjë do të shihet deri në detajet më të vogla... Sa bukur është të përgatitet njeriu në ditën e fesë... dhe sa e shëmtuar është që njeriu të vijë duar bosh atë ditë.

Një tjetër “rini” që i solli njerëzimit Pejgamberi (a.s), i cili i solli rininë njerëzimit, është edhe “bukuria” që nuk vjetërohet, që nuk vyshket, që nuk prishet dhe që për gjithë jetën e ruan freskinë e saj. Një bukuri e tillë a mund të ishte vallë një bukuri fizike? Padyshim që jo. Pasi sipas thënies së njeriut të Anadollit “nuk do të mund të rendej në supë”. Pra, bukuria fizike nuk ka fuqi as t'i shtojë shijen supës. Në këtë gjendje, siç mund ta kuptoni edhe vetë, bukuria fizike nuk mund të ishte as sa kripa e liqenit të kripur. Sigurisht që Zotëria i gjithësisë nuk mund të ishte udhëzues dhe dërgues i një bukurie që s'mund të ishte as sa kripa. Pasi bukuria fizike ishte e përkohshme dhe Ai nuk i pëlqente gjërat që ishin të përkohshme. Në këtë aspekt Ai ishte si Ibrahim (a.s) që thoshte me gjuhën e Kur'anit “Unë nuk i pëlqej gjërat e përkohshme”. Për këtë arsye Ai i ishte nervozuar Ebuzerit që i kishte thënë Bilalit “i biri i gruas së zezë”, pasi bukuria sipas Tij nuk qëndronte tek ngjyra, forma, rrënja farefisnore apo raca. Prandaj, me gjuhën e Tij: “nuk ka superioritet arabi nga ai që nuk është arab” dhe “*Superioriteti është vetëm me devotshmëri, pra vetëm duke u ruajtur nga gjynahet dhe duke iu frikësuar Allahut*”. Ja pra, kjo ishte edhe rinia që i dërguari i Allahut i kishte sjellur njerëzimit.

Pasi ishin vetëm të devotshmit robërit e vërtetë të Allahut,



Muhamed (a.s.) urdhëronte dhe thoshte “Është në humbje ai që ka dy ditë njëlloj” dhe përgjerohej duke thënë “O Zot; më mëso mua të vërtetën e sendit”.

pra, ata të cilët kanë thënë ‘robi im’ dhe që janë lavdëruar ndaj melekëve duke thënë me gjuhën e Kur’anit “Ja, i patë ‘keni pas thënë a do të krijoni njërin që derdh gjak dhe nxjerr disfatizëm në sipërfaqen e tokës’. Pasi janë vetëm të devotshmit ata që i përshtaten ‘hallkës’ dhe vetëm ata që i përshtaten hallkës janë zotëruesit e etikës së vërtetë, pra ata që kanë natyrë të mirë, pra mbartësit e ‘bukurisë që s’rendet në supë’. Për këtë arsye njerëzit e drejtë që ndjekin vijën Muhammedane janë ndjekës së bukurisë së hujit (natyrës) dhe për këtë arsye nuk janë kërkues të ‘bukurisë që s’rendet në supë’. Prandaj, njerëzit e drejtë që ndjekin vijën Muhammedane, shkojnë pas bukurisë së vesit dhe prandaj nuk kanë kërkuar asnjëherë ‘bukurinë që s’rendet në supë’. Ja pra, edhe Ai, Pejgamberi (a.s), u ka sjellur njerëzve bukurinë e vesit që e çon njeriun tek devotshmëria dhe jo bukurinë e përkohshme, megjithëse është shumë e bukur nga ana fizike dhe ia paraqiti njerëzimit këtë bukuri brenda qeseve të mbushura plot. Pasi Ai është dërguar për të plotësuar moralin e mirë dhe me shprehjen e Aishes ‘Etika që solli Ai është etika e Kur’anit’. Dhe Ai tregonte vetë me gjuhën Pejgamberore bukurinë e vesit të vet duke thënë: **‘Mua më edukoi Zoti im dhe sa bukur që më edukoi’**. Me të vërtetë, Atë e edukoi Allahu dhe sa mirë që e edukoi....

Pra, siç e thamë, faktori “rini” më i rëndësishëm që i solli i dërguari i njerëzimit ishte kërkesa për dije. Pasi dija ishte mbi çdo gjë, edhe dashuria, edhe mirësia, edhe bukuria, edhe pasuria, pra çdo gjë mësohej prej dijes. Dhe të gjitha këto veçori që e bënin njeriun njeri mund ta ruanin rininë dhe freskinë e tyre vetëm me dije. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut këshillonte

“Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr”. Për këtë arsye na thoshte se *“Nuk mund të ishin një ata që dinë dhe ata që s’dinë”*.

Për këtë arsye *“Gjumi i dijetarit është më superior se adhurimi i të devotshmit”*. Pasi dijetari do të flinte, të pushonte, të mësonte përsëri dhe të ishte i dobishëm për njerëzit. Dhe a nuk ishte kështu?

Më i hajrit i njerëzve a nuk ishte më i dobishmi për njerëzit? Dijetarët ishin njerëz që jetonin për të tjerët. Ja pra, për këtë arsye ata ishin trashëgimtarë të pejgamberit (a.s). Prandaj *“vdekja e dijetarit ishte vdekja e botës”*. Apo mendo ni se ishin adhuruesit? Lodhjet dhe ibadetet e tyre ishin vetëm për ta. Pra, ata e jetonin jetën vetëm për veten e tyre. Prandaj edhe adhurimet e tyre nuk arrinin deri tek gjumi i tyre.

Muhamed (a.s) urdhëronte dhe thoshte *“Është në humbje ai që ka dy ditë njëlloj”* dhe përgjerohej duke thënë *“O Zot; më mëso mua të vërtetën e sendit”*. Ai e dinte që nëse nuk e mësonte këtë nuk mund ta kishte atë. Dhe nëse nuk mund të sundonte, ata që ishin zotërues të sendit do të mbizotëronin mbi ata që nuk ishin të tillë dhe Ai për këtë arsye ishte sundues i sendeve. Prandaj edhe thotë *“forca është të hedhësh”* dhe urdhëronte *“armatimin me armët e armikut”*. Sipas Tij *“hikmet, dija deri në detaje, pra e vërteta e sendit, ishte fuqia e besimtarit dhe kudo që të ndodhej ajo duhej të merrej e plotë”,* prandaj Ai shpeshherë këshillonte *“Kërkojeni dijen goftë edhe në Kinë”* A nuk e kemi menduar vallë se dija që na këshillohet me gjuhën Pejgamberore cila ishte ose dija e kujt ishte?

Cila dije ishte që do të merrej në Kinë, hadithi, tefsiri apo kelami?

A e keni menduar?

A e di kush dhe nëse ka që e dinë a mund të na e shpjegojnë

ju lutem?

Kur Ai thoshte *“Bëhu ai që mëson, ose ai që mëson të tjerët, ose që dëgjon dhe do, mos u bëj i katërti apo i pesti”* vallë mos kishte për qëllim shkencat e përmendura më sipër? Përse disa robërve të Bedrit u pat dhënë kusht që të mësonin tre nga një mysliman si bedel fidjeje?

Pse i dha për detyrë Zejd bin Thabitit të mësonte hebraishten?

Pse Hafzasë i dha mësim shkrim leximi?

Pse Hz. Ali *“Bëhej rob i atij që i mësonte qoftë edhe një shkronjë?”*

Kurse në fakt Ai me gjuhën Pejgamberore a nuk ishte *“dera e qytetit të dijes”*? Çfarë kishte diçka që s’dinte ai njeri bamirës që kishte aq ambicje për mësimin aq sa të ishte gati edhe të bëhej rob?

A e keni menduar ndonjëherë?

Ai i solli njerëzimit një emocion që s’kishte konsumim dhe mbarim. Pasi *“rinia”* do të thoshte emocion dhe Ai për gjithë jetën nuk e humbi emocionin. Në panairin e Ukazit me këtë emocion Ai doli çadër për çadër me mendimin nëse kishte ndonjë zemër të ndotur në të cilën mund të hidhte farat e tevhidit. Më pas kur shihte se ky shpirt është ndriçuar me dritën e *“Tevhidit”* ose e vuri nën minber ose i veshi hërkën e tij shpirtit të personit që ndriçoi. Në muajt më të vështirë të vitit Ai me këtë emocion shkoi në udhëtimin e Tebukut dhe ata që duhej ta dëgjonin këtë emocion dhe që nuk e dëgjuan, nuk i fali derisa t’i falte Allahu. Përsëritja së bashku me Xhebrailin e vahjit që i solli ishte nga ky emocion që ndjente. A thamë që Ai nuk e humbi për asnjë rast emocionin dhe vazhdimisht jetoi me këtë emocion? Emocioni ishte treguesi i të qenurit *“i ri”* dhe



i të mbeturit *“i ri”*. Për këtë arsye Ai kur lodhej në një punë pushonte në tjetrën. Ky dinamizëm që nuk humbiste forcën dhe qëndrueshmërinë e Tij buronte nga rinia, pra nga emocionin e Tij. Ja pra, për këtë arsye bënte thirrje njeriu i forcës dhe i përpjekjeve Muhammed Ikbal duke thënë: *“O Muhammed (a.s) që i sjell njerëzimit rininë”* Nëse edhe ju dëshironi të bëheni një i ri Muhammedan jeni të detyruar që dashurinë, mirësinë, pasurinë, dëshirën tuaj për dije dhe emocionin tuaj ta mbani të gjallë brenda përmasave Muhammedane. Dhe kjo bëhet me arsim dhe para se të shpjegojmë se me çfarë arsimit është e nevojshme të bëhet dëshiroj të ndalem pak mbi atë se si dhe me çfarë nuk bëhet.

Një rini e vijës Muhammedane nuk rritet dhe zhvillohet me slogane të papërcaktuara dhe që s’shkelin në tokë. Mos harroni, duke u bazuar në ajetin *“fe men*

ja’mel mithkale dherr-rretin hajren jere ve men ja’mel mithkale dherr-rretin sherr-rren jere” do të japim llogari për çdo duartrokasje, për çdo slogan dhe për çdo grusht të hedhur kot. Mos harroni që duartrokjet pa vend janë si uji që i jepet qimes së devesë. Prandaj, nga ky aspekt, para se të duartrokisni një fjalë, e kaloni atë në kullojsen e mendjes, peshoni mundësinë e saj dhe më pas duartrokisni. Në të kundërt, duartrokjet do të rrisin më tepër mërzi të folësit dhe do ju takojë të jepni llogari si njerëz që ushqeni këtë pakicë.



Jetojmë Rininë

Arjeta PELINKU

Në një hadith të profetit Muhamedit (a.s) këshillohemi të vlerësojmë tre gjëra para tre të tjerave dhe një ndër to është rinia.

Të vlerësojmë rininë para se të na zërë pleqëria.

Përpara nesh shfaqet një shumëllojshmëri rrugësh, por njëkohësisht mund të jemi të rrethuar nga kotësi, hapësira boshe dhe materializëm. Kaq shumë mundësi për të kuptuar, për të kërkuar të zbulojmë të vërtetën, atë që realisht ia vlen dhe kaq pak përpjekje për t'ia arritur.

Nga një thënie e thjeshtë mund të përfitojmë aq shumë dhe asgjë, mund të kuptojmë dhe të përpiqemi të ndryshojmë, por mund dhe të mos kuptojmë asgjë.

...Të aftë për ndryshim dhe të

lënë pas dore, të dashur por të harruar, rebelë dhe të papranuar, të rinj dhe të papjekur, akoma të paplotësuar.

Materializëm i shfaqur si sfidë e pathyeshme para rinisë, i aftë të të rrëmbejë dhe i vështirë të ndahesh prej tij. Në një shoqëri të tillë me standarde të përcaktuara, të afishuara qartë dhe kërkesa për të plotësuar ato që të tjerët presin prej nesh, ne qëndrojmë si të dyzuar. Në një shoqëri të cilës i përkasim, por prej kthetrave të së cilës duam të shkëputemi dhe të fitojmë liri. Duam të fitojmë liri që të jemi vetvetja. Jemi të lirë në individualitetin tonë por të cënuar të jemi vetvetja. Pritet njëlloj nga secili prej nesh, por ka nga ne që s'e duan njëllojshmërinë. Ca prej nesh s'pranojnë standart,

duan individualizëm, duan të duhen dhe pranohen pikërisht sepse diçka ndryshe i dallon, diçka ndryshe nga e njëjtoja, diçka ndryshe nga njëngjyrshmëria i bën të bukur por ndryshe, të dashur por ndryshe, të rinj por ndryshe nga rinia e pa kuptuar.

Bukuria e zërave tanë është në unikalitetin e tyre dhe bukuria e pamjeve tona është në të qenët të posaçme për ne.

"E edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe, ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza." (Kur'an 35:27)

Modë, veshje e njëjtë, njëllojshmëri dhe jo individualizëm.

Modernizëm që nxit standartizim, modernizëm që çënon shije individuale, por jo të gjithë pra-





nojnë këtë lloj konformiteti. Jo të gjithë janë të gatshëm të ndrydhin vetveten dhe të sillen njësoj, të plotësojnë me detaje çdo pritshmëri të mundshme. Jo të gjithë pranojnë ti nënshtrohen asaj që të tjerët presin. Ka nga ata që duan të jenë ndryshe, duan të ndryshojnë standardet, të modifikojnë pritshmëritë.

Tablo e pikturuar dhe rini që shfaqet me ngjyrat e saj. Kërkon të arrijë idealen, punon të jetë vetvetja, kërkon të shfaqet me gjithë potencialin e vet, kërkon pareshtur të arrijë dhe të afirmojë lirinë e saj. Rini që do veten dhe të tjerët, do humanen, i frikësohet materializmit dhe vorbullës së tij që të rrëmben.

Rini e gjendur përballë muresh të amortizuar të kufijve ndarës të së drejtës dhe së gabuarës, të së vërtetës dhe së gënjeshtres, të adhurimit dhe mosbesimit. Rini që përpiket të adhurojë dhe papritur gjendet mes mos-besimtarësh,

kjo e trishton por dhe i rrit besimin, e bën falënderuese dhe kupton ndryshimin.

Sheh veten të aftë për të besuar, sheh veten të gatshme për të falënderuar, sheh veten të aftë për të menduar dhe sheh përballë vetes të afërt dhe të largët, miq dhe shokë mosbesues, larg adhurimit, të gatshëm të verbohen para së vërtetës së qartë, të gatshëm të jenë të shurdhët para dëgjimit të mesazhit të përçar, të lumtur të qëndrojnë të palëvizshëm para standardeve fikse, të caktuar nga të tjerë, të lumtur të ndryshojnë veten për të qenë njësoj, të frikësuar nga vetja dhe të dhënë pas materiales, të rrëmbyer nga materializmi dhe të zhytur ne depresion. Ajo që kërkoj të them është se të jesh i ri do të thotë të zotërosh një potencial që pas pak kohe do ta humbasësh, prandaj është e rëndësishme ta shfrytëzosh atëherë kur efektivitetin do ta ketë më të madh, dhe në sho-

qërinë tonë përveç një konformiteti që karakterizon rininë e sotme shohim të rinj që kërkojnë të shfrytëzojnë potencialet e tyre, të rinj që diversiteti dhe shumëllojshmëria nuk i tremb. Dhe mes nesh ka akoma prej atyre të rinjve që reflektojnë mbi hadithet profetike dhe kuptojnë domethënien e tyre, reflektojnë mbi ajete Kur'anore... dhe kuptojnë. Dhe ka prej atyre të rinjve që zemrat e tyre i ka mbuluar besimi dhe shpirtrat e tyre duan të Vetmin Krijues, dhe mendjet e tyre kërkojnë përherë zbulimin e të vërtetës, e padyshim ata do jenë me të vërtetë më të suksesshmit. Ata që e kuptuan rëndësinë e rinisë së tyre, ata që e vlerësuan rininë e tyre. *"Vërtet bota dhe çfarë ka në të nuk vlejnë sa shpirti i besimtarit"*. E me të vërtetë shpëtimi i çdo njeriu dhe çdo të riu është dashuria për Zotin, të vetmin Krijues.

Intervistë Me Prof. Dr. Hajreddin Karamanin Mbi Modernitetin

ETIKA

Etika: Është duke u bërë një shtjellim se: "Moderniteti ka ndikuar tek myslimanët më shumë se sa mendojnë vet ata"... sa që edhe sipas disa sociologëve thuhet se janë formuar "personalitete meleze". Disa nga këta, këtë e shohin si diçka të pa shmangshme kurse dikush tjetër mendon se ata kanë ndryshuar.

Sipas jush, çka duhet të kuptojmë nga bazat themelore të modernitetit? A është ai një bashkësi në vete? Cilat janë pikat kryesore ku ai ndahet nga Islami?

Prof. Dr. Hajreddin Karaman: Modernitetin dhe post modernitetin, sipas Islamit unë e shoh si një bashkësi dhe proces. Të dyja këto (së pari kishën pastaj fenë e bazuar në shpallje) përjashtojnë vendosjen e fesë universale, moralit dhe traditës. Kundra individit, te drejtave dhe lirive të tij pengon daljen e "zotave të ri".



Moderniteti në vete nuk shpreh një bashkësi ideologjike, por në të kundërtën, ky del në pah si armiku më i madh i ideologjive dhe feve, kështu që ai po kuptohet si një fe që i udhëzon njerëzit apo një ideologji.

Në modernitet nuk ka fe të përsosur. Udhëzuesi dhe orientuesi i njerëzve, të menduarit dhe shkenca, kurse edhe udhëzuesi pas modernizmit nuk janë të nevojshëm për të, ai (drejtuesi fetar) ka individualitetin, të drejtat dhe lirit e tij. Sipas Islamit, mendja dhe dituria ka kufijtë e saj të caktuar, ka kufijtë e përdorimit të saj, nuk i përkufizon të gjitha të vërtetat dhe kufijtë por, për ato gjëra të cilat mbesin jashtë mendjes dhe diturisë dhe për të arritur gjëra te ato nevojitet *shpallja /vahji*. "Të menduarit dhe shkenca" e cila nuk është në kundërshtim me të menduarit dhe shkencën është një e vërtetë fetare e pa shmangshme.

Etika: A e përkrahni mendimin se myslimanët janë të ndikuar nga moderniteti apo janë të ndikuar më shumë se sa mendohet? Sipas jush, në planin e mendimeve dhe ideologjive, cilët janë shembujt më të qartë të ndikimit dhe ndryshimit.

Prof. Dr. Hajreddin Karaman: Njeriu, sistemin e jetës dhe botës së tij e formon mbi një themel të besimit dhe mendimit të tij. Duhet

që besimin ta ndajmë në atë fetarë dhe jo fetarë. Besimi fetarë është përkufizuar nën formulën "âmentu" "besoj". Kurse besimi i cili nuk është fetarë, brenda këtij është edhe "mohimi", p.sh. mendimet dhe mohimet se nuk ka Zot apo se Ai nuk ndikon në jetën e njerëzve apo edhe se nuk do të ketë ahiret janë besime, sepse këto nuk mund ti theksojmë dhe argumentojmë me shprehje shkencore. Ja pra, modernizmi është formuar mbi llojin e dytë (*mohimin*). Myslimanët të cilët kanë besim dhe të cilët jetën dhe botën e tyre e ndërtojnë sipas kësaj, për shkak se kanë ra në gabime të rëndësishme në aplikimin dhe kuptimin e fesë, ose, dallimi i atyre të cilët balancojnë jetën në mes dynjasë dhe ahiretit dhe atyre që balancojnë jetën e tyre vetëm për dynja, duke e treguar veten e tyre në shkencë, teknologji, ekonomi... dhe duke ndikuar në jetën e gjithë myslimanëve, edhe myslimanët u ndikuan nga këta. Si përfundim i kësaj, dolën tri grupe të ashpra:

1. Ata të cilët nuk merren me modernitetin dhe modernizmin edhe nëse mund të përfitojnë nga ai, të kuptojnë diçka apo ta vlerësojnë atë, ata të cilët kufizojnë të drejtat e tyre kundra tij, dhe ata të cilët bëjnë zgjedhje në ruajtjen e sistemit të jetës klasike.

2. Ata të cilët pjesërisht apo krejtësisht e japin fenë dhe pranojnë modernitetin.



Lindi në vitin 1934 në qytetin Çorum në një familje me prejardhje nga Erzurumi. Pasi mësoi në shkollën fillore të këtij qyteti zuri të merrte mësimet private në gjuhën arabe dhe shkencat islame. Më pas u regjistrua në Medresenë e Konjës, një ndër medresetë e para të hapura nga shteti turk. Më pas i vazhdoi studimet në Institutin e Lartë të Teologjisë Islame në Stamboll dhe që një ndër të diplomuarit e brezit të parë të këtij Instituti (1963). Fitoi të drejtën e pedagogut të Institutit të Lartë Teologjik Islam në vitin 1971 me mbrojtjen e disertacionit "Ixhtihadi në të Drejtën Islame nga fillimet e tij deri në shekullin e katërt hixhri". Pas vitit 1975 mori gradën shkencore të Profesorit. Momentalisht është pedagog i jashtëm i Universitetit Islam Ndërkombëtar Europian në Hollandë. Njeh gjuhët arabe, perse dhe franceze. I martuar dhe ka 3 fëmijë. Faqja e tij personale në web është

www.hayrettinkaraman.net

3. Ata të cilët e kuptojnë modernitetin dhe modernizmin, të cilët drejtë e vlerësojnë, të cilët i përmbahen rrugës për prezantimin e këtij për të gjithë njerëzit si një "alternativë" besimin islam, mentalitetin, sistemin e jetës dhe ndërtimin e saj me një gjuhë të re apo brenda një plani të ri, dhe mu për këtë shkak sakrifikojnë. Që nga shekulli i 18, dy kategoritë e fundit seriozisht kanë ndikuar në frymën islame dhe kanë zënë vend, kurse në pjesën e tretë të këtij shekulli është pranuar edhe kategoria e tretë, i kanë edukuar, arsimuar dhe ende vazhdojnë ti

arsimojnë kuadrot e veta.

Etika: Kur ti keni parasysh sjelljet dhe mendimet tuaja "A thua unë kështu po mendoj pse ndoshta kam mbetur nën ndikimin e modernitetit?" A ju ndodh që ndonjëherë edhe ju të brengoseni për këtë çështje? "A ka ndonjë rrugëdalje tjetër? A mund të jem kundra modernitetit?" Këso pyetje dhe të ngjashme me to, a i thoni nga brendësia juaj këto si përkulës dhe determinist?

Prof. Dr. Hajreddin Karaman: Teorikisht asnjëherë nuk jam dorëzuar, asnjëherë nuk kam vërejtur se kam mbetur pa rrugëdalje dhe asnjëherë nuk kam vërejtur që ajo e cila na përket neve është e pa vlefshme kurse e tjetërkujt te jetë e vlefshme. Por unë jam një fakih/jurist. Duke shkuar në Dimjat për të ngrenë pilaf, për të arritur gjer te "pilafi i atjeshëm" – njerëzit të cilët mendonin - a ta hamë pilafin të cilin e kishim me vete apo diçka tjetër, pastaj të jetojmë, të sakrifikojmë dhe të gjejmë të vërtetën, unë jam i obliguar që atyre tu gjejë rrugëdalje. Ja pra, duke u munduar ta bëj këtë, nuk ka mundësi që të mos mbetem nën ndikimin e modernitetit, nuk mundem që atë të mos e konsideroj asgjë dhe s'ka mundësi që të gjej rrugëdalje të përkohshme duke iu përmbajtur doktrinave "të domosdoshme dhe interesante të përgjithshme".

Etika: A i bashkëngjituni mendimet se ka gjëra ku myslimanët mund të kenë dobi nga moderniteti?

Prof. Dr. Hajreddin Karaman: Këtë dobi të këfillë mund t'ia përngajmë organeve të bartura. Pasi që udhëheqja e krijuesit është e këfillë, mund të jenë organe të cilat duhet të ndërrohen, të vjetroheshin dhe të shkatërrohen. Po që se këto organe do të ndërroheshin

me burimet tjera, se a do të pranojë apo jo rehabilitacioni i trupit organe të reja, nëse e pranon, duhet të parashikohen normat se cila ndikon te tjetra dhe se a mundet që ti ruajë veçoritë e veta. Po që se ka mundësi që trupit ti ndërrohet ndonjë organ dhe ai të shndërrohet në një trup të ri, nëse ky organ i ri nuk sjell ndonjë virus, mikrob apo ndonjë prishje, atëherë ky merret dhe shfrytëzohet.

Etika: A besoni se myslimanët duhet të bëjnë një larje hesapësh në mes modernitetit dhe islamit? A ka ndodhur një proces i tillë? Apo si u zhvilluan marrdhëniet në mes këtyre?

Prof. Dr. Hajreddin Karaman: Përgjigjja e kësaj pyetje pjesërisht ekziston lartë. Por si shtesë mund që të thuhet edhe këto: Gjer në pjesën e fundit të njëqindveçarit tonë – përafërsisht- sjellja dhe sistemi kundra modernitetit, kundra korrsjes së fitores, në njohjen e armikut dhe marrjes së masave dhe në vend të prezantimit të alternativave dhe larjes së hesapeve kemi mbetur të habitur, pa rrugëdalje, janë bërë vlerësime dhe bashkime të gabueshme.

Po, me të vërtetë duhet ti lajmë hesapet me modernitetin. Islami nuk merret me asnjë besim dhe bindje e cila është në kundërshtim me të dhe i cili sjell rrezik për të, ai nuk mund të bëj paqe me të. Ai duhet të përpiqet dhe të mundohet, duhet ta ruaj veten, le të ndryshoje aq sa është e nevojshme që të mos e prishë rivalin dhe drejtimin e vet, dhe në këtë rast le ta vazhdojë ekzistencën e vet e edhe atë të renë, ai duhet të mbetet gjithmonë një "murshid" "udhëzues" ku njerëzit gjithmonë do të jenë të nevojshëm për të, gjersa të krisë kiameti...

Studente për Psikologji: Saida BEQIRI

Vetja, të tjerët dhe mjedisi

Copëz e thyer që mundohem të arnohem. Të tjerët që thyhen mundohen t'i ngrënë dhe t'i "ngjisin" copëzat e mia, por unë vazhdoj të jem e thyer. "Arni" që jepni ju s' është ngjyra ime.

S'e shikoni që është blu... i kuq... i zi ?

...Sot jam një vazo. Jam qelq pa ngjyrë...

Kam shumë vizatime të verdha, të kuqe, blu...

Jam një pikturë... Sfondi im është gri. Nuk arrij të dal nga ai. Po korniza?! S'e di...

Familja, shoqëria... Një penel në një dorë të padukshme.

Sot ngjyrat e mia janë rrjetat e një merimange. S'dua që fshesa juaj të prishë qetësinë e ekzistencës sime. Pse u dashka që unë të jem karremi në rrjetën e merimangës?

A s' mund të jem ajo që thur rrjetën me gjithë brishtësinë e saj?

S'dua të ma prishni. Jam unë. Është jeta ime...

Është vjeshtë. Jam gjethja ngjyrë kafe që bie në trotuarin e ftohtë gri. Hapa indiferente ecin...

Mos! Ti po më shkel... Po shkel dashurinë me të cilën vjeshta më hodhi në hapësirat pa ngjyra. E unë përsëri jam ngjyrë kafe, e ver-

dhë, portokalli...

Jam hija e vetes pas të cilës zvarritem çdo ditë. Kam humbur vërtet shumë... Kam fituar shumë përsëri.

Gjunjzohem para vetes sime. Jam një vazo e thyer, rrjeta e merimangës, argjili i papunuar, gjethet në hapësirë...

Jam zogu që akoma ecën me hapa të pasigurtë dhe fluturimi është ëndërr.

Jam brenda dashurisë... E di!

Vallë copëzat e mia a do të më ndihmoni t'i ngjis një ditë, pa i ngjyrosur...

Shprehja e ndjenjave

Më fal!

Dua të të them diçka. Kam shumë që dua ta bëj por s'mund të flas.

Të lutem! A mundesh një minutë ?

Përse nuk arsyetojmë kur pyesim?

Di të dua... shumë madje por ...nuk mundem.

Shikoj hënën. Zemra ime ka krahë dhe tani është atje bashkë me shumë zemra të tjera. Të dua!

Asgjë tjetër nuk ka rëndësi.

Sot... rrugës kur po kthehesha për në shtëpi pashë hijen tënde. Zemra rrahu fort.

Asnjëherë nuk jam ndjerë

kështu.

Duhet të të dua si idealiste nga larg apo të kthehem në materializëm?

Aty ku ka dashuri, bashkë me ëndrrat ka edhe shumë frikë, por nëse do t'i japësh dashurisë mundësitë e saj duhet ta bësh duke u përballur me të dhe jo duke u larguar prej saj.

Nganjëherë, paarsyeja e zemrës sonë na mashtron! Asgjë nuk ishte siç dukej dhe guacka e arsyes është thyer nga lotët, por dashuria e vërtetë nuk lejon që brenda saj të zgjidhet egoizmi.

Vështirë të pranosh që dashuria nuk kërkon ta zotërojë zemrën, por t'i japë krahë asaj. Rrugët e zemrës kryqëzohen.

Ndonjëherë "semafori" është portokalli dhe tabelat flasin një gjuhë të pakuptueshme për vështrimet femënore. Lutjet janë të bardha... ndërsa fjalët janë gdhendur mureve të zemrës...

Sido që të jetë dashuria, të duash është një privilegj dhe të merresh me dashuri është dhuartë hyjnore.

Mes shumë pyetjesh përse arsyen nuk e kupton edhe kur gjendesh brenda dashurisë. Dashuria është dashuri. Kjo është arsyeja pse njerëzit duhen.

Shpresoj që dashuria t'i bëjë të gjithë të privilegjuar dhe të zbulojë ndjenjat e tyre Hyjnore.

Lufta e Vlerave

Përktheu dhe përshtati: Artur TAGANI



Librat që bëjnë fjalë për fe apo për ndo-një sekt na paraqiten herë në formën e ndonjë romani të rrjedhshëm, herë në një dokumentar enigmatik dhe nga njëherë në një film që përmban skena horrori.

Pak njerëz i patën dhënë të drejtë parashikimeve të Samuel Huntington-it rreth përplasjes së qytetërimeve që do përhapej në mbarë rruzullin tokësor, madje shumë mendimtarë e vlerësuan utopik, ashtu sikur pohimet e George Orwell-it tek "1984" i famshëm.

(Në të vërtetë, zhvillimet e fundit nuk po e nxjerrin as Orwell-in si një utopik i madh, thjesht kishte gabuar pak në kohë.) Sot, le të thonë ç'të duan, gjendemi në mes përplasjes së qytetërimeve. Tema jonë është çështja për flakërimin e ngadaltë (apo duhet të themi të papritur?) të armiqësisë historike mes të krishterëve dhe hebrenjve.

Në filmin "The passion of

the Christ", që në vitin 2004 në të gjithë botën u diskutua shumë, pohohet se torturimi dhe kryqëzimi i Krishtit nga ana e romakëve, ishte i planifikuar nga hebrenjtë e asaj kohe dhe në fakt prefekti romak i asaj kohe ishte kundër një ndëshkimi të tillë. Personazhet negative ia kishin veshur të gjitha nga fillimi në fund klerikëve hebre. Më interesante është se kjo pikëpamje ishte ideja zyrtare që përkrahte kisha katolike deri në vitet 1960 për t'i dhënë fund armiqësisë mes tyre, me urdhërin e Papës që hequr nga funksioni. Nëse mund të bëjmë një krahasim, është sikur Kalifi të japë një urdhër që të hiqet nga literatura Islame konflikti me Beni Kurejdhan për hir të miqësisë dhe të konsiderohet sikur nuk ka ndodhur asgjë. Mirëpo, disa mund të mendojnë se "Kjo nuk mund të ndodhë, historia nuk mund të ndryshojë me një urdhër", përveshin mëngët dhe realizojnë një film të tillë. Si rezultat, njerëzit shohin një film dy orësh që figurës së rëndësishme të krishterëve i vënë kurorë me gjemba, me kryq në shpinë, copëza mishi i heqin nga shpina me topuz me kanxhë, shkurtimisht e vrasin duke e torturuar dhe njerëzit këtë e ndjekin me vëmendje. Çfarë do të thotë kjo? Ose hebrenjtë nuk e kanë më nën kontroll Hollywood-in si më parë ose ka një përplasje të brendshme.

Kur të krishterët bëjnë kështu, a mund të qëndronte i heshtur krahu tjetër? Në të vërtetë, para këtij filmi ishin realizuar filma që të krishterët i kishin futur në telashe. Këto kryesisht ishin ve-

pra të qarqeve masonike që i jepnin një lëkundje të mirë krishterimit katolik dhe që vinin në plan të parë gjakun hebre të Jezu Krishtit. Për shembull, libri gjysëm dokumentar "Fraksioni i Priftërinjve Luftëtarë, Templarët, Gjaku i Shenjtë dhe Kupa e Shenjtë" i përgatitur nga tre të rinj, gazetarë të BBC-së, një libër mjaft tërheqës dhe i logjikshëm, i cili bënte fjalë për kundërthëniet mes ungjillëve dhe në të njëjtën kohë edhe për Jezu Krishtin që ishte një njeri krejtësisht si ne, por një profet i mrekullueshëm dhe që kishte një trashëgimi. **Gjaku i shenjtë** që flitej në libër ishte gjaku, pra trashëgimia e Jezu Krishtit, kurse **Kupa e shenjtë** simbolizonte mitrën e Maries, si rrjedhojë sërish trashëgiminë e shenjtë.


Maria Magdalena, gruaja me të cilën ishte martuar Jezu Krishti sipas doktrinës zyrtare kishtare emri i saj ishte **Lavirja e Shenjtë**. Pohimi më interesant në këtë libër është se të krishterët e vërtetë që ishin nga familja e ngushtë e Jezu Krishtit nuk ishin shumë efikas, kështu që emigruan në Egjipt dhe u fshinë nga faqja e historisë.

Është shumë e qartë që libri që përmban këto mendime në mënyrë bindëse i shqetëson të krishterët, por sidoqoftë, teoria e Don Brown-it që Jezu Krishti është martuar me Maria Magdalenën dhe që gjaku i tij vazhdon deri në ditët e sotme nuk është ndonjë tezë e re. Libri hyri në listën best-seller (më të shiturve) për arsye se kishte një rrjedhshmëri dhe për aspektin enigmatik që rridhte nga sim-

bologjia, aq sa bëri të dalin në treg edhe imituesit e tij.

Vitin e kaluar në Shqipëri “Kodi i Da Vinçit” i Don Brown-it ishte një nga pesë librat më të shitur. Ndërsa këto ditë po përfaqësohet me tre libra. Libri tjetër i tij “Engjëjt dhe djajt” e ruan të njëjtën rrjedhshmëri. Edhe në këtë vepër ai sjell në formë romani tensionin mes fesë dhe shkencës. Në librin me rreth 560 faqe, Papa që ishte në krahun e engjëjve, deri në faqen 550, ndërkohë që po e ngjiste lart e më lart, në dhjetë faqet e fundit e hedh nga ajo lartësi në fundet e humnerave. Lexuesi sapo do të thojë “sa e nevojshme qenka feja dhe kleriku fetar, shkenca qenka fatkeqësi” papritmas –gjoja- mëson se po gabon. Faktikisht, një metodë e tillë është më efikase sesa efekti që mund të bëjë një libër që është krejtësisht kundër fesë. Dialogje të këtij lloji, që tregojnë përplasjen mes fesë dhe shkencës që ka pasur historia e botës së krishterë janë të shumtë. Ajo çfarë mund të nxjerrim mësim nga kjo është se me sa duket shkrimtari ka performancë. Brown-i njih shkëlqyeshëm temat e përgjithshme dhe pikat kyçe të fesë, hollësitë e shkencës, artin dhe historinë e artit, gjeografinë e Italisë, simbolologjinë dhe teknikat e shkrimit të romanit. Kjo do të thotë se një njeri kaq i talentuar mund të shesë lehtë kërmilla në fshatin e myslimanëve!

Sado që tek lexuesi shqiptar arrin vetëm ndonjë që është shumë i publikuar, raftet e librarive perëndimore janë të mbushura me llojet e tyre. Librat që bëjnë fjalë për fe apo për ndonjë sekt na paraqiten herë në formën e ndonjë romani të rrjedhshëm, herë në një dokumentar enigmatik dhe nga-njëherë në një film që përmban skena horrori. Madje edhe personat që nuk janë shumë të interesuar për çështjet fetare i



bën për vete në një mënyrë. Për këtë është e nevojshme të përmendim pohimin interesant të amerikanit Texe Mars. Sipas tij, fuqitë e mëdha po planifikojnë një vizion me përmbajtje “sistemi pas kaosit”. Çdo vlerë e ndërtuar për mijëra vite në botën tonë të vjetër duhet atrofizuar dhe pasi të formohet kaosi duhet ndërtuar një sistem i ri. Tek vlerat që duhen asgjësuar janë edhe ato të çdo feje e çdo kulture. Kur në planin krahinor, mentaliteti që i barazpeshon perandorët më të nderuar të Osmanëve me njerëzit me çrregullime seksuale; në rrafshin global edhe Hz. Isain e përfshin me ata.

Thonë se një gënjeshtër që thuhet 40 herë bëhet e vërtetë. Njerëzit në mesin e këtyre informacioneve të ndyra arrijnë në një gradë që të mos dinë se në cilin port të strehohen që të zgjidhin ç’është e drejtë dhe ç’është e shtrembër. Është e pasdiskutueshme që po shkohet për në kaos në të gjitha vlerat, por, pastaj a do formohet ndonjë sistem apo rregull?

Nëse po, i kujt do jetë ky sistem?

E gjithë lufta për këtë është me sa duket...

Në një kohë ka jetuar një Sulltan i fuqishëm, që kishte katër gra. Sulltani më shumë donte gruan e katërt. I kushtonte interes të veçantë dhe bënte çfarë donte ajo.

Ai në çdo moment të ditës rrinte me të, e mbante vazhdimisht para syve dhe nuk i bëhej që të ndahej prej saj. Sulltani i mëshirshëm dhe zemërgjerë edhe gruan e tretë e donte mjaft, por nga frika se një ditë ajo mund ta linte, ishte shumë xheloz dhe dridhej për të. Edhe pse ishte shumë xheloz për të, ai kishte kënaqësi kur atë jua prezantonte të tjerëve.

Nuk ishte e pakët dashuria e Sulltanit autoritar edhe për gruan e dytë. Ai, kësaj gruaje të dureshme dhe të respektueshme i rrinte afër dhe e mbështeste sa herë që ajo kishte nevojë. Gruaja e parë dhe e dyta kishin disa sjellje të veçanta ndaj tij, por megjithatë sulltani ndihej më i qetë dhe më i sigurt tek gruajeja e tretë.

Gruaja e parë e Sulltanit ishte zonja (e para) e sarajit. Kjo edhe pse ishte gruaja që e donte më shumë Atë, ishte ajo që kishte kontribuar më shumë për Salltanatin e Tij, por Ai nuk interesohej shumë për të. Ajo edhe pse i rrinte Sulltanit vazhdimisht afër, kishte raste që Ai as nuk e vinte re.

Si çdo qenie e gjallë edhe Sulltanit i erdhi fundi i jetës. U sëmur nga një sëmundje vdekjeprurëse. E kuptoi se po vdiste. Ngaqë frikësohej shumë të rrinte vetëm, deshi të dinte se cila nga gratë e tij do ta shoqëronte atë në vetminë e vdekjes.

Në fillim pyeti gruan e katërt që më shumë e kishte dashur, se a do ta shoqëronte në vetminë e vdekjes apo jo. Përgjigja që

mori nga ajo e theri si thikë në zemër. Gruaja, të cilën e kishte dashur më shumë ju përgjigj:

- Është e pamundur o prijës!

Sulltani u mërziq shumë, u brenog jashtë mase, por nuk e humbi shpresën dhe ju drejtua gruas së tretë duke i thënë:

- Ty të kam dashur gjithë jetën, a pranon ti tani që të vdesësh bashkë me mua? Edhe gruaja e tretë pa më të voglin hezitim ia ktheu

- Jo, jeta është e bukur. Pasi të vdesësh ti, unë do të martohem përsëri.

Pas kësaj, Sulltani u mërziq jashtëzakonisht shumë dhe ju shtuan edhe më tepër dhimbjet e vdekjes. Ju kthye gruas së dytë:

- Ti gjithmonë më ke qëndruar afër, nuk më ke lënë asnjëherë vetëm, sa herë që të kam kërkuar ndihmë e ke zgjatur dorën për të më ndihmuar, gjithmonë e kam ndjerë veten të sigurt pranë teje. Tani unë po vdes, nuk dua që të shkoj vetëm në këtë rrugë, prandaj a më shoqëron ti?

Edhe prej gruas së dytë mori këtë përgjigje:

- Kisha dashur, por nuk kam mundësi të të ndihmoj në këtë gjë. Gjëja e vetme që mund të bëj për ty është shoqërimi deri tek varrezat dhe mund të sigurohesh se do të mbaj zi për ty, por nuk mund të bëj gjë më tepër.

Mendoni gjendjen e këtij Sulltani pas këtyre përgjigjeve të dhëna nga tri gratë e tij, të cilave gjithë jetën nuk ju kishte munguar dashuria, respekti dhe interesimi i tij. Pas kësaj i erdhi në mendje gruaja e parë, por atë nuk e pyeti,

për shkak të përgjigjeve të tri grave tjera dhe për atë që gjatë gjithë jetës nuk ishte interesuar siç duhet për të, por ajo kuptoi çdo gjë, dëgjoi edhe përgjigjet e grave të tjera dhe e ndodhur afër shtratit të tij, me një respekt të madh i tha:

- Sulltani im! Unë jam pranë teje dhe kudo që të shkosh ti unë do të jem me ty. Sulltani u habit shumë dhe u mërziq njëkohësisht. Ai ndjeu një lloj pendese për sjelljet e tij ndaj saj. I turpëruar dhe me keqardhje i tha:

- Sikur të më jepej edhe një mundësi, do ta jepja hakun tënd. Në të vërtetë në jetën e kësaj bote të gjithë Ne jemi sulltanë me katër gra.

Gruaja jonë e katërt është trupi jonë, sado që të merremi me të që të duket sa më bukur, kur të vdesim ai do të na braktisë.

Gruaja jonë e tretë është pasuria dhe posti ynë që me vdekjen tonë bëhen të tjera kujt.

Gruaja e dytë është familja dhe miqtë tanë. Çdo gjë e ndajmë me ata, kur vdesim derdhin lot për Ne, por nuk vijmë me Ne në ahiret sado që të na duan.

Ndërsa gruaja e parë është shpirti ynë. Nëse do të jemi të pakujdesshëm, si Sulltani në ndodhinë e mësipërme, do ta neglizhojmë gjithnjë atë edhe pse ai është vazhdimisht me Ne.

Personaliteti Shembullor

Prill
Maj
Qershor
2007 | 7

ETIKA

Osman Nuri TOPBASH

Përsosja e një besimtari me cilësitë e tij shpirtërore mund të arrihet nga jeta shpirtërore dhe moralet madhore me të cilat qe pajisur Nderi i Gjithësisë, Muhammedi (a.s.). Kjo situatë realizohet në shkallën e dashurisë që ndjejmë ndaj Profetit (a.s.) dhe mbështjelljen tonë me botën e Tij të përsipirtshme.

Pasi e gjithë bota njerëzore kishte dëgjuar nga gjuha e bekuar e Të Dërguarit të Allahut (a.s.) meloditë hyjnore që i dhurojnë shërim dhe prehje shpirttrave njerëzorë, njerëzimit iu ofrua oqeani i paanë dhe i pafund i faljes dhe mirësjelljes hyjnore të të Gjithëmëshirshmit në shenjë respekti ndaj dashurisë së asaj krijese prej drite. Po

kështu megjithë mëkatet e kryera, njerëzimi e pat mbërritur të drejtën që të dëgjojë thirrjen e përzemërt të Allahut në formën **O robërit e Mi** për shkak të pënderimit të Zotërisë së Botëve.

Detyra që na bie ne mbi supe, Ummetit Muhammed përkundrejt gjithë kësaj bamirësie, respektimi që na bëhet dhe komplimenteve që na drejtohen është të mund të jetojmë sa më shumë të mundemi brenda botës së përsipirtshmërisë së Traditës së Lavdëruar të Tij duke u lidhur me mish e me shpirt pas urdhërave, ndalesave dhe këshillave që Ai na ka lënë pas.

Zoti ynë i ka dhuruar Zotërisë sonë Postin e Lavdërueshëm (Makam-ı Mahmud) që është

pozita më e lartë dhe e ka pajisur me këshilla që i përshtaten madhësisë së pozitës që Ai e meriton. Edhe Profeti ynë, për shkak të **zemërdhembshurisë dhe mëshirës** që ndjente për bashkësinë e tij, kishte ndjerë thellë në vetvete dëshirën që edhe bashkësia e tij të vepronte sipas këshillave hyjnore që ju shpallën. Një pjesë nga ato këshilla po i paraqesim më poshtë:

a. Zotëria ynë (a.s.) urdhëron e thotë:

Zoti im më urdhëroi që në çdo situatë intime apo publike të mbështillem në ndjenjën e frikës hyjnore dhe t'ia kem frikën Atij (këtë ua këshilloj edhe juve).

Resulullahu (a.s.), i cili e kry-



ente me përpikmëri çdo urdhër hyjnor që i jepej edhe këtë urdhër e zbatonte siç duhej dhe rreth kësaj pat thënë:

- *Betohem në Allahun se unë jam ai që i frikësohem më shumë dhe e adhuroj më shumë Allahun nga të gjithë ju.* (Buhari, Nikah, 1) Përherë kur dëshironte të ngrihej dhe të largohej nga ndonjë tubim lutej duke thënë:

- *Allahu im! Dhurona nga ajo frikë që vë pengesë mes nesh dhe mëkateve njerëzore.* (Tirmidhi, Deavat, 79)

Kjo për arsye se Zotëria ynë qe edhe personi i bekuar në mesin e njerëzve që u pajis me shfaqjet kulmore të njohjes nga afër të Allahut të lartësuar. Një ditë prej ditësh i pat thënë kështu shokëve të tij që e rrethonin:

- *Po të dinit ju ato që di unë do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë.*

Sahabet patën mbuluar fytyrat e tyre dhe patën nisur të qanin me ngashërim. (Buhari, Tefsir, 5 12).

Allahu i Lartësuar u ka premtuar parajsën robërve të Tij që ia kanë frikën edhe në publik edhe kur janë vetëm. Në ajetet fisnike të Kuranit thuhet:

Kushdo që ia ka frikën ditës që do të dalë në agorën hyjnore dhe do të japë llogari dhe për këtë e mban egon e tij larg prej dëshirave të ulta nuk ka dyshim se vendi ku do të mbërrijë është parajsja. (en-Naziat, 40-41)

Ja parajsja që u premtohet. Ajo u takon atyre njerëzve që i drejtohen Allahut, i përmbahen urdhërave të Tij, ia kanë frikën Mëshiruesit megjithëse nuk e shohin dhe vijnë me zemrat e kthyer nga Zoti i tyre. (Kaf, 32-33)

Ata ngrihen nga shtretërit e tyre, i luten Zotit të tyre me frikë dhe shpresë dhe shpenzojnë në bamirësi nga begatitë që u kemi dhënë. (es-Sexhde, 16)



Për këtë arsye edhe jeta e natës e profetëve dhe miqve të Zotit, të cilat i kalonin me frikë ndaj Zotit dhe shpresë ndaj mëshirës së pafund të Tij, janë më të ndriçuara dhe të kulluara nga ditët e jetës, sepse netët e tyre qenë të mbushura me përshpirtshmërinë dhe prehjen hyjnore të sexhdeve të frymëzuara me lot të derdhur.

Për këtë arsye edhe jeta e natës e profetëve dhe miqve të Zotit, të cilat i kalonin me frikë ndaj Zotit dhe shpresë ndaj mëshirës së pafund të Tij, janë më të ndriçuara dhe të kulluara nga ditët e jetës, sepse netët e tyre qenë të mbushura me përshpirtshmërinë dhe prehjen hyjnore të sexhdeve të frymëzuara me lot të derdhur.

b. Zotëria ynë urdhëron dhe thotë:

Zoti im më urdhëroi të

gjykoj me drejtësi edhe në momentet që jam i revoltuar edhe atëherë kur jam i qetë (këtë ua këshilloj edhe juve).

Momentet e zemërimit dhe revoltimit janë çastet, kur është e vështirë të ruhet paanshmëria dhe kur mundesh shumë lehtë të humbësh ekuilibrin dhe të shmangesh nga drejtësia. Në situata të tilla duhet që përherë me një durim të madh ta kujtojmë Allahun dhe botën e përtejme dhe të veprojmë me kujdes që të mos shkasim në padrejtësi.

Allahu i Lartësuar urdhëron dhe thotë:

...Mos u shmangni nga drejtësia duke shkuar pas dëshirave tuaja egoiste. (en-Nisa, 135)

...Silluni përherë me drejtësi. Me të vërtetë Allahu i do sjelljet e drejta. (el-Huxhurat, 9)

Edhe në një hadith në të cilin flitet rreth temave të ndryshme, i Dërguari i Allahut mes të tjerash urdhëron dhe thotë:

Ekzistojnë tri pika që ju shpëtojnë:

1. Të silleni me drejtësi edhe kur jeni të zemëruar edhe kur nuk jeni të tillë.

2. Të silleni me nikoqirllëk (bujari) edhe kur jeni të varfër edhe kur të jeni të pasur.

3. Ta keni frikë Allahun edhe në publik edhe në jetën intime. (Hejthem, I, 90)

Personit të ardhur për të ndërmjetësuar në mënyrë që dënimi të mos zbatohet në një rast vjedhje, Profeti Muhammed (a.s.) ju pat drejtuar me këto fjalë duke dhënë si shembull vajzën e tij më të dashur:

- *Betohem në Allahun se po të vidhte edhe Fatimja e bija e Muhammedit do t'ia kisha prerë dorën edhe asaj.* (Buhari, Enbija, 54)

Për të pasur shoqëri dhe individ të lumtur drejtësia është e domosdoshme. Mbi këtë të vërtetë mëton edhe Umeri (r.a.) me fjalët e tij lakonike:

- Drejtësia është themeli i pronësisë.

Shtrirja e kufinjve të hilafetit deri në Spanjë dhe jetesa e sigurtë dhe e qetë e popullsisë gjatë hilafetit të Umer bin Abdulazizit që zgjati 2 vjet e gjysëm nga 92 vjet që zgjati hilafeti Emevi, i cili në historinë Islame numërohet si halifi i pestë më i madh, qe rezultat i ligjit dhe drejtësisë që përhapoi ai tejmbanë shtetit që drejtonte. Ashtu sikurse nuk ka mirëqenie në një klimë terrori, edhe shtetet nuk mund të qëndrojnë në këmbë po nuk pati drejtësi. Po ashtu edhe ngjarja në historinë otomane e rastit kur gjatë një mosmarrëveshje midis sulltan Mehmed Fatihut dhe një arkitekti të krishterë kadiu i caktuar nga vetë sulltani Hëzër Beu gjykoi në disfavor të padishahut, sepse e gjeti atë në faj është vetëm një nga shfaqjet e bazave të drejtësisë që i siguroi vazhdimësinë shekullore perandorisë Osmane.

c. I Dërguari i Allahut urdhëron dhe thotë:

Zoti im më urdhëroi të sillem me nikoqirllëk edhe në ditët e pasura edhe në ditët me skamje (këtë ua këshilloj edhe juve).

Njeriu duhet treguar nikoqir edhe kur të ketë pasuri, edhe kur të jetojë në skamje sipas caktimit hyjnor dhe nuk duhet të kalojë në harxhime të tepërta në asnjë çështje dhe në asnjë situatë.

Profeti (a.s.) na ka këshilluar t'ia dimë vlerën pasurisë para se të vijë skamja.

Allahu i Lartësuar e urdhëron kështu nikoqirllëkun:



Nga ky aspekt besimtari duhet të jetë çdo moment i vetëdijshëm se pronari i vërtetë i pasurive është Allahu. Ai duhet ta konceptojë pasurinë si amanet që i është dhënë dhe duhet ta përdorë atë sipas nevojave, ndërsa pjesën tjetër duhet ta shpenzojë në rrugën e Allahut.

...Mos shpenzo pa pra aty ku nuk duhet. Ata që shpenzojnë pa gajle janë miqtë e djallit. Djalli u tregua shumë mosmirënjohës ndaj Zotit të tij. (el-Isra, 26-27)

Mos u bëj koprrac dhe t'i mbash duart mbyllur përherë, por edhe mos e lësho dorën dhe të rrih e të shpenzosh, pastaj pendohesh e rri duke kujtuar (ato që humbe). (el-Isra, 29)

Sërish Profeti (a.s.) urdhëron

dhe thotë:

Ata që tregohen nikoqir dhe rrinë larg shpenzimeve nuk ia kanë nevojën kujt. (Ibn Hanbel, I, 447)

Ai që fal istihare nuk humbet, ai që u merr mendimin të tjerëve nuk pendohet, ai që sillet nikoqir nuk bie në varfëri. (Hejthemi, Mexhmau'z-Zevaid, II, 280)

Nga ky aspekt besimtari duhet të jetë çdo moment i vetëdijshëm se pronari i vërtetë i pasurive është Allahu. Ai duhet ta konceptojë pasurinë si amanet që i është dhënë dhe duhet ta përdorë atë sipas nevojave, ndërsa pjesën tjetër duhet ta shpenzojë në rrugën e Allahut.

Allahu i Madhëruar urdhëron dhe thotë:

... Të pyesin se çfarë të dhurojnë për bamirësi. Thuaju: Atë që mbetet pasi t'i plotësoni nevojat tuaja... (el-Bekare, 219)

Profeti Muhammed (a.s.) urdhëron e thotë kështu duke na këshilluar shpirtmadhësinë edhe në kohët kur mundësitë materiale janë të kufizuara:

Ruajuni nga zjarri i xhehenemit qoftë edhe me një kokërr hurmë. Ai që nuk mund ta gjejë edhe këtë atëherë me fjalë të bukura dhe të ëmbla. (Buhari, Edeb, 34)

Lumturia e vërtetë e kamjes dhe pasurisë fitohet me kryerjen e bamirësive në rrugën e Allahut. Bamirësia në rrugën e pëlqimit të Allahut dhe të fituarit në rrugë hallall për të kryer shërbime të denja kush tëzton të shpenzuarit duke mos i vënë mundësitë materiale në një peshore me përshpirtshmërinë.

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: *Sa e mirë është pasuria e vlefshme dhe e pastër nga mëkatet në duart e njeriut të devotshëm.* (Ibn Hanbel, IV, 202)

Njeriu i devotshëm është i shkur me cilësitë e mëshirës dhe zemërdhembshurisë. Mëshirë do



të thotë të gostitësh me atë që zotëron njerëzit që nuk i kanë ato. Me fjalë të tjera mëshirë do të thotë të shpejtosh t'i ndihmosh të tjerët që të zëvendësojnë gjërat që u janë privuar në jetë. Mëshira dhe dhurimi janë sihariqet e prehjes shpirtërore në këtë botë dhe lumturisë së përhershme në botën tjetër.

Në shoqëri janë të rrallë njerëzit që cilësohen si **agnija-i shakirin**, pra të pasurit që e falënderojnë Zotin dhe kryejnë vepra bamirësie dhe **fukara-i sabirin**, pra të varfërit që bëjnë durim. Për këtë arsye të dy grupet e besimtarëve janë robërit e pranuar në agorën hyjnore. **Të pasurit falënderues dhe bamirës dhe të varfërit durimtarë dhe dinjitozë janë të barabartë në shkallën e krenarisë njerëzore dhe pëlqimit hyjnor.**

Në fenë Islame janë kritikuar të pasurit mendjemëdhenj dhe dorështrënguar si dhe të varfërit

që nuk bëjnë durim për atë që u është caktuar dhe ngrenë krye. Për këtë arsye, Pejgamberi Muhammed (a.s.) i është lutur Zotit duke thënë:

O Zoti im! Të mbështetem Ty të më ruash nga ngatërresat që shkaktojnë varfëria dhe pasuria. (Muslim, Dhikr, 49)

Prandaj personi tek i cili gjenden cilësitë e larta siç janë të kënaqurit me atë që ka, mbështetja tek Zoti dhe nënshtrimi ndaj Tij është i pasuri e vërtetë. Edhe mbretëria e vërtetë e pasurisë qëndron në këmbë në sajë të lumturisë së bamirësisë.

Kur u shpall kushtrimi për bamirësi me rastin e betejës së Tebukut edhe sahabet që nuk kishin ndonjë mundësi materiale u mbushën me emocionin e sakrificës me pasuritë dhe jetët e tyre. Njëri prej tyre Ebu Akili (r.a.) fitoi gjysëm kile hurma pasi kishite punuar një natë të tërë. Një çerek prej tyre ia kishte dërguar familjes së tij, ndërsa një çerek ia pat dhuruar ushtarëve që niseshin për në Tebuk.

Me të mësuar këtë gjë Muhammedi (a.s.) pat thënë:

- Allahu e bekoftë edhe atë që na solle, edhe atë që le pranë familjes tënde.

Pastaj i pat zbrazur me duart e tij hurmat në mesin e ndihmave që po mblidheshin.

Një ditë prej ditësh Profeti (a.s.) tha:

- E d h e një mijë dirhemët ia kaluan njëqind mijë dirhemëve.



Mëshirë do të thotë të gostitësh me atë që zotëron njerëzit që nuk i kanë ato. Me fjalë të tjera mëshirë do të thotë të shpejtosh t'i ndihmosh të tjerët që të zëvendësojnë gjërat që u janë privuar në jetë. Mëshira dhe dhurimi janë sihariqet e prehjes shpirtërore në këtë botë dhe lumturisë së përhershme në botën tjetër.

Sahabet e pyetën:

- E kur ndodh kështu, o i Dërguar i Allahut?

Ai u përgjigj:

- Një njeri kishte vetëm dy dirhemë. Ai dhuroi nga këto dy dirhemin më të vyer për të. Një tjetër që kishte pasuri shumë më të mëdha mori prej tyre vetëm njëqind mijë dirhem dhe i dhuroi. (Nesai, Zekat, 49)

Kjo do të thotë se i pari dhuroi gjysmën e asaj nga e tëra prej së cilës kishte nevojë, ndërsa i dyti megjithëse kishte shumë më tepër pasuri nga ajo që dhuroi i pari, dhuroi vetëm një pjesë të vogël nga ajo që kishte. Kjo do të thotë se pranimi i bamirësisë më shumë se sasia e shumtë e saj varet nga shkalla e ndjenjës së sakrifikimit që gjendet në shpirt. Për shembull akti që kryen tre dëshmorët myslimanë që lëngonin nga etja pas betejës së Jermukut duke kërkuar që gota e ujit t'i jepej më parë shokut pranë, përbën një shembull të paparë nga aspekti i shkallës së ndjenjës së bamirësisë që gjendet në shpirta.

Ja pra, ideali i brezit të sahabeve që të visheshin me cilësitë e moralit që gëzonte i Dërguari i Allahut. Për këtë arsye mëshira dhe asketizmi u ngrit në pedestal tek ata, sepse ajo shoqëri jetonte





një jetë të përkorë. Konsumimi pa kriter, luksi, të mbajturit me të madh ishin një model jetese, që sahabet nuk e patën pranuar. Të pasurit nga mesi i tyre qenë të kamurit falënderues, ndërsa të varfërit prej tyre qenë skamnorët durimtarë. Edhe Profeti Muhammed (a.s.) qe shembulli më i përkryer i të kamurve falënderues kur përpara i shtroheshin plaçkat e luftës dhe i skamnorve durimtarë atëherë kur në shtëpi nuk gatuhej ushqim prej ditësh apo kur detyrohej të lidhte gur pas barku për shkak të urisë.

d. I Dërguari i Allahut urdhëroi dhe tha:

- Zoti im më urdhëroi të mbaj marrëdhënie të ngushta edhe me ata që i presin ato me mua (këtë ua këshilloj edhe juve).

Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar me ngulm robërit e Tij që t'i ruajnë marrëdhëniet me farefisin e tyre dhe t'i respektojnë e t'u gjenden pranë. I Dërguari i Allahut (a.s.) e bëri të qartë rëndësinë që ka vizita e farefisit, përkrahja dhe ndihma ndaj tyre duke thënë:

Allahu i Lartësuar më dërgoi me detyrën që t'i përkrah dhe të

kujdesem për farefisin, t'i thyej idhujt dhe të shpall, se Allahu është një dhe se nuk duhet bërë shirk ndaj Tij. (Muslim, Musafirin, 294)

Po qe se farefisi nuk i përgjigjet rëndësisë që ne tregojmë ndaj tyre, madje përpiqen t'i shkëpusin marrëdhëniet me ne është një detyrim që na e obligon besimi ynë të vazhdojmë lidhjet me ta dhe t'i urdhërojmë me gjuhën e duhur që të kryejnë vepra të mira. Në një hadith thuhet:

Ai që i përgjigjet me të njëjtën masë sjelljeve të mira që u bën farefisi nuk numërohet se e ka kryer detyrën e përkrahjes së farefisit. Ai që e përkrah me të vërtetë farefisin e tij është ai që i vazhdon marrëdhëniet e mira me ta edhe kur ata i largohen dhe i qëndrojnë ftohtë. (Buhari, Edeb, 15; Ebu Davud, Zekat, 45)

Shembulli i përkryer edhe në këtë rast është sërish Profeti Muhammed (a.s.). Ai sa herë që do të priste një kurban i çonte pa tjetër një pjesë prej tij edhe farefisit të Hatixhes.

Ai thoshte:

- Mësojeni farefisin tuaj në atë masë sa do të mund të plotësonit detyrat tuaja ndaj tyre. (Ali el-Muttaki, Kenz, X, 220, nr. 29162)

Allahu i Lartësuar e shpreh

në këtë ajet faktin se si do të shkojnë në humbje ata që nuk i kushtojnë rëndësi detyrës që kanë për të përkrahur farefisin dhe që nuk i mbështesin ata:

Ata që e thyejnë fjalën që i kanë dhënë më përpara Allahut. Ata i presin marrëdhëniet me ata që duhet të jenë të bashkuar dhe krijojnë ngatërresa në botë. Ja ata janë të humburit. (el-Bekare, 27)

(O munafikë!) Po qe se ju vini në krye të punëve në tokë lindin ngatërresa dhe i preni marrëdhëniet tuaja me farefisin, apo jo? Ja këta janë njerëzit që Allahu i ka mallkuar, veshët e të cilëve i ka bërë të shurdhër, sytë e të cilëve i ka bërë të verbër. (Muhammed, 22-23)

I Dërguari i Allahut e ka shprehur me këto fjalë se në çfarë humbjeje të tmerrshme do të gjenden ata që nuk i kushtojnë rëndësi marrëdhënieve të mira farefisnore:

Ai që i pret marrëdhëniet farefisnore nuk hyn në paraajsë. (Buhari, Edeb, 11)

Mëkatet që meritojnë të ndëshkohen sa më herët në këtë botë përveç dënimit që do të marrin në botën tjetër, janë padrejtësia dhe lënia pas dore e marrëdhënieve me të afërmit. (Ebu Davud, Edeb, 43; Tirmidhi, Kijame, 57)

e. I Dërguari i Allahut urdhëron dhe thotë:

Zoti im më urdhëroi t'i jap atij që më lë pa gjë kur kam nevojë për të (këtë ua këshilloj edhe juve).

Në ajetin Kuranor thuhet:

Të bësh mirë nuk është e barabartë me të bërët keq. Ti parandaloje të keqen me mënyrën më të mirë. Atëherë personi mes teje dhe të cilit ka armiqtë të bëhet shok për shpirt. (Fussilet, 34)

Në hadithin fisnik thuhet:

Mos e ndërprit interesimin tënd ndaj atij që e ka bërë këtë gjë me ty. Dhuroji atij që nuk të jep. Fale atë që të bën keq. (Ibn Hanbel, IV, 148, 158)

Në vitin e shtatë pas Hixhretit në Mekke pat nxjerrë krye thatësia dhe zia e bukës. I Dërguari i Allahut i pat ndihmuar Mekkasit, të cilët për një periudhë 20 vjeçare i patën shpallur luftë të paparë duke u dërguar ar, hurma dhe grurë. Ebu Sufjani që i kishte marrë në dorëzim të gjitha këto ua pat shpërndarë më pas të varfërve nga mesi i Mekkasve.

Njeriu dorëzohet përpara bamirësisë. Ndihma dhe përkrahja e zbut edhe armiqtë inë e armikut madje. Për shkak të kësaj ndihme ekonomike që profeti Muhammed (a.s.) u bëri të varfërve të Mekkes edhe Ebu Sufjani madje, meqë i ishin zbutur ndjenjat e vrazhdësisë dhe armiqtë ishin që ushqente në zemër e pat shprehur me këto fjalë lumturinë që përjetonte në ato çaste:

Zoti e shpërbleftë me të mira birin e vëllezërve tanë. Ai e përbushu si duhet detyrën e tij ndaj farefisnisë. (Jakubi, Tarih, II, 56)

Përballë kësaj shpirtmadhësie dhe akti sublim shumë nga njerëzit u nderuan me përkatësinë Islame.



Edhe Jusufi (a.s.) është një shembull i bukur në këtë pikë. Vëllezërit e tij nuk e mposhtën smirën e tyre ndaj tij vendosën dhe e hodhën në pus. Kur erdhi dita ai i priti ata në mënyrën më të bukur dhe pa e shprehë në fytyrë gabimin e madh që kishin bërë i fali. Para kësaj situatë ata thanë:

Betohemi se Zoti të ka caktuar ty epror mbi ne. Ne me të vërtetë kemi gabuar rëndë. (Jusuf, 91)

Shkurtimisht, për t'i udhëzuar njerëzit drejt Allahut dhe akteve të mira duhet përherë të gjejmë rrugën që shkon drejt e tek zemrat e tyre. Shtegu më i afërt që na shpie atje është bujaria, zemërdhembshuria dhe ndjenja e faljes. Me këto virtyte shpirtërore mund të bëjmë vepra bamirësie mbi robërit e Allahut.

Të mund të përfitojmë nga dashuria e Allahut duke u shndërruar në besimtar të plotësuar me virtytet që i takojnë, du-

Edhe Profeti Muhammed (a.s.) qe shembulli më i përkryer i të kamurve falënderues kur përpara i shtroheshin plaçkat e luftës dhe i skamnorve durimtarë atëherë kur në shtëpi nuk gatuhej ushqim prej ditësh apo kur detyrohej të lidhte gur pas barku për shkak të urisë.

het ta mbajmë përherë në zemër **frikën e Allahut**, qoftë kur jemi të kënaqur me ata që na rrethojnë, qoftë edhe kur jemi të nxehur, pra në asnjë situatë **nuk duhet të ndahemi nga drejtësia**. Duhet të shpenzojmë në rrugë të Zotit sipas mundësive që kemi duke u treguar të matur në shpenzime edhe kur jemi të pasur, edhe kur jemi të varfër, **nuk duhet t'i shkëpusim mar-**

rëdhëniet tona me farefisën, duhet t'i dhurojmë edhe atij që na i privon mundësitë dhe duhet t'i falim me shpirt edhe ata që na bëjnë të padrejtë.

Një ditë prej ditësh ëngjëlli Xhebrail ia pat tërhequr vëmendjen profetit Muhammed (a.s.) rreth tre çështjeve për shkak të rëndësisë që ato kanë. Kab bin Uxhre (r.a.) rrëfen:

I Dërguari i Allahut na kërkoi që të qëndronim ulur përpara minberit. Edhe ne u ulëm ashtu siç ishim që të gjithë përballë minberit. Profeti po hipte një shkallë të minberit kur dëgjua të thoshte Amin!. E dëgjua të thotë sërish Amin!, ndërsa shkelte në shkallën tjetër. Kur hipi të tretën e dëgjua të thotë sërish Amin!

E pyetëm:

- O i Dërguari i Allahut! Sot dëgjua nga goja juaj gjëra që nuk i kishim dëgjuar më parë. Ai u përgjigj:

- Teksa qëndroja në minber erdhi Xhebraili. Kur isha në shkallën e parë m'u drejtua me këto fjalë:

- Mos e paftë mëshirën e Allahut ai person që e mbërrin muajin e Ramazanit dhe kur ai të ketë përfunduar të mos i jenë falur mëkatet.

Unë thashë:

- Amin!

Tek isha në shkallën e dytë ëngjëlli tha:

- Mos e paftë mëshirën e Allahut ai person që nuk lexon salavat për ty, kur të të përmendet emri.

Unë thashë:

- Amin!

Kur hipa në shkallën e tretë Xhebraili tha:

-Mos e paftë mëshirën e Allahut

ai njeri që nuk e fiton parajsën edhe nëse ia ka arritur ditës që prindërit e tij apo njëri prej tyre ta ketë mbërritur moshën e thyer pranë tij.

Dhe unë u përgjigja

- Amin. (Hakim, Mustedrek, IV, 170)

Sipas përmbajtes së këtij hadithi ne duhet të tregojmë kujdes në këto tri pika:

1. Në ditët e bekuara fetarisht, atëherë kur mëshira hyjnore vërshon pa pushim, duhet t'i gëzojmë sa më shumë zemrat e prindërve tanë, në qoftë se ata janë ndarë nga kjo jetë le të japim sadaka dhe



Po që se farefisi nuk i përgjigjet rëndësisë që ne tregojmë ndaj tyre, madje përpiqen t'i shkëpusin marrëdhëniet me ne është një detyrim që na e obligon besimi ynë të vazhdojmë lidhjet me ta dhe t'i urdhërojmë me gjuhën e duhur që të kryejnë vepra të mira.

leximet e kënduara për to t'ua dhurojmë shpirt-rave të tyre.

2. Duhet ta shtojmë përditë e më shumë dashurinë që kemi për Profetin Muhammed (a.s.) dhe ta kthejmë në udhërrëfyesin tonë personalitetin e tij shembullor në çdo hap të jetës.
3. Gjatë muajit të Ramazanit të përgatitemi shpirtërisht për bash-

këbisedimin tonë me Zotin dhe të përpiqemi që agjërimin ta kryejmë me të gjithë organet tona të trupit. Në mënyrë të veçantë gjuha jonë duhet të përhapë mëshirë. Le të përpiqemi të përfitojmë sa më shumë nga klima shpirtërore që rrethon natën e Kadrit. Me zekatet dhe sadakatë që japim t'i gëzojmë shpirtërat e nevojtarëve, jetimve dhe të papërkrahurve. Botën tonë të brendshme ta krehim në lutjet e ndërgjegjësimit të festimit të bajramit të vërtetë me prehjen e përshpirtshme me të cilën mund të hyhet në zemër.

Zoti ynë na bëj të mundur të gjithëve që të mund t'i reflektojmë ditëve të tjera të jetës sonë begatinë dhe përshpirtshmërinë që jetohet gjatë muajit të Ramazanit! Për nder të këtyre ditëve dhe muajve të bekuar na dhuro të gjithëve të jemi nga robërit që do i Dashuri i Allahut duke shkuar gjurmëve të urdhërave dhe këshillave të tij ashtu siç e ndjek hija të zotin e saj! Na vish me petkun e moralit të profetit Muhamedit (a.s.) i cili është personaliteti shembullor për botën mbarë dhe na përfshi në grupin e robërve të mirë që janë dëshmitarët e Zotit në këtë botë!...

Amin!

Përktheu: Ermal NURJA

Sadik DANA



Është e nevojshme që çdo besimtar kur të ngrihet në agim të bëjë sexhde, të bëjë ibadet (adhurim Allahut), sepse koha e agimit është një ndër të mirat më të rëndësishme që Allahu (xh.xh) ju ka dhënë robërve të vet. Kjo është koha kur besimtarët e devotshëm braktisin shtretërit e tyre të ngrohtë në dimër dhe i drejtojnë zemrat dhe shpirtrat e tyre nga krijuesi i gjithësisë. Është kohë të cilën besimtarët e devotshëm e kalojnë me namaz, me lutje, me tevbe, me dhikër e me adhurime të tjera. Koha e agimit është një lloj feste me krijuesin e tyre për ata që e vlerësojnë, ndërkohë që shumë njerëz janë të pakujdesshëm ndaj saj. Kjo është një kohë në të cilën zbret mëshira e Allahut nga Qielli sikur Shiu, e cila rrezaton në zemrat e atyre që e vlerësojnë siç duhet këtë kohë. Këta besimtarë në këtë kohë shoqërohen edhe nga engjëjt dhe krijesa të tjera të larta. Ata që dëshirojnë të përfitojnë nga të mirat e kësaj kohe, duhet ta shfrytëzojnë atë ashtu siç duhet. Por si do të arrijmë të zgjohemi në kohën e agimit kur dihet se kjo është koha më lezetshme për gjumë.

Si fillim duhet që patjetër ta vendosim jetën tonë në një rregull. Të kemi kujdes të mos bëhemi prej atyre që rrinë deri vonë në darkë e që nuk ia dinë vlerën kohës së agimit. Të mos e lodhim veten tonë tepër me punët e të tjerëve e të mos jemi në gjendje të ngrihemi herët. Të mos përzihemi me grupime të padobishme njerëzish e të mos flasim fjalë të kota. Duhet ta fitojmë rehatinë e trupit dhe vazhdimsinë e shëndetit duke fjetur herët. Ushqimi i lehtë në darkë është i rekomanduar si nga feja ashtu edhe nga mjekësia. Mos ngarkimi i tepërt me ushqim i stomakut ndihmon në zgjimin herët. Ushqimi që hahet me emrin e Allahut gjithashtu ndihmon në zgjimin herët dhe kalimin e një pjese të natës me adhurim. Ushqimi, i cili i vjen rëndë stomakut është edhe më i rëndë për zemrën.

Është vërtetuar se ata të cilët shoqërohen me dijetarë dhe njerëz të mirë arrijnë të zgjohen kollaj naten dhe të bëjnë ibadet. Duke ndenjur me njerëz të tillë, përfitojmë shumë nga cilësitë dhe sjelljet e tyre të mira. Në këtë mënyrë arrijmë të mposhtim egon tonë dhe të bëhemi prej atyre që ndjekin rrugën e të devotshmëve.

Ata që vazhdimisht zgjohen herët në agim, për shkak të lartësisimit të tyre shpirtërisht, e ndjejnë veten të lehtë si zogu, mjaftohen me pak gjumë, me pak ushqim...etj., ndërsa ata që flejnë shumë, vazhdimisht ankojnë nga shqetësime të ndryshme në shëndetin e tyre.

Disa të rinj bëjnë jetë të çrregullt dhe jo normale dhe për këtë arsye çdo punë që bëjnë mbetet e paplotësuar (përgjysëm). Pejgamberi (s.a.v) i shpalli vëllezër Ebu Derdan dhe Selman Farisin (r.anhuma). Ebu Derda (r.a) bënte shumë ibadet. Bënte ibadet deri në mëngjes, lodhej aq shumë sa që nuk ishte në gjendje të bënte punë tjetër. Selman Farisi (r.a) si vëllai i tij shpirtërorë shkoi në shtëpinë e tij për ta verifikuar se çfarë bënte. Vuri re që gjendja e përgjithshme e familjes së Ebu Derdas ishte e varfër. E pyeti bashkëshorten e të vëllait për gjendjen e përgjithshme të tyre dhe ajo i tha:

- Vëllai yt (Ebu Derda) nuk merret aspak me ne. Ai vazhdimisht natën fal namaz, ndërsa ditën agjëron. Gjendja jonë është si po e shikon edhe ti vetë.

Selman Farisi (r.a) pasi e dëgjoi këtë i tha që do të vinte para akshamit dhe do të fliste me të vëllain, pastaj u largua.

Kur erdhi Selman Farisi (r.a) në shtëpinë e Ebu Derdas (r.a) e gjeti këtë të fundit të ardhur në shtëpi. Ebu Derda (r.a) u kënaq shumë nga ardhja e Selmanit në shtëpinë e tij. E futi brenda dhe pas pak i solli për të ngrënë. Mikëpritja është nga rregullat e Islamit dhe synneti i Pejgamberit (s.a.v). Ebu Derda (r.a) i tha Selmanit (r.a) që të hante, por Selmani (r.a) i tha që të hanin bashkë. Ebu Derda (r.a) i tregoi që ishte agjërueshëm. Selmani (r.a) i tha që ta prishte agjërimin e të hanin së bashku dhe pasi nguli këmbë e bëri që të prishte agjërimin.



Duhet patur kujdes që kur të shkohet diku nuk duhet të jemi agjërueshëm (është fjala për agjërimin vullnetar- nafile).

Nëse ndodh diçka e tillë, agjërimi duhet të prishet dhe të zëvendësohet me ndonjë ditë tjetër (kaza). Fitimi i zemrës së besimtarit është një ndër ibadetet më të mëdha.

Pastaj hëngrën së bashku dhe Selmani (r.a) i tha të vëllait:

- Vëllai im! Allahu (xh.xh) na ka dhënë katër të drejta të cilat duhet t'i zbatojmë. E para është të interesohemi për familjet tona (është fjala për marrëdhëniet burrë-grua), sepse lumturia në familje arrihet me anë të dashurisë. Hamë, pimë, kalojmë kohë të bukur dhe pasi t'i japim hakun që i takon familjes duhet të flemë në kohë dhe ky është haku i trupit, të cilit duhet t'i jepet. Pas kësaj u çuan dhe u përgatitën për të pushuar. Ebu Derda (r.a) si gjithmonë deshi të fillojë ibadetin pa fjetur, por Selmani (r.a) nuk e lejoi duke i thënë që të flinte. Ebu Derda (r.a) u çua përsëri në gjysmë të natës, por Selmani (r.a) përsëri i tha që të flinte. Kur u bë koha e agimit Selmani (r.a) i tha:

- Ngrihu vëlla, tani është koha për ibadet. Eja të bëjmë ibadet së bashku. Në këtë mënyrë e kaluan atë natë së bashku. Ebu Derda (r.a) pasi i dëgjoi fjalët e Selmanit (r.a) i tha që do shkonte e do pyeste Pejgamberin (s.a.v) dhe ashtu ndodhi. Shkoi tek Pejgamberi (s.a.v) dhe i tregoi se çfarë i kishte ndodhur. I dërguari i Allahut (s.a.v) ia ktheu:

- Po Selmani është i mprehtë në çështjet fetare.

Një ndër detyrat e besimtarit është edhe ajo që gjithsecili të bëjë atë që i takon gjatë ditës. P.sh. nëse është tregtar, të merret me tregti, nëse është nxënës në shkollë, të interesohet për mësim-

et e tij...etj. Për nxënësit nuk ka ngarkesë të madhe përsa i përket anës shpirtërore. Ai p.sh. e fal namazin e sabahut për 10 apo 15 min pastaj gjen kohë për t'u marrë me mësimet e tij. Nëse njeriu ecën me program arrin të gjejë kohë për çdo gjë, e nëse jo, atëherë nuk arrin të gjejë kohë për shumë gjëra, prandaj edhe punët e tij nuk shkojnë asnjëherë ashtu siç duhet.

Një njeri nga i cili nuk kanë dobi të tjerët nuk mund të quhet njeri. Ai që do Krijuesin duhet të dojë edhe krijesat, sepse kështu është i ndërtuar rregulli në univers, çdo gjë është e lidhur me njëra - tjetrën. Nëse një njeri ka dituri, nga dituria e tij duhet të përfitojnë edhe të tjerët, nëse



ka pasuri, duhet t'i ndihmojë të varfërit, nëse ka forcë, t'i ndihmojë të pafuqishmit ... etj.

Rini e dashur! Ne duhet të jemi të kujdesshëm në detyrat që na takojnë qofshin ato punë të përditshme apo mësimet e shkollës dhe gjithmonë duhet të jemi në shërbim të të tjerëve. Duhet të përpiqemi që të jemi njerëz të thjeshtë, të komunikueshëm me të tjerët dhe me moral të lartë dhe jo mendjemëdhenj, inatçi, ziliqarë...etj, sepse këto nuk kanë vend në Islam. Nëse do t'i kemi kujdes këto gjëra, do të arrijmë të bëhemi të dobishëm për veten tonë, familjen tonë dhe mbarë shoqërinë.

Kështu që ne duhet të jemi të

kujdesshëm në çdo aspekt të jetës. T'i japim hakun gjithkujt dhe çdo gjëje, t'i japim hakun familjes sonë, trupit tonë duke fjetur në kohë, të ngrihemi në kohën e agimit e t'i bëjmë ibadet Allahut (xh.xh), gjatë ditës t'i kryejmë detyrat që na takojnë...Duke i bërë këto duhet të jemi të kujdesshëm që zemrat tona të jenë të lidhura me Krijuesin. Atë duhet ta përmendim sa më shumë, me Të duhet të jemi gjithmonë dhe në çdo vend, sepse kush e përmend Atë më tepër, shpërblimin dhe vlerën do ta ketë më të madhe tek Ai.

Në fenë tonë nuk ka asnjë vështirësi, elhamdulillah-lah.

Ata që nxjerrin vështirësi në fe janë pikërisht ata që nuk e dinë fenë mirë. Allahu (xh.xh) nuk u ka ngarkuar robërve të vet përtej mundësive të tyre.

Siç duhet të jemi të kujdesshëm në ushqim apo pije ashtu duhet të jemi të kujdesshëm edhe në çështjet fetare, të mos e teprojmë asnjëherë.

Duhet të falënderoni Allahun (xh.xh) për mundësitë që ju ka dhënë, sepse e dini shumë mirë se në çfarë kushtesh janë arsimuar të parët tuaj. Ata nuk i kishin kushtet dhe mundësitë që i keni ju sot. Prandaj duhet t'i vlerësoni dhe t'i shfrytëzoni në maksimum mundësitë që ju janë afuar, në mënyrë që të arrihi sukseset e duhura. Sot bota në përgjithësi ka shumë nevojë për të rinj të arsimuar mirë. Nesër, Zoti (xh.xh) juve do ju mundësojë të punoni në vende të ndryshme, prandaj kudo që të jeni dhe çfarëdo pune të bëni, të jeni të kujdesshëm që t'i jepni hakun çdo gjëje.

Drejt Teje

Si nje zile frymëzimi
Më shfaqet në vetmi
... zani, që preka
N' bregdetin e dashunisë së fjalës.

Dhuroje lule
... e unë!
... eshtra të arta kohësh të humbuna.

Fjalët e vjetra
Me virgjërinë e një gjuhe të njomë,
Bahen ajër
Ku rritet e vetme,
E ngrirë,
Si hije e ndritun,
... Bota e re...

Alban Kali

Rinia Përballë Të Vërtetës Së Humanizmit-modernizmit

Prill
Maj
Qershor
2007

ETIKA

7

Mexhid Yveysi, Gjakovë



Do t'ju kërkoja që përpjekjet tuaja t'i drejtoni më tepër për përgatitjen e rinisë për rrugë, se sa përgatitjen e rrugës për rininë.

B. Lindsej

E vërteta mund të jetë njerë-

zore dhe Hyjnore. E vërteta njerëzore është relative, e përkohshme, është e kufizuar, prandaj mund të pranohet, apo të mohohet, mund të jetë e urrejtur ose e pëlqyer, kurse e Vërteta

Hyjnore është absolute, e përherëshme dhe e përkryer...

Por, të Vërtetën Hyjnore, në kohën moderne që jetojmë, disa qenje njerëzore, të cilët e quajnë veten humanistë modern, nuk e pranojnë.

Rinia është pranvera e jetës. Jeta në rini është përplotë stuhi. Stuhi që sjellin herë dhimbje, herë kënaqësi. Herë kënaqësi sjellë jeta e rinisë në shoqëri, por edhe dhimbje sjellë jeta e rinisë në vetmi...

Në moshën e rinisë përfundon mosha e lumtur e fëmijërisë. Mosha e lumtur e fëmijërisë përfundon, por mosha e shqetësimeve të rinisë po sa fillon. Fillon një etapë e re, krahas shqetësimeve, një etapë e re e zhvillimeve. Zhvillimeve fizike, psikike, sociale, emocionale, shpirtërore, intelektuale...

Rinia krijon pikëpamjen e vet ndaj jetës, por kjo pikëpamje është shumë larg prej së vërtetës. E vërteta për rininë është ajo që ju serviret apo edhe ajo që prej tyre krijohet. Krijohet me mendime, gjykime, arsytetime, por që përfundojnë shpesh me zhgënjime, me dështime, me pësime. Këto zhgënjime, këto dështime, këto pësime, ka mundësi reale të bëhen mësim. Mësimet i çelin rrugën, i japin mundësi për të njohur veten e tij. Njohja e vetvetes është çelësi për të njohur thelbin e së Vërtetës...

E vërteta mund të jetë njerëzore dhe Hyjnore. E vërteta njerëzore është relative, e përkohshme, është e kufizuar, prandaj mund të pranohet, apo të mohohet,



mund të jetë e urrejtur ose e pëlqyer, kurse e Vërteta Hyjnore është absolute, e përhershme dhe e përkryer...

Por, të Vërtetën Hyjnore, në kohën moderne që jetojmë, disa qenje njerëzore, të cilët e quajnë veten humanistë modern, nuk e pranojnë.

E vërteta e humanizmit modern

Humanizmi modern është shekullar, ateist. Ai nuk e pranon më besimin te Zoti si burim autoriteti moral për mënyrën e të jetuarit apo të vepruarit.

Humanistët modern mendojnë se kemi vetëm një jetë, prandaj është e rëndësishme, kanë dëshirë, që ajo të jetë sa më e mirë. Humanistët modern e shohin arsyen njerëzore si forcë të vërtetë, forcë udhëheqëse në këtë jetë. Humanizmi i tyre bazohet në agnosticizëm dhe ateizëm. Në qëndrimin ndaj njohjes janë empiristë, kurse njohja vjen vetëm përmes shqisave, mendojnë këta modernistë...!

Morali humanist është një kod i sjelljes të njerëzve që është ndërtuar prej njerëzve....

Humanistët nuk i japin vlerë as rëndësi të veçantë të pasurit të një besimi, as përluljes, bindjes ndaj porositve të të Madhit Zot, dhe thonë, kjo është gjë e kotë...!

Ata kërkojnë ashiqare, ta çlirojnë shoqërinë prej besimeve

Në shoqërinë moderne rinia gjendet shumë e rrezikuar sepse ndodhet përpara një udhëkryqi të ngatërruar. Nga ky udhëkryq i ngatërruar, cila është rruga që duhet zgjedhur për të shpëtuar?

fetare, që, sipas tyre, pengojnë përparimin shoqërorë në nivel botërorë...

Si ta përkufizojmë shekullin në të cilin jetojmë?

Shekulli i përparimit apo i prapakhimit? Shekulli i shpresës apo i zhgënjimit dhe dëshprimit? Shekulli i shkencës apo post-shkencor?

Në botën moderne, zhvillimi i shkencave natyrore, e sidomos i fizikës nukleare, bëri që bota të përjetojë një ndryshim me përmasa kozmike, por gjendja në shumë vende është kaotike, është katastrofike!

Megjithatë, përkundrajt këtyre arritjeve të të menduarit njerëzorë, njeriu kurrë nuk ka qenë më tepër se në këtë shekull i vetmuar, nga vetvetja i tjetërsuar!

Në euforinë e përparimit material njeriu e harron vetveten, e harron njerëzoren, e harron shpirtëroren. Kështu, njeriu po dehumanizohet, po depersonalizohet dhe një ditë vetvetiu do të asgjësohet...!

Mënyra, stili modern i të jetuarit ka një veçanti - kërkimin e zjarrtë të jetës me një kuptim të ri! Pikërisht, humbja e kuptimit të jetës i ka shpër, disa herë, shumë të rinj në humnerë...!

Shumë të rinj kanë rënë në humnerë duke menduar se prej dimrit po dalin në verë...! Alkooli, droga, shfrenimi, krimi, mashtrimi, dhunimi, prostitucioni, iluzioni dhe shumë të këqija të tjera i çojnë tek humnera...

Në shoqërinë moderne rinia gjendet shumë e rrezikuar sepse ndodhet përpara një udhëkryqi të ngatërruar. Nga ky udhëkryq i ngatërruar, cila është rruga që duhet zgjedhur për të shpëtuar?

Rruga e shpëtimit

Rruga e shpëtimit vjen përmes besimit. Besimi është shpëtimi. Shpëton ai që veten e pastron.

Si bëhet pastrimi? Kur të ktheheni te burimi. Burimi është Kur'an-i. Burimi është Islami.

Islami është besimi ku mund të gjendet shpëtimi. Aty është Adhurimi. Aty është Njësimi. Aty është Vëllazërimi. Aty është Drejtësia. Aty është Dashuria. Aty është Besnikëria. Aty është Mençuria. Aty është Edukimi. Aty është Zhvillimi. Aty është Përparimi. Aty është Lartësimi. Aty ke çdo gjë që kërkon. Aty asgjë askujt nuk i mungon...

Kush nuk i beson Zërit të së Vërtetes, barrën e mosbesimit e ka kundër vetes...

Dashuria Si Thelbi i Çdo Gjëje

Përktheu dhe përshtati: Alban KALI

Islam do të thotë paqe, kurse mysliman ndërtues i paqes apo qëllimtar i saj. Njëri nga emrat e Zotit është pikërisht Selam, sepse Ai është padyshim burimi i paqes. Adhuresit e këtij Zoti, pra myslimanët, janë të lidhur me këtë burim, nëpërmjet të cilit sigurojnë një paqe të brendshme. Ato gjithashtu ëndërrojnë në mënyrë të vazhdueshme reflektimin apo instalimin e saj edhe jashtë tyre (tek të tjerët). Çdo mysliman mundohet të qëndrojë larg çdo stresi, shqetësimi apo çdo gjëje që prish këtë qetësi. Ato janë të obliguar ta ruajnë atë në mënyrë që me të ta shdërronjë këtë botë në një atdhe paqeje. Kjo është arsyeja ndoshta që njeriu i parë, pra Ademi (a.s.), u la, u vendos në xhennet.

Ai (Ademi a.s.) jetoi për një kohë atje, u pajis me kulturën e xhennetit e pastaj u hodh në këtë botë.

Një emër tjetër i myslimanit është "mumin" që do të thotë

"posedues i sigurisë e garancisë"
Mumin gjithashtu është edhe një nga emrat e Allahut, sepse Ai është burimi i çdo sigurie e garancie në këtë dhe në botën tjetër.

Myslimanët si mbartës të kësaj cilësie dhe të këtij emri kanë një botë shpirtërore të qetë, të qëndrueshme, pa paradokse e shqetësime të kota, prandaj myslimanët mundohen të frymëzojnë tek të tjerët.

Allahu në Kur'an thotë:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqia dhe të besoni Allahun"

Ai është "Vedud", i cili do të thotë Zot, që do dhe duhet shumë. All-llahu është burimi i dashurisë. Ai e krijoi dashurinë të cilën e hodhi thellë në thelbin tonë, kur mbas krijimit fizik na dhuroi me frymën e tij shpirtin.

Ibn Arabi thotë: "Ne rodhëm,

dolëm nga dashuria, u krijuam për dashurinë, iu drejtuam asaj, iu falëm e iu dhuruam tërësisht asaj."

Në Kur'an thuhet *"Zoti është rrahim (mëshirues) është vedud (ai që i do krijesat e veta vazhdimisht). Ai është i bukur dhe e do çdo aspekt të së bukurës. Prandaj e pajisi njeriun me virtytin, cilësinë, pasurinë më të madhe e bukurinë më të lartë, që quhet "iman".*

Për kultivimin e saj ai dërgoi profetërit nëpërmjet të cilëve zbriti edhe shpalljet. I fundit i këtij vargu siç dihet tashmë është Muhammedi (a.s.) dhe shpallja, që iu dha atij është Kur-ani. Ky pejgamber shkriu çdo gjë të tij për të formuar apo ndërtuar një shoqëri që do t'i vlente gjithë njerëzimit. Profeti (a.s.) me jetën e tij ofroi shembullin më të mirë.

All-llahu (xh.sh.) në Kur-an thotë *"S'ka dyshim që Profeti (a.s.) është shembulli më i mirë për ata që shpresojnë në shpërbëlimin e botës tjetër dhe për ata që përmendin Zotin shumë."*

Ai edhe në periudhën e parashpalljes kishte një jetë për t'u marrë shembull. Pa qenë profet njëri në shoqëri si i besueshmi, i sinqerti pra El -Emin. Në lidhje me këtë temë në Kur'an thuhet: *"A nuk e njohën akoma profetin e tyre, prandaj e refuzojnë atë?"*

"Thuaj: sikur të donte All-llahu (xh.sh.) unë nuk do t'ua lexoja atë, as nuk do t'ua kisha njohur ju me të. Unë përpara kam jetuar në mesin tuaj. Pse nuk mendoni?" Unë, sa isha i pa ngarkuar me këtë mision, 40 vjet jetova në mesin tuaj. Ju e



dini ndershmërinë time, drejtësinë, mbajtjen e amanetit dhe analfabetizmin tim. Unë as i ri s'i kam bërë ortak (shok) Zotit. Si e kërkonti tani një gjë të tillë prej meje.

Momentet e para të shpalljes profeti (a.s.) i përjetoi me frikë dhe emocion. Gruaja e tij Hadixheja u mundua ta qetësonte duke i thënë: "Qetësohu, mos u merakos. Beto hem në Zotin tim se Allahu (xh.sh.) nuk do të turpërojë ty, sepse ti kujdesesh për të afërmit, tregon gjithmonë të vërtetën, mban amanetin, duron vuajtjet, ndihmon të varfërit dhe je mikpritës.

Disa tablo dashurie nga jeta e Profetit (a.s)

Tani le të paraqesim nga jeta e profetit (a.s.) disa tablo të dashurisë së tij.

1. Dashuria ndaj Allahut

Pejgamberi (a.s.) ishte vazhdimisht i vetëdijshëm për kontrollin hyjnor. Ai përpiqej të kryente obligimet dhe detyrat, që duhet të përmbushë çdo njeri si rob i Zotit (xh.sh.). Qëllimi i tij ishte sigurisht të jetë një rob falënderues. Profeti ishte njohësi më i mirë i Allahut. Ai ishte në një kontakt të vazhdueshëm me Atë. Arritja e kënaqësisë së tij ishte i vetmi qëllim. Vdekja ishte vetëm bashkim me Qenien Supreme. Në shumë fjalë të tij ceket e zhvillohet tema e dashurisë ndaj Allahut e të dashurit për hir të Allahut. Atë e bënte reflektues e të fuqishëm në dashuri pikërisht lidhja e fuqishme me burimin e dashurisë Allahun.

2. Dashuria ndaj fëmijëve

Profeti Muhammed (a.s.) i merrte në prehër e i përkëdhelte ato. Profeti (a.s.) njërit i cili edhe pse kishte 10 fëmijë nuk i kishte rrokur e puthur ato i thotë: Nuk do të mëshirohet ai i cili nuk

mëshiron. Çfarë mund t'i bëj atij që Allahu ia ka shkukur nga zemra mëshirën dhe e ka lënë krejtësisht të thatë?

Ai në mënyrë të veçantë merrte vetëm me fëmijët por edhe me të rinjtë. Të rinjtë e parë që besuan kishin për profetin (a.s.) një vend të veçantë. Ai i shpërblente ato apo i bënte të fitonin një status të veçantë në shoqërinë e atëhershme duke i emëruar komandant ushtrish, në të cilat bënin pjesë sahabë (shokë) të rëndësishëm e të pjekur të Muhammedit (a.s.).



Islam do të thotë paqe, kurse mysliman ndërtues i paqes apo qëllimtar i saj. Njëri nga emrat e Zotit është pikërisht Selam, sepse Ai është padyshim burimi i paqes.

Në luftën e Tebukut, Ai ia dha flamurin 20 vjeçarit Zejd b. Thabit; kurse në atë të Uhudit ia dha Aliu (r.a.), Usame bin Zejdin e caktoi komandant i një ushtrie 40 mijë vetësh, kur ai pa se Usamja ishte vetëm 18 vjeç. Muadh ibn Xhebelin e caktoi drejtues të Jemenit.

3. Dashuria ndaj familjes e të afërmeve

Ai ishte një drejtues familjeje shembullor. Nuk e kishte për turp t'i ndihmonte ato madje edhe në punët e shtëpisë. Ai në mënyrë të veçantë përkudesej për obligimet fetare të atyre e për ngritjen e tyre në një vetëdije islame, sepse ai ishte urdhëruar me ajetin "Këshillo familjen tënde të falë namaz, edhe t'i vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet" Ai thirrjen islame e filloi nga të afërmit mbas shpalljes së ajetit: "Tërhiq vërejtjen fafesisit tënd". Ai i ruante marrëdhëniet fafesisnore dhe të njëjtën gjë kërkonte edhe prej të afërmeve. Ishte këmbëngulës në dashurinë për prindërit, e gjithashtu për nënën e qumështit, vllazërit e motrat e qumështit, përkujdesja e tij arrinte deri në dashurinë e miqve të prindërve. Duke i shfaq përkujdesjen e nevojshme ai u bë një shembull shumë i mirë për to.

4. Dashuria ndaj shokëve

Profeti (a.s.), duke mos njohur asnjë pengesë e vështirësi, arriti të shndërronte në njerëzit më të përsosur që ka njohur historia e njerëzimit, ato të cilët jetonin një periudhë të quajtur jo kot periudha e injorancës.

Ai fali shokët e tij që dikur duke u bërë rob të unit të tyre e

torturuan dhe stresuan profetin (a.s.). I lartësoi ato dhe ua përjetësoi emrat. *“Juve ju erdhi i dërguari nga lloji i juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”. “Ndaj besimtarëve ji i përulur e i butë”. “Të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty.”*

6. Dashuria ndaj njeriut

Ai është një peygamber i dërguar si mëshirë për tërë njerëzimin (Enbija 21/107), që pranon të bashkëbisedojë me çdo njeri



Vërejmë se Profeti (a.s.) vlerësonte edhe krijesat e tjera përveç njeriut e gjithashtu i kushtonte një kujdes të veçantë edhe mjedisit.



pavarësisht se kush është ai. I gatshëm të bëjë çfarëdolloj sakrifice për shpëtimin e njerëzimit.

Peygamberi plotësoi detyrimet ndaj komshinjve pa i dalluar ato nga besimi. Ai kundërshtonte, kritikonte e dënonte robërimin e njerëzve, ushtrimin e dhunës ndaj tyre e çfarëdo lloji të ishte ajo etj.

Dashuria, mëshira e dhimbshuria e profetit kishin një burim hyjnor. All-llahu thotë: *“Ti ishe i butë ndaj tyre ngaqë Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje. Ti fali ato e bëj dua (lutje) për ta dhe konsultoj me ta në të gjitha çështjet e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ato që i mbështeten”* (Al-i Imran)

7. Dashuria ndaj krijesave të tjera dhe mjedisit

Vërejmë se Profeti (a.s.) vlerësonte edhe krijesat e tjera përveç


njeriut e gjithashtu i kushtonte një kujdes të veçantë edhe mjedisit. Me hadithin “mëshironi krijesat e tokës që të mëshiroheni nga ai që është në qiell” Profeti na këshillon mëshirën si objektivin kryesor të jetës tonë në kontaktet apo marrëdhëniet tonë me çdo gjë. Ai tregoi se një grua imorale përfundoi në xhennet vetëm ngase ajo i shuajti etjen një qeni, e dënimin e një njeriu tjetër vetëm për vuajtjet që ai i shkaktoi një maceje”. Çdo mirësi që i bëhet krijesave do të shpërblehet. Ai urdhëroi mprehen e thikave në mënyrë që kafshët mos të ndjenin shumë dhimbje kur priteshin apo bëheshin kurban.

Ai mbjelli rreth 500 pemë dhe në lidhje me këtë temë tha: “Nëse një person mbjell një pemë dhe prej frutit të saj ushqehen kafshët, shpendët apo ndonjë njeri atëherë për mbjellësin ka sevabin e lëmshës.



Rinia Përballë Librit

Ma. Irida HOTI



të dhëna mbi një autor, përmbajtje apo një analizë të veprës, por asnjëherë nuk do të gjejnë ato elementë, të cilat do i zbulojnë gjatë leximit dhe aq më pak mendimin e tyre kritik mbi atë libër të lexuar.

Një i ri për kulturën dhe formimin e tij pa lexuar kryeveprat shqiptare dhe ato botërore do të ishte i çalë, i varfër në mendime, pa kulturë të thellë, pa botë imagjinare, si një lule që rritet në thatësi...që shpejt mund të vyshket pa çelur petalet e saj.

Lind pyetja:

Interneti... progres?!

Nuk mund të mos e quajmë internetin progres, sepse si një rrjet i brendshëm ndërkombëtar të pajis me informacione që një të riu do i duheshin orë të tëra, madje, ditë dhe muaj në biblioteka për të gjetur informacionin që kërkon, por interneti përballë rinisë së sotme po zë vendin që duhej të balancohej edhe me librin.

Interneti rrezikon të jetë njëkohësisht edhe regres, ku nëse një të riu i kërkohet të lexojë Iliadën, më parë ai zgjedh të hulumtojë në internet dhe të marrë informacion të gatshëm, sesa të ulet dhe ta lexojë. Me të vërtetë që ai do të gjejë mjaft material, madje edhe analiza dhe kritika shumë interesante, por a do mundet t'i kuptojë ato? Pak e vështirë, madje e pamundur pa e lexuar vetë veprën.

Të lexosh libra mund të mendohet se është një gjë e thjeshtë, por ne mendojmë se është shumë e vështirë të lexosh për të kuptuar, dhe shumë më e vështirë të lexosh

në mënyrë kritike. Pra mund të lexohet në tre mënyra: Të lexuarit e thjeshtë, të lexuarit mekanik dhe të lexuarit kritik.

Duke kujtuar fjalët e Volter: **“Sa më shumë lexoni pa u menduar, aq më tepër bindeni se dini shumë, kurse sa më shumë mendoni duke lexuar, aq më qartë e shihni se ende dini shumë pak”**, mund të themi se nëse ky i ri lexon veprën, e lexon për ta kuptuar, e lexon duke mbajtur shënime, përdor edhe internetin atëherë ai do të ishte jo vetëm i mirë informuar për veprën, por do të ballafaqonte njohuritë e tij me të tjerët, gjykimin e tij kritik mbi këtë veprë krahasuar me atë të tjerëve, me një fjalë do krijonte mendimin e tij të pakushtëzuar nga të tjerët dhe do jetë i aftë ta mbrojë atë, prandaj përdorimi i internetit sot duhet të kuptohet ndryshe, si një informacion mbështetës dhe plotësues por jo zëvendësues.

Si përfundim mund të themi se të rinjtë duhen vendosur përballë librit duke u motivuar për:

- të mos marrë informacione të gatshme, por për t'i krijuar vetë ato;
- përvetësimin e informacionit duke argumentuar mendimet e tyre;
- për një rini më elokuent dhe plot aftësi shprehëse, duke kujtuar thënien e Profetit Muhammed s.a.s.v:

“Allahu le të mos bekojë asnjë ditë, në të cilën nuk mësoj diçka të re”.

Libri është një dritare nga e cila shihen karaktere të ndryshme njerëzish, ngjarje prekëse, emocionuese, tragjike që të bëjnë të jesh pjesëmarrës dhe të jetosh bashkë me to. Libri është një portë nga e cila mund të hysh një herë dhe s' mund të dalësh më, sepse bota magjike e tij të tërheq si një magnet.

Jetojmë në një botë të vru llshme materiale, ku çdo njeri synon të ecë me hapat gjigandë që kërkon koha, pa menduar për tokën në të cilën shkelim dhe rinia e sotme është në një dilemë zgjedhjeje përballë asaj që sot është shfaqur si e pazëvendësueshme...internetit, por a mund të zëvendësojë interneti...librin?

Ka të rinj që shprehen se libri është i pazëvendësueshëm dhe në përzgjedhjen mes librit dhe internetit do të zgjidhnin librin, sepse në internet mund të gjejnë

Të Rinjtë Dhe Organizata E Konferencës Islamike

Aisa KOKICI

Takimi i ministrisë së punëve të jashtme me organizatën e konferencës islamike përfundoi me marrjen e disa vendimeve të suksesshme në kuadrin e shtetit turk. Me këtë organizim Turqia edhe një herë tjetër tregoi vendin e saj në mes të vendeve udhëheqëse të botës islame. Në qoftë se kthehemi tek të rinjtë shohim se nuk ka ndonjë lidhje të hapur në mes të OKI dhe të rinjve. Tani për tani nuk ekziston ndonjë organizatë që ka lidhje të drejtpërdrejt me të rinjtë.

Përpjekja e një princi të Arabisë Saudite e bërë para dhjetë vjetëve për të formuar një federatë sportive për të rinjtë nuk pati sukses. Edhe në qoftë se keni dëshirë të bëheni anëtar i një forumi të tillë nuk ekziston ndonjë rrugë e qartë. Në një farë mënyre edhe analizimi

i projektit tonë në lidhje me të rinjtë nga ana e komisionit kulturor është rezultat i kësaj paqartësie. Në të njëjtën kohë në Europë ekzistojnë struktura të konsoliduara si Forumi Rinor European, Bashkësia Rinore Katolike, Lidhja e të Rinjve Katolikë.

Forum i rinor european si një iniciativë civile merr me miliona dollarë të ardhura nga bashkimi european. Në panairin e zhvilluar në korrik të vitit 2000 në Hannover të Gjermanisë më habiti emri i një shoqate që përfaqësonte Turqinë. Quhej "Habitat Youth Network" –Lidhja Rinore Habitat.

Sipas informacioneve që kam ligjet turke nuk e lejojnë formimin e një shoqate ose forumi të tillë. Kur pyeta përfaqësuesin e kësaj shoqate rreth krijimit të saj më dha një përgjigje të çuditshme:

- Ne nuk kemi marrë leje për formimin e kësaj shoqate dhe nuk kemi ndër mend të presim derisa shteti turk të na japë leje. Kombeve të bashkuara u ishte dashur të mbyllnin njërin sy gjatë mbledhjes së famshme të Habitatit të bërë në Stamboll për të ndryshuar ligjet e lidhura me përfaqësimin e rinisë turke. Kjo strukturë nuk njihet nga shteti turk, por është e njohur në instancat ndërkombëtare.

Kur bëhet fjalë për rininë në organizatat ndërkombëtare shohim një lloj mosinteresi të OKI ndaj kësaj çështjeje. Problemet e OKI nuk mbesin vetëm në forcimin e marrëdhënieve rinore por edhe të marrëdhënieve në shoqërinë civile. Ndërkohë që në të gjithë botën organizatat e shoqërive civile enden nga një anë në tjetrën dhe të vjen keq për





pavendosmërinë e vendeve islame të cilat pasqyrojnë më mirë se kushdo tjetër formimin e vakëfit si një organizatë e sukseshme e shoqërisë.

Këtë shkrim e kam përgatitur gjatë një konference të zhvilluar në New York me ftesën e Këshillit të punëve social-ekonomike të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC).

Në konferencë u diskutua tema: **“Ringjallja e burimeve dhe plani dhjetë vjeçar për të zhdukur varfërinë në vendet e prapambetura”**. Ishin të ftuar njerëz të mëdhenj nga secili shtet dhe bashkë me to i ishte dhënë një rëndësi e madhe edhe organizatave të bashkësive civile. Në ditën e dytë u organizua ngrënia e mëngjesit në dhoma të ndryshme në bazë të të ftuarve. Në dhomën e organizatave të shoqërisë civile na ra në sy një pamje e tillë: Në çdo tavolinë ishte i ulur një njeri i shtetit, një përfaqësues i Kombeve të Bashkuara, një njeri i aftë i OSHC dhe tre përfaqësues të saj. Përveç kësaj në krye të çdo tavoline janë vendosur edhe nga tre stazhierë të KB. Çdo fjalë e thënë në tavolinë është shumë e rëndësishme dhe shkruhet menjëherë nga tre stazhierët. Më vonë kërkohet që ju të bëni propozimet tuaja. Në tavolinën tonë si përfaqësues shteti është i ulur një përfaqësues amerikan.

Sponsorja e këtij mëngjesi EL ZAJED me prejardhje nga Dubai me një veshje islame është e ulur në tavolinën tonë dhe po i informon të tjerët për një milion dollarë që do të shpërndajë vakëfi i saj. Miku që kam në të majtën time është nga Japonia dhe përfaqëson vakëfin Peace Boat ose varka e paqes. Ky vakëf organizon udhëtime në të gjitha portet e botës gjatë tre muajve dhe ndërkohë organizon lidhje të rëndësishme me tregtarët e secilit vend. Gjëra të tilla nuk i keni dëgjuar ndonjëherë apo jo?

Në tavolinën tonë janë të ulur edhe përfaqësuesit e shoqatës ndërkombëtare të Bahait dhe të Federacionit botëror të familjes. Të gjithë të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe ajo më e çuditshmja është se të gjithë përdorin këtë vend për të përhapur idetë e tyre fetare. Përfaqësuesi i ECOSOC shkon në çdo tavolinë dhe duke harxhuar disa minuta mundohet të ndezë diskutimin dhe më vonë duket kryetari i ECOSOC. Pavarësisht se kalon në të gjitha tavolinat ai parapëlqen të bëjë mëngjes me kryetarët e OSHC. Më vonë për të përmbledhur mendimet e nxjerra nga çdo tavolinë ai thërret të ngarkuarin e KB. Ja nga tavolina afër nesh nxirren këto përfundime: Flitet për kompjuterët e përdorur në sallonet e KB dhe përfaqësuesi i KB tregon pikërisht për ndërrimin e tyre me të tjerë dhe për zhdukjen e modelit të vjetër. Ndërkohë përfaqësuesi i shtetit të Kamboxhies tregon se këto kompjutera mund të përdoren edhe disa vite të tjera në vendin e tij. Përfaqësuesi i OSHC merr përsipër madje edhe transportin e tyre.

Kryetari i ECOSOC i dëgjon me vëmendje të gjitha diskutimet dhe në fund flet për rolin e rëndësishëm të OSHC, na falënderon për ardhjen tonë dhe na thërret që të mos i lëmë vetëm. Ai falënderon të gjitha organizatat dhe vakëfet e ardhura nga e gjithë bota. Pas këtij intervali mund të kthehemi edhe një herë tek çështja jonë e OKI.

Në mbledhjen e zhvilluar në Stamboll projekti i Konferencës rinore islamike është miratuar. Gjithashtu në prill të vitit 2005 në Rijad KRI në bashkëpunim me ministrinë e sporteve organizuan një mbledhje. Të dyja projektet e diskutuara kishin lidhje me financimin e shoqërisë civile. Pavarësisht se në Rijad u vendos që të mos ketë shpenzime për

strukturën e re ky princip pengon zhvillimin e mëtejshëm. Këtu dalëngadalë mund të marrim edhe përgjigjen e pyetjes se ç'mund të bëjë një sekretar i zoti?

Vlerësimi i vërtetë i OKI, qëndrimi i kanaleve si CNN dhe BBC pas dyerve të kësaj organizate për të marrë informacionin e duhur tregon për krijimin e një organizate të fortë. Arritja e qëllimit është e lidhur me aktivitetin dhe aftësitë e kryetarit dhe me lëvizjen e shteteve të tjera. Ajo që del në pah është: Qeverisjet sunduese në vendet islame veprojnë në bazë të lëvizjeve që mund të sjellë një projekt dhe kështu që vakëfet, të rinjtë, organizatat etj. futen në grupin e gjërave të rrezikshme.

Si një drejtues i shoqërisë civile në kuadrin e edukimit të rinisë mund të them se çdo njeri duhet të merret me atë çështje që i intereson dhe i vlen. N.q.s nuk marrim parasysh rëndësinë e organizatave të shoqërisë civile dhe rinore është njësoj sikur ta fusësh kokën në rërë dhe të mos përfitosh asgjë. Qytetërimi islam i ka treguar botës një gjë të tillë me anë të vakëfeve, por fatkeqësisht sot në botën islame mungon koncepti i një organizate të tillë. Le të mos harrojmë që të 56 anëtarët e OKI nuk mund të kenë të njëjtin mendim. Të habit qëndrim i heshtur i vendeve islame ndaj lidhjeve që mund të kenë me OKI, sepse principit ‘nuk do të ketë shpenzime’ mund t’i shërbejnë më tepër pikërisht këto shtete.

Ndërkohë që në Amerikë përveç të ardhurave që mund të kenë organizatat e shoqërive civile i shtohen edhe të tjera nga shteti. Në shtetet islame vakëfet shihen si një alternativë ndihmëse e shtetit dhe ndonjëherë me një sy kritik. Ashtu si në shumë çështje të tjera do ta kuptojnë rëndësinë e tyre, por do jetë vonë.

Xhamia “Sulltan Mehmed- Fatih”

(Xhamia e Madhe) (1460/61) në Prishtinë- vepër
madhështore e trashëgimisë islame në Ballkan

Ramadan SHKODRA - Prishtinë

Kosova paraqet një thesar të pasur të monumenteve kulturo-historike të periudhave të ndryshme, të cilat shquhen për llojshmërinë, cilësinë dhe rëndësinë historike të tyre. Në përbërjen e këtij thesari kulturo-historik bëjnë pjesë edhe ndërtimet pesëshekulllore të periudhës osmane në këto territore.

Kultura materiale islame në Kosovë, po edhe në të gjitha trojet shqiptare, është shfaqur që nga depërtimi i Perandorisë Osmane në këto troje në shekullin XV, asokohe si bartëse kryesore e fesë,

kulturës dhe qytetërimit islam. Krahas përhapjes së fesë e të kulturës islame në këto troje, paraqitet nevoja edhe për objektet ku do të kryeshin ritet dhe obligimet e fesë islame, prandaj në shumë vende-lokalitete, u ndërtuan objekte përkatëse për qëllime të ndryshme:

1. Objekte për kryerjen e obligimeve dhe riteve fetare: xhami, mesxhide, tyrbe, teqe etj.
2. Objekte për nevojat arsimore: medrese, mektebe, biblioteka;
3. Objekte të karakterit publik e social: hamame, ura guri, kroje

publike, shtëpi banimi, kulla të sahatit, shatërvane, hane, imarete, kala (kështjella);

4. Objekte që shprehin qytetërimin islam: nishane mbi varrezat e myslimanëve, çarshi, bezistane, objekte banimi; dhe me kalimin e kohës me shtimin e ndikimit të kulturës islame në viset tona, u përhapën edhe ndërtime e vendbanime të tëra në stilin oriental.

II

XHAMITË - janë faltore kryesore islame dhe objektet më mon-





umentale dhe për nga numri janë monumentet më të shumta të ruajtura nga përmendoret e kulturës islame në Kosovë. Ndër ne ndërtimi i tyre ka filluar menjëherë pas depërtimit osman.

Sipas të dhënave historike, ndërtimi i xhamive filloi menjëherë pas *Betejës së Kosovës më 1389* (Xhamia e Çarshisë në Prishtinë). Ky aktivitet u zgjerua sidomos gjatë shek. XVI dhe në gjysmën e parë të shek. XVII, kur gradualisht mbisundon popullata islame sidomos në qytete.

Xhamitë janë të ndërtuara me gurë a tulla. Kryesisht janë të mbuluara me kube plumbi, të mbështetura mbi pandantive a trompe, por edhe me çati druri e me qeramidhe. Karakteristike arkitektonike e shumicës së xhamive, sidomos të atyre më të mëdhave, janë kubetë monumentale dhe minaret e holla e të larta.

sovës kemi disa xhami që i takojnë mesjetës, që paraqesin vlerat arkitektonike të këtyre xhamive, siç janë p.sh.: në Prishtinë: Xhamia "Sulltan Murat" (Xhamia e Çarshisë) -(1444); Xhamia "Sulltan Mehmet - Fatih" (Xhamia e Madhe) (1461); Xhamia "Ramadanije" (Xhamia e Llapit) (1470); në Gjakovë xhamia "Hadumë Agës" (1595); në Pejë "Bajrakli Xhamia" (1471); në Prizren Xhamia "Sinan Pasha" (1616)

Një ndër xhamitë më të rëndësishme jo vetëm për nga stili, por edhe për nga vlera s'ka dyshim se është xhamia "Sulltan Mehmed-Fatih" në Prishtinë që nga populli njihet edhe si Xhamia e Madhe.

Estetika, madhësia, bukuria e kësaj xhamie është aq tërheqëse, saqë, më të drejtë, është quajtur

(*Fatihut*) në Prishtinë, që quhet edhe "Xhamia e Mbretit", është ndërtuar me urdhër të Sulltan Mehmedit II në vitin 865 hixhri (1460/61), 8 vjet pas çlirimit të Stambollit.

Mbishkrimi i xhamisë gjendet mbi derën e xhamisë, mbi një copë të bukur mermeri me ngjyrë të zezë e përbërë prej katër rreshtave.

Xhamia Fatih Sulltan Mehmed Han nga ana e Prishtinasve përmendet më shumë si Xhamia e Madhe

Në realizimin e këtij objekti sakral si material ndërtimor konstruktiv është përdorur guri i latuar. Ndërkaq faqet e brendshme të mureve janë me tulla dhe të suvatuara. Përsa u përket dekorimeve plastike, kjo është mjaft modeste, sado që ajo në një masë të vogël prezantohet në formë relievi të imët në minare



Gjithashtu karakteristikë e këtyre xhamive është se brendia e mureve është pikturuar me arabeska, që kryesisht janë me vija gjeometrike dhe me motive bimore të gërshetuara e të stilizuara.

Në qendra të ndryshme të Ko-

"Xhami Sulltanore" ose "Xhamia e sulltanit" dhe paraqet një ndër veprat më të bukura të artit Osman-Islam, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

III

Xhamia e Sulltan Mehmedit II

si stalaktite në mihrab dhe në kapitole e shtylla të hajatit.

Xhamia është e ndërtuar sipas shkollës arkitektonike të Bursës. Xhamia është godine një hapësinore me kubënë me dimensione prej 13.50 m. Është ndërtuar me

tulla nga brenda e me gurë të gdhendur nga jashtë.

Xhamia Fatih Sulltan Mehmet Han është e ndërtuar në stilin e "Ullu Xhamisë" që gjendet në Bursa, është e stolisur shumë bukur, dhe është ndër projektet me bukuri të rrallë të kohës kur është ndërtuar.

Xhamia është e ndërtuar me gurë të mëdhenj katrorë. Në mes ka kupolën kryesore në madhësi prej 13,50 m, kurse nga të katër anët gjenden kupolat me tre kënde. Kupola kryesore dhe kupolat e tjera mbulojnë këtë projekt madhështorë. Minarja e lartë, e hollë dhe e bukur është e ndërtuar gjithashtu prej gurëve. Kapaku i minares, kupola kryesore dhe tre kupolët e vegjël përpara janë të mbuluara me plumb.

Sikurse xhamia po ashtu edhe minarja nuk janë të suvatuara. Maja e minares është e mbuluar me bronz. Kur shikohet minarja mund të vërehet se ballkoni dhe pjesa e epërme e minares është e

rinovuar.

Tavani i xhamisë është rinovuar në vitin 1950-1960. Në këtë rinovim kupolave ua kanë ndërruar mbrojtëset. Në këto vite gjithashtu i kanë rregulluar edhe strehët.

Xhamia e Madhe përbëhet nga këto pjesë: salla e lutjeve (faljeve), hajati (portiku) dhe minarja.

Sipas të dhënave historike, ndërtimi i xhamive filloi menjëherë pas Betejës së Kosovës më 1389 (Xhamia e Çarshisë në Prishtinë). Ky aktivitet u zgjerua sidomos gjatë shek. XVI dhe në gjysmën e parë të shek. XVII, kur gradualisht mbisundon popullata islame sidomos në qytete.

1. Brendia e xhamisë

Brendia e xhamisë (Salla e lutjeve) ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube. Kjo sallë ka planimetri katrore me përmasa 13,95 m. dhe në të hyhet nga porta, që është e mbuluar me arkitrak. Salla me vëllimin e saj unik është e mbuluar me kube të ndërtuar drejtpërdrejt mbi të nëpërmjet pandantivave në qoshe

Xhamia ka 39 dritare në madhësi të ndryshme. Secila nga

dritaret e poshtme ka kapakun e bukur prej druri.

Mahfili:

Mbi derën e hyrjes gjendet mahfili nga druri, i cili është pak i thellë në lartësi prej 3.50 m nga toka.

Mihrabi

Mihrabi i xhamisë është nga mermeri dhe është mjaft i zbukuruar. Mihrabi është në vend të lartë dhe në harmoni me stilitë e xhamisë, është i ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër.

Minberi:

Minberi i xhamisë nga mermeri është mjaft i bukur. Tre qoshet e tij, bukuria e vendosjes së tyre dëshmon për mjeshtërinë e ndërtimit.

Në xhami ka 39 dritare në madhësi të ndryshme. Çdo njëra nga dritaret e poshtme ka kapakun e bukur prej druri.

2. Kupola qendrore

Kupola kryesore mbahet nga qoshet trekëndëshe dhe nuk është shumë e lartë. Gurët të cilët e rrethojnë kupolën i japin një bukuri tjetër xhamisë. Kupolat e pjesës së fundit të vendit të xhematit përbëhen nga pesë pjesë dhe janë tetë këndësh.

3. Hajati

Hajati (portiku) i xhamisë ka një zgjidhje tradicionale të këtyre ambienteve. Hajati mbulohet me tri kube të vogla të njëjta. Kubet e hajatit janë në nivel më të ulët se kubeja kryesore dhe me dinamikën e me kontrastet e tyre ndikojnë në vlerën estetike të objektit. Kubetë janë të mbuluara me mbulesë prej plumbi.

4. Minarja

Si pjesë e pandarë dhe me rëndësi është edhe minarja, e cila zakonisht është në vend të djath-





**E s t e t i k a ,
m a d h ë s i a ,
b u k u r i a e k ë s a j
x h a m i e ë s h t ë a q
t ë r h e q ë s e , s a q ë , m ë t ë
d r e j t ë , ë s h t ë q u a j t u r
“ X h a m i S u l t a n o r e ”
o s e “ X h a m i a e
s u l t a n i t ” d h e p a r a q e t
n j ë n d ë r v e p r a t m ë t ë
b u k u r a t ë a r t i t
O s m a n - I s l a m , j o
v e t ë m n ë K o s o v ë p o r
e d h e m ë g j e r ë .**

të të sallës së lutjeve. Minarja si pjesë konstruktive-arkitektonike dhe funksionale veçohet për poligonalitetin dhe elegancën e saj. Si element i minares është edhe sherifja, e cila shërben për kryerjen e ceremonive të caktuara fetare: thirrja e ezanit.

Minarja shumë këndshe shpreh tendencën e hollësisë maksimale. Madhësia e xhamisë mesatarisht thuhet se është 900 metra katrorë. Xhamia ka vend për 800 njerëz.

Vlerat artistike të xhamisë

Brendia është e dekoruar me omamentikë bimorë. Duke marrë parasysh dimensionet (14,14 x 14,14 m.), konstruksionin, realizimin dhe elementet dekorative së bashku me kohën e ndërtimit, kjo xhami është një ndër objektet më

të rëndësishme dhe më të vlefshme të periudhës osmane ndër ne.

Në këtë objekt monumental na prezantohen edhe dekorimet pikturale të realizuara në seko teknikë. Këto realizime të pikturave murale dekorojnë sallën e lutjeve me kube si dhe hajatin e xhamisë. Këtu, krahas luleve të stilizuara, prezantohen edhe figura gjeometrike, motive arkitektonike, selvi dhe motivi i rrushit. Piktura është përqendruar kryesisht në dritare të sallës së lutjeve, në harqe dhe në padantive në kurore ku nga sistemi konstruktiv pandantiv kalohet në kube. Dekorime kemi edhe në vetë kubën e objektit. Në piktura murale të xhamisë dominon ngjyra e kaltër me nuanca të saj dhe e përhimëta. Rozeta si një tërësi kompozicionale është realizuar me ngjyrë të kuqe (qeramidhe) me të gjelbër, të përhimët dhe të zezë. E zeza kryesisht konturon motivet florale dhe gjeometrike të rozetës.

Në mes të kupolës gjendet një rozetë. Pjesa e epërme e kupolës është e punuar me motive trëndafili dhe gjethe të bimëve. Figurat janë të punuara me një art mallëngjyes, figurat janë me ngjyrë të kaltër, të gjelbër dhe të kuqe dhe shtrihen deri te dritaret e poshtme.

Brendësia e dritareve në pjesën jugore është e zbukuruar me shkrime të bukura. Në pjesën jugore dritaret e epërme janë në formë gjysmë harku dhe xhamat i kanë në formë trëndafili.

Në sajë të elementeve konstruktive, formës arkitektonike, proporcioneve dhe vlerës estetikë të objektit, kjo xhami bën pjesë në rendin e ndërtimeve më të vjetra të realizimeve arkitektonike të konfesionit islam jo vetëm në Prishtinë e në Kosovë, por edhe më gjerë.



Infarkti ulë jetëgjatësinë

Infarkt quhen çrregullimet e funksionimit të zemrës që lindin si pasojë e mosushqimit të muskujve të zemrës. Kjo sëmun-

dje shfaqet tek meshkujt tre-katër herë më shumë se tek femrat.

Mes shkaqeve që shpien në infarkt janë shtimi i sasisë së kolesterolit në gjak, diabeti, ten-

sioni i lartë, cigarja, moslëvizja e tepërt, tensionet shpirtërore dhe mbipesha. Ekspertët pohojnë se kohët e fundit përqindja e infarktit tek të rinjtë është rritur. Mes arsyeve të infarkteve që shfaqen në moshat e reja përveç faktorëve gjenetik dalin në plan të parë cigarja, fast-foodi dhe stresi.

Infarkt sjell pasoja më të rrezikshme tek të rinjtë sepse në moshat e larta gjatë infarktit kur bllokohet aorta, damarët anësor të zhvilluar hyjnë në mes dhe ndihmojnë që zemra të mos mbetet pa gjak. Ndërsa në moshat e reja meqenëse këto damar anësor nuk zhvillohen para moshës pesëdhjetë vjeçare shkalla e rrezikut është më e lartë. Për këtë arsye ekspertët këshillojnë stërvitje të rregullt.

Sida po i tremb jetimët

Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës thuhet se në vitin 2003 fëmijëve që u ka vdekur njëri nga prindërit për shkak të sidës dhe i ka lënë jetim nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç i kalon shifrat 15 milion. Fëmijët që humbasin nënën ose babanë e tyre nga kjo sëmundje dita-ditës është në rritje. Vetëm poshtë shkretëtirës Sahara në Afrikë në vitin 2010 numri fëmijëve që do të mbesin jetim për shkak të sëmundjes së sidës të njërit nga prindërit do të arrijë shifrat 17 milion.



Zgjateni qëndrimin në sofër gjatë ngrënies

Njëzet minuta pasi të fillojmë ngrënien e ushqimit truri i njeriut e paralajmëron stomakun që është ngopur. Që të mos ta teprojmë ngrënien duhet që ta ngadalësojmë ritmin e tij sa më shumë. Për realizimin e kësaj rruga më e mirë është që ushqimi të përthpjet mirë dhe të zgjatet koha e ngrënies. Kjo rrugë pengon që të mos hahet në mënyrë të tepruar dhe lehtëson tretjen e tij lehtë. Sipas studimeve të bëra për këtë thuhet që njerëzit të cilët qëndrojnë shumë

në sofër gjatë ngrënies janë më të dobët se të tjerët. Nëse një person ndjen uri është mirë që të haj fruta dhe perime për tejkalimin e tij.



Kanceri që ka simptomat e gripit: Lenfoma

Lloji i kancerit që dihet më pak është lenfoma. Vullnetarët dhe ekspertët për ti vënë njerëzit në dijeni janë mbledhur në Akademinë e Shkencave të New Yorkut për të diskutuar mbi tri-dhjetë e pesë llojet e ndryshme të lenfomës. Nëse disa forma të lenfomës nuk kurohen brenda gjashtë muajsh kjo sëmundje mund të zhvillohet aq shumë saqë mund të shkaktojë vdekje.

Sipas të dhënave të studimeve të lenfomës njerëzit të cilët jetojnë në botë me këtë sëmundje e kanë kaluar shifrën 1 milion. Dhe është verifikuar se në çdo vit preken nga kjo sëmundje 350 mijë persona.

M. Semih IRTES

ie te zbukurimit eshte nje teknike zbukurimi qe ne gjuhën arabe do të thotë të zbukurosh me flori. Shembujt më të hershëm është e mundur t'i gjejmë në librat e Kur'anit, duave, shkencës dhe letërsisë që janë në artin e librave të shkrimit. Tez'hibët më të mrekullueshëm që ka realizuar piktori me metoda të ndryshme brenda shekujve, padyshim janë ato që ka realizuar për librat fetarë dhe kjo është një e vërtetë që dihet.

Këta artistë që i realizojnë punimet dhe proceset e tyre nëpër vende të posaçme të lidhura me pjesët e territorit të shtetit janë kujtuar gjithmonë me emrin Muzahhip.

Ari apo floriri, që është materiali më i pashmangshëm i artit të Tez'hibit, pas një përpunimi të gjatë arrin në formën e varakut (një pllakë e hollë), e cila më pas shtypet me dorë nga muzahhipi. Floriri i shtypur me një material

ime pas, pasi tnanet benet piunur. Pasi të jenë lyer vendet që do të përgatiten u jepet një shkëlqim me një material në formë vule prej guri të çmuar.

Floriri i përdorur për shkëlqim në shekujt XII, XIII dhe në shekujt e mëvonshëm është përdorur në ngjyra të ndryshme si (jeshile, e kuqe, e bardhë) bile ndonjëherë është përdorur edhe si Mat (lloj materiali). Më e përdorura e bojërave me ngjyra që përdorej përveç floririt ishte edhe e kuqja e mbyllur. Ngjyra bojëqielli e përdorur në tone të ndryshme është me prejardhje pluhuri të tokës në emra të tillë si nuanca lahor, lapis etj, kryhet me materialin e zamkis. Përveç dy ngjyrave kryesore si ngjyra të mesme janë përdorur ngjyra të tilla si e kuqja, jeshilja, ku njëkohësisht këto tone janë përdorur si ngjyra sfondi.

Edhe ngjyrosja e motiveve të luleve bëhet në një mënyrë të shkallëzuar që përfshin të gjitha ngjyrat dhe tonet kryesore dhe që kalon nga më të mbylltat tek më të hapurat apo më të ndezurat.

Pjesët e një veprë shkrimi që zbukurohen me Tez'hib janë: pjesa që është kapaku i brendshëm dhe emri i librit, pjesa në të cilën gjendet se kush e ka shkruar veprën dhe pse është shkruar, faqet boshe apo fletët që tregojnë të gjithë talentin e artistit, faqja ketebe apo faqet e fun-

ime për arsye të vendosjes rit të hattatit, sureja në kur an apo tema në shkrimet e tjera që quhen kryetema apo mihrabije, pikat apo stacionet e vendosura për të ndarë nga njëra-tjetra fjalinë nga ajetet, janë zbukurime trëndafilash që janë në qoshe të faqeve dhe që përmbajnë shpjegime në lidhje me temën dhe këta janë trëndafila të sexhdes, hizip dhe xhyzit dhe të asheres.

Motivet e përdorura në artin e tez'hibit janë një stilizim në formën e bimëve dhe të kafshëve.

Emri që u është dhënë luleve me rrënjë bimore është një lloj kompoziti që në të shumtën e rasteve është një imagjinatë që mbli-dhen në grupin e quajtur Hataji, ndërsa lloji tjetër i motivit që vjen nga modifikimi i formave të kafshëve, ka mbërritur deri në ditët tona me emrin Rumi. Kjo fjalë, me kuptim nga Anadulli në shekujt XII dhe XIII është modeli më i përdorur në artin e zbukurimit arkitekturor dhe të tez'hibit.

Në mënyrë të veçantë, në arkitekturën e Selçukëve, ky lloj arti vihet re në shumë përkujtimore të ideuara me figura karakteristike kafshësh. Që nga shekulli i XIV e humbi formën e saj të kafshëve. Në shekujt XV dhe XVI në Timuri Safavi dhe në Osmanët është në formën e kompozitit që paraqet një shumëllojshmëri.

Idetë në tez'hibet e bëra në shekujt XII dhe XIII janë në rregullin asimetric dhe në të shumtën e rasteve në motive Rumi. Kompozicionet në një pjesë të të cilave zë vend edhe motivi Hataji përbëjnë një lloj të thjeshtë. Një lloj tjetër i quajtur mol që u pëlqye në këtë periudhë është edhe zenxherë i përdorur



në qoshet e parvazeve.

Interesi në rritje i artit të librit në shekullin XII u bë shkak i zhvillimit të Tez'hibit të Konjas. Mbrojtjen e këtij arti në shekullin XIV e bënë Karamanogullari dhe Germijan. Muzehipët Turq i vazhdojnë punimet e tyre në Bursa në mbrojtjen e Sulltanatit Osman.

Idetë e realizuara ndiqen në një formë shumë të pasur dhe motivet Hataji dhe Rumi të studiuara mjaft hollë. Në këtë periudhë, ku kompozicioni pati një zhvillim të dukshëm ndihet një ndikim i shkollave Lindore (Bagdat, Tebriz, Heart). Në kompozicion është periodizuar në një mënyrë të rregullt dhe me karaktere që nuk të lodh syrin simetria.

Vihet re një zhvillim i skemave të kompozicionit brenda përmasave të përcaktuara siç ndodh në artin e Hattit të lidhura plotësisht me rregullat gjeometrike. Në idetë e përgatitura, motivi Rumi dhe Hataji mbart veçori karakteristike të mëdha nga ana individuale apo e përgjithshme.

Brenda kësaj periudhe në repertorin e zbukurimit Turk kanë hyrë edhe motivet e reve dhe në shekullin XVI dhe më pas pothuajse në të gjithë kompozicionet janë përdorur me kënaqësi.

Në periudhën e Javuz Sulltan Selimit, në vitet 1514-15 pas marrjes së Tebrizit me ardhjen në Stamboll të Tebrizit dhe me piktorët e tjerë Heart, artet e zbukurimit Osman fituan një ripërtëritje. Që nga vitet e para të mbretërisë së Kanuni Sulltan Sulejmanit të tërheqin vëmendjen të gjitha të rejat e metodës së zbukurimit, si edhe të rejat e metodës Saz. Krijuesi i këtij modeli është Sahkulu, kryepiktori i sarajit.

Gjatë shekullit XVII mjeshtrat e Tezhibit Turk zakonisht zënë vend në librat e lutjeve. Ideja dhe rregullimi e kanë ruajtur pjesërisht traditën e tyre deri nga mesi i shekullit XVII.

Një nga shembujt më të veçantë



Edhe ngjyrosja e motiveve të luleve bëhet në një mënyrë të shkallëzuar që përfshin të gjitha ngjyrat dhe tonet kryesore dhe që kalon nga më të mbylltat tek më të hapurat apo më të ndezurat.

të Tezhibit Turk janë edhe dizenjot Karahisari në Kur'an. Këto tezhibe të Kur'anit që numërohen si një repertor i artit Osman të zbukurimit nga aspekti i metodës, teknikës dhe llojshmërisë, me një detaj apo hollësi të paimagjinueshme i takojnë vendit të nakëshit Karamemi. Vetëm dizenjot e Kolltukut përfshijnë brenda saj rreth 100 dizenjo të ndryshme. Ajo është zbukuruar me tezbih me rreth 600 ngjyra të ndryshme dhe me metoda të ndryshme.

Vëmë re se në fund të këtij she-

kulli Tezhibi Turk sa vjen dhe e shmang detajin e vet dhe dalëngadalë i humb veçoritë e motiveve të tij. Në shekullin XVIII ku ndihet në mënyrë të dukshme ndikimi i artit Perëndimor, vihet re se është përdorur një lloj në të cilin janë bashkuar në një pikë zbukurimet klasike dhe motivet Barok, Rokoko. Muzehipi më i njohur i periudhës është mjeshtri i punimit Lale Ali Uskudar. Në të gjitha punimet e këtij artisti është e mundur të shihen shembuj të shumtë të përputhjes dhe të kombinimit të modeleve të vjetra dhe të reja. Në fund të shekullit XVIII në Tezhib gjen një shtrirje një mod-el stolisjeje që quhet Rokoko Turk.

Kjo lloj teknike, e cila përbëhet veçanërisht nga buqetat e luleve natyrale ka vazhduar deri nga fundi i shekullit të XIX. Drejt fundit të shekullit XIX janë bërë përpjekje për të marrë në dorë përsëri motivet klasike dhe edhe pse në tezhibin Turk ka dalë në dukje modeli klasik Neo, i cili pranohet si modeli më i varfër dhe më i dobët i artit bezeme Osman. Që në fillim ndoqëm ecurinë e Tez'hibit në artet e librave të shkrimit. Një nga shumë fusha në të cilën është zbatuar tezhibi janë edhe llojet e zbukurimit të realizuara mbi fletët e shkri-mit murakka.

Në shekullin që jetojmë, tez'hibi Turk, i cili vazhdon të zhvillohet në formën e fletëve në kushtet e sotme i jep përgjigje një arti të duhur.

Alban KALI

Shkodër

Një kryq i lartë, i vendosur në majën e një kodre në fshatin Plezhë të Shkodrës është sharruar dhe më pas rrëzuar nga persona ende të paidentifikuar. Rasti i dytë i rrëzimit të kryqeve në komunën e Bushatit brenda 13 muajve, ka indinjuar banorët, të cilët kësaj here përjashtojnë kategorikisht përfshirjen në këtë ngjarje të besimtarëve myslimanë.

Të informuar nga banorë të këtij fshati që ndodhet në kufirin ndarës mes Shkodrës dhe Lezhës, pohojnë se kjo është vepër e turpshme ka si protagonistë segmente të caktuara antishqiptare, ndërsa nuk përjashtojnë mundësinë që sharrimi i kryqit të jetë një lojë politike, për të acaruar akoma më shumë situatën e krijuar në këtë komunë, pas zgjedhjeve lokale të 18 shkurtit.



Tiranë

19 Shkurt 2007, zgjedhjet lokale të 18 shkurtit në Shqipëri përbënë një shans të humbur për të zhvilluar zgjedhje në përputhje të plotë me detyrimet ndërkombëtare dhe me standardet demokratike. Dita e zgjedhjeve ishte në përgjithësi e qetë, por votimi u përshkua nga mangësitë procedurale dhe në disa vende nga tensioni. Këto janë konkluzionet e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, MNVZ, të shpallura në Tiranë.



UNESCO Shpall vitin 2007 si përvjetori i Mevlanasë

Duke marrë inspirim nga bejtët e të Madhit Mevlana është përgatitur një koleksion i argjendë. Unesco e ka shpallur vitin 2007-të si "përvjetori i Mevlanasë" në tërë botën. Në këtë program (ritm-i sema') që është zhvilluar në vilën Esmâ Sultan kanë marrë pjesë Ferjal Kemal Gylman, Xhejla Gëlxykly, Bettina Hakko si dhe rreth katërqindë te ftuar të tjerë nga vendet e ndryshme të botës.



Shkodër

Në qendër të Shkodrës, pikërisht përpara Gjimnazit "28 Nëntori" dhe Prefekturës së Shkodrës, u inagurua monumenti i gjeneralit të madh turk, mbrojtës së Shkodrës Hasan Riza Pasha. Komandanti turk i garnizonit të Shkodrës e ka mbrojtur qytetin më të madh të asaj kohe në trojet Shqiptare nga pushtimi malazes duke mos e dorëzuar garnizonin e tij të mbrojtur si nga ai dhe qytetarët shkodranë për 132 ditë rresht sulmet e forcave të bashkuara malazeze dhe serbe. Në ceremoninë e madhe të organizuar ishin autoritetet lokale si kryebashkiaku Artan Haxhi, Prefekti i Shkodrës Maxhit Cungu, kryetari i sapozgjedhur i Bashkisë Lorenc Luka etj.



Një video që ka qarkulluar këto ditë në internet tronditi shumë Ministrinë Greke të Mbrojtjes. Videoja e realizuar nga një celular dallonte qartë ushtarë grekë të cilët kryenin një maratonë prej 50 km për qëllim stërvitjeje. Përgjatë rrugës nën kujdesin edhe të oficerëve, ushtarët këndonin këngë të improvizuara gjatë rrugës, me përmbajtje të theksuar antishqiptare.

Në njërën prej tyre thuhej: *"I shikoni ata, i quajnë shqiptarë, litarë do të bëjmë me zorrët e tyre. I shikoni ata, quhen turq, opinga do bëjmë me lëkurën e tyre"* dhe ky ritëm u pasua me të qeshura dhe këngë të tjera në vazhdim me përmbajtje të përafërta për turq, shqiptarë apo maqedonas. Videot mund të ndiqen në

Me rastin e 15 vjetorit të rihapjes së Medresesë së Shkodrës pas triumfit të pluralizmit në Shqipëri, me datën 27 Dhjetor 2006 në Teatrin "Migjeni" u organizua një program artistik mjaft i suksesshëm i titulluar **"15 Vjet Medrese"**.

Presidenti i Turqisë Sezer i bëri një vizitë presidentit Moisiu ne Spitalin e Akademisë Ushtarake Gylhane

Para ca ditësh Presidenti Turk Sezer, i bëri një vizitë Presidentit të Shqipërisë Alfred Moisiu i cili ishte për një kontroll mjekësor në spitalin ushtarak të Ankarasë. Kjo është një vizitë e përvitshme pas operacionit në klinikën ku edhe është vizituar ish-kryeministri Nano më parë.

Në vizitën që i bëri perfaqësuesit e shoqatës vëllazërore Turko-Shqiptare në Ankara, presidenti Moisiu shprehu mirnjohjen ndaj tyre. Gjatë bashkëbisedimit me ta u tregoj se është vizituar edhe nga presidenti Sezer me bashkshorten e tij si edhe nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Turke Jashar Byjkanët dhe se këta i kanë uruar shërim të shpejt.

Presidenti Moisiu pohoi se deri tani përkrahësit kryesor për antarsimin e Shqipërisë në Nato janë Turqia dhe Shteti i Bashkuar të Amerikës. Presidentit Turk i premtoi atij se Turqia do ta përkrahë Shqipërinë për t'u antarsuar sa më shpejt në Nato. Gjithashtu ata ishin në të njëjtin mendim rreth problemit të përcaktimit të statusit të Kosovës dhe se zgjidhja më e mirë e saj është pavarësia.



Përdoruesit e kompjuterëve mund ta harrojnë shkrimin e dorës

Rreth 90 % e japonezëve kanë filluar t'i harrojnë karakteret e shkrimit të tyre "Kanzhi". Sipas studimit të një ankete të bërë në Japoni thuhet se rreth

Robotët do të drejtohen nga ana e trurit


Prodhimi i mikroçipëve nano teknologji do të bëjë të mundur t'i drejtojë robotët me anë të sinjaleve të dërguara nga mikroçipët e vendosur në trurin e njeriut.

Shefi i katedrës së fakultetit bio medikal të inxhinierisë Prof. dr. Metin Akaj pohon se vitet e fundit nano teknologji ka arritur të zhvillohet jashtë mase dhe është e mundur që këto mikroçipe mund të vendosën në trupin e njeriut pa shkaktuar ndonjë problem. Profesori thekson se mikroçipët së shpejti do të vendosen në trurin e njeriut me sukses dhe si rezultat do të kemi mundësinë që më anë të sinjaleve t'i drejtojmë ata. Ai pohon se këtë e ka bërë provë tek majmunët. Kjo punë në të ardhmen ka për të sjellë sukses të madh, veçanërisht për të moshuarit të cilët kanë nevoja personale. Akaj thekson se truri i njeriut do t'i përdorë robotët për punë.

90% e shtetasve Japonez të moshës 35-40 vjeç kanë filluar ta harrojnë shkrimin e dorës "Kanzhi" për arsye se ju është bërë ves përdorimi i tepërt i kompjuterit.

Shoqata e cila kujdeset për shkrimin kanzh pohon që është bërë një analizë me mbi 400 persona, të moshës 35-40 vjeç dhe ka rezultuar se rreth 93 % e tyre në vitet e fundit nuk kanë pasur rast të shkruajnë shkrim dore. Po ashtu është verifikuar se aftësia e të shkruarit është ulur tek 85% e kësaj moshë. Harresën e shkrimit të dorës studiuesit e lidhin me atë se pjesa më e madhe e tyre për të shkruar përdorin më tepër sms dhe kompjuterët.

Shkrimi kanzh ngaqë përbëhet nga simbole të ndryshme është më i lehtë për tu shkruar sesa për t'u lexuar. Një profesor Japonez për të treguar vështirësinë e shkrimit të tyre jep këtë shembull: "Po tu paraqitet fotografia e një maceje dhe nëse pyeteni se cila kafshë është ajo, ju padyshim do të përgjigjeshit saktë se cila është ajo, por nëse ju kërkohet që ta vizatoni atë nuk do të mundeshit ta bëni një gjë të tillë."



Ky celular është prodhuar për fëmijët

Për prodhimet e para të vitit 2007 është mbajtur në Barcelonë Kongresi i GSM-së ku ndërmodet e paraqitura të telefonave celular ishte i pranishëm edhe firma Omega Mobile e cila ka lënë përshtypje të jashtëzakonshme. Në këtë telefon mund të kërkojnë vetëm ata numra që janë të lejuar nga ana e prindërve. Në të njëjtën mënyrë mund t'u bëhet thirrje vetëm atyre numrave që janë lejuar nga prindërit. E njëjta gjë vlen edhe për mesazhet. Kjo gjë u siguron


prindërve të fëmijëve që mos t'ju vijë mesazhe dhe thirrje të padëshiruara.

Në këtë model të ri të celularit gjenden edhe lojëra mësimore që janë të dobishme për fëmijët. Nga ana e këtij celulari mund të zbriten edhe lojëra për fëmijë. Gjithashtu një veçori tjetër e këtij telefoni është se me një të shtypur të butonit të celularit mund të bëhen thirrje urgjente në bazë të kodit të çdo shteti. Përfaqësuesit e kësaj firme së bashku me kongresin kanë deklaruar se së shpejti do të hidhet në treg edhe në Evropë.



Motori më i vogël në botë

Shkencëtarët Amerikanë kanë zbuluar motorin më të vogël në botë. Në vitet e ardhshme do të bëhet e mundur që me anë të këtij motori të kurohen qelizat e dëmtuara të trupit. Motori i zbuluar nga shkencëtarët e Universitetit të Kalifornisë është bazuar në logjikën e një miniprovëze karboni, në të cilën janë vendosur dy pika të vogla metali dhe pasi të jenë shkrire mirë ndryshojnë vendin njëra me tjetrën. Ky motor prodhon 20 mikrowat energji dhe në krahasim me masën e tij ndikon jashtë mase. Gjithashtu theksohet se raporti i energjisë së prodhuar nga ky minimotor me energjinë e prodhuar nga motori i një makine V6 që ka 225 fuqi do të jetë 100 herë më i madh.



Roboti që bën ski

A keni parë ndonjëherë më përpara robot që bën ski? Roboti i vogël, i cili quhet Plen mund të bëjë ski dhe gjimnastikë. Programuesit e Plenit të shoqërisë Systec Akazava kanë zhvilluar një robot të vogël por mund të bëjë lëvizje të çuditshme. Roboti është me gjatësi 23 cm. dhe me peshë 700 gr. Është i vogël dhe me procesor 32 bit ARM7.

Roboti është hedhur në treg dhe çmimin e ka dy mijë e dyqind dollarë.

